

**DOKUMENT I BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

STRATEGJI PËR KOSOVËN

Aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e zhvilluar me 4 Tetor 2016

Përkthimet e versionit origjinal të këtij dokumenti janë përgatitur nga BERZH vetëm për të lehtësuar përdorimin nga lexuesit. Megjithëse BERZH ka ushtruar kujdesin e arsyeshëm për të siguruar autenticitetin e përkthimit, BERZH nuk garanton dhe nuk vërteton saktësinë e përkthimit. Kushdo që mbështetet në këto përkthime e merr përsipër rrezikun. BERZH-i, punonjësit ose agjentët e saj nuk janë përgjegjës në asnjë rrethanë ndaj lexuesit ose kujtdo tjetër për çfarëdo pasaktësie, gatimi, lëshimi, fshirje, mangësie dhe/ose ndryshimi në përkthim, pavarësisht nga shkaku si dhe për dëmet që mund të rezultojnë nga kjo. Në rast të dallimeve ose kundërtënive ndërmjet versionit në gjuhën Angleze dhe një versioni të përkthyer, versioni në gjuhën Angleze ka përparësi.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1 PASQYRË E AKTIVITETEVE TË BANKËS	7
1.1 PORTOFOLI AKTUAL I BANKËS.....	7
1.2 ZBATIMI I DREJTIMEVE TË MËPARSHME STRATEGJIKE.....	7
1.3 MËSIMET KRYESORE.....	11
2 MJEDISI OPERACIONAL.....	12
2.1 KONTEKSTI POLITIK.....	12
2.2 KONTEKSTI MAKROEKONOMIK	13
2.3 KONTEKSTI I REFORMAVE STRUKTURE	15
2.4 QASJA NË FINANCIM	17
2.5 MJEDISI AFARIST DHE KONTEKSTI LIGJOR.....	20
2.6 KONTEKSTI SOCIAL.....	22
2.7 EFIKASITETI I BURIMEVE DHE TRANZICIONI NË EKONOMINË E GJELBËR	24
3 ORIENTIMET STRATEGJIKE.....	26
3.1 DREJTIMET STRATEGJIKE	26
3.2 SFIDAT KRYESORE DHE AKTIVITETET E BANKËS.....	29
3.3 MENAXHIMI I RREZIQEVE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR KOSOVËN	45
3.4 IMPLIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE TË AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA NGA BANKA	46
3.5 BASHKËPUNIMI I BERZH ME BMZH	47
ANEKSI 1 – VLERËSIMI POLITIK.....	48
ANEKSI 2 – INDIKATORËT E PËRZGJEDHUR EKONOMIK	58
ANEKSI 3 – VLERËSIMI I SFIDAVE TË TRANZICIONIT.....	59
ANEKSI 4 – TRANZICIONI LIGJOR.....	63
ANEKSI 5 – PROFILI GJINOR.....	67
ANEKSI 6 – BERZH DHE KOMUNITETI I DONATORËVE.....	69

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është e përkushtuar dhe është duke aplikuar parimet e demokracisë shumë partiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut në pajtim me kushtet e përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës. Gjatë kësaj periudhe, nga miratimi i Strategjisë së kaluar, përpjekjet e Kosovës për përafrim me Bashkimin Evropian (BE) kanë vazhduar të përbejnë synimin kryesor të jashtëm, rreth të cilit janë bazuar reformat gjithëpërfshirëse. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE ka hyrë në fuqi ligjërisht me 1 Prill 2016.

Gjatë krizave globale dhe atyre të Eurozonës, ekonomia Kosovare i ka përballuar më mirë këto kriza se sa ekonomitë e rajonit, duke pasur rritje mesatare prej 3.5 përqind gjatë periudhës 2009-2013. Pas një ngadalësimi në vitin 2014, ky ritëm i rritjes është kthyer përsëri në vitin 2015 kur ka pasur rritje prej 3 përqind, që ka qenë rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, me investimet që kanë kontribuar më së shumti. Rritja pritët të përshpejtohet në vitet e ardhshme me zbatimin e reformave të mëtutjeshme dhe rritjen e investimeve. Në Janar 2016, Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka përfunduar Shqyrtimin e Parë të Programit Stand-By (MSB) me kohëzgjatje prej 22 muajsh dhe vlerë të përgjithshme prej 185 milion euro – që ka për qëllim ruajtjen e deficitit dhe borxhit të ulët publik, eliminimin e pengesave kryesore strukturore për zhvillim, dhe të nxisë mbështetjen nga kredituesit tjerë multilateral dhe bilateral – dhe ka vlerësuar se kjo Marrëveshje është duke u zbatuar dhe është duke i ndihmuar autoritetet Kosovare në ruajtjen e indikatorëve të favorshëm fiskal. Megjithatë, pengesat strukturore janë duke e rënduar ekonominë Kosovare, në të cilën dominojnë industritë me vlerë të shtuar të ulët, dhe në përgjithësi është në fazën e hershme të tranzicionit, krahasuar me pjesën tjetër të rajonit, me BPV-në më të ulët për kokë banori nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Në aspektin strukturor, në mënyrë që sektori privat të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme të klimës për investime, përmirësimin e qeverisjes dhe sundimit të ligjit, rritjen e konkurrueshmërisë në ekonomi si dhe përmirësimin e infrastrukturës publike dhe adresimin e pengesave për zhvillimin e sektorit të energjisë, si dhe ndërlidhjen e ngushtë të këtyre reformave me procesin e integritimit në BE. Sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova kanë të bëjnë me mungesën e kapacitetit energjetik. Kosova nuk ka furnizim të qëndrueshëm me energji dhe termocentralet e vjetruara prodhojnë sasinë më të lartë të karbonit në Ballkanin Perëndimor dhe shkaktojnë ndërprerje të shpeshta të energjisë, duke penguar zhvillimin dhe investimet. Një sfidë e rëndësishme është siguri i kredive për ato ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të cilat kanë nevojë për kredi mirëpo janë të kufizuara për shkak të gjendjes së përgjithshme ekonomike, shkallës së lartë të informalitetit, mungesës së historikut biznesor ose kreditor, mungesës së kolateralit si dhe shkallës së ulët të zhvillimit të tregjeve të kapitalit. Integrimi i Kosovës në tregjet rajonale ka mbetur prapa dhe është duke u ballafaquar me shkallë të lartë të deficitit të jashtëm tregtar dhe ka shkallën më të ulët të eksporteve në rajon, që është indikacion i qartë për vështirësitë me të cilat ballafaqohen kompanitë Kosovare në tregtinë ndërkombëtare. Përfundimisht, ka pasur pak progres në privatizimin e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore (NPSH) të mbetura dhe apetiti i investitorëve vazhdon të jetë i kufizuar dhe nuk ka pasur të ardhura nga privatizimi në vitin e kaluar.

Megjithëse sfidat strukturore janë të konsiderueshme, zhvillimet pozitive të brendshme dhe të jashtme mund të bashkohen për ti dhënë shtytje angazhimit të Bankës gjatë periudhës së re të Strategjisë. Këto zhvillime pozitive përfshijnë 1) hyrjen në fuqi të MSA-së me BE-në, 2) miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, 3) dorëzimi i Programit të Dytë Ekonomik dhe të Reformave 2016 – që përfshin një agjendë për reforma strukturore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim dhe krijim të vendeve të

punës – si dhe 4) harmonizimin strategjik të prioritetëve të Bankës dhe të BE për alokimin e 645.5 milion Euro në kuadër të Fondeve të Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA II).

Strategjia ka për qëllim aplikimin e disa filtrave selektiv në zhvillimin e aktiviteteve investive dhe të dialogut për politikën brenda Kosovës:

- **Harmonizimi i prioritetëve të Bankës me prioritetet e Qeverisë dhe pronësia;** Banka do t'i shmanget angazhimit substancial në fushat dhe sektorët në të cilën nuk ka udhëheqje të qartë politike;
- **Plotësimi i akterëve të tjerë,** duke përfshirë Komisionin Evropian (KE), FMN-në, Grupin e Bankës Botërore (GBB) dhe institucionet tjera ndërkombëtare financiare (IFN); Banka nuk do të ketë angazhim substancial në fushat në të cilët partnerët tjerë janë në rol udhëheqës;
- **Përparësitë krahasuese të BERZH dhe historiku i angazhimit në Kosovë.** Këto do të rezultojnë kryesisht nga angazhimi i Bankës me sektorin privat (posaçërisht në agrobiznes, prodhimtari, TIK, energji elektrike dhe burime të ripërtëritshme të energjisë) si dhe investimet e targetuara në sektorin publik, për promovimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe mbështetjen e reformave (IKM dhe transportet).
- Banka do të aplikojë **qasjen Tranzicioni në Ekonomi të Gjellbër (TEGJ)** në të gjithë sektorët dhe aktivitetet kur është relevante, për maksimalizimin e mbështetjes dhe zbatimit të investimeve TEGJ; ofrimin e asistencës teknike për adresimin e mungesës së kapaciteteve dhe vetëdijes; si dhe angazhimin në dialog për politika me qëllim të largimit të barrierave dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për investime të gjelbra, ndër tjera.
- Në kuadër të të gjitha prioritetëve strategjike të saj, Banka do të promovojë **zhvillimin përfshirës** (të të rinjë, femrave në fuqinë punëtore dhe emigrantëve të kthyer).

Shfrytëzimi i iniciativave të siguruara nga BE dhe FMN, si dhe dinamikës së reformave të vet autoriteteve Kosovare, Banka do të ketë për qëllim mbështetjen e Kosovës në përpjekjet e saj për përsheptimin e zhvillimit ekonomik mbi baza të qëndrueshme dhe përfshirëse, njëkohësisht duke thelluar dhe fuqizuar angazhimin dhe mbështetjen e nevojshme dhe në pajtim me dinamikën dhe progresin e reformave, duke u fokusuar në prioritetet strategjike në vijim:

- **Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit afarist.** Ekonomia Kosovare karakterizohet nga produktiviteti i ulët, papunësia e lartë, mospërputhja e aftësive të fuqisë së re punëtore dhe kërkesave të punëdhënësve, baza e dobët e eksportit, investimet e jashtme të kufizuara, shkalla e lartë e informalitetit dhe zbrastëritat në përfshirje, siç është pjesëmarrja shumë e ulët e femrave në fuqinë punëtore. Në mënyrë që sektori privat të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme në fushën e klimës së investimeve, qeverisjes dhe konkurrueshmërisë, duke shfrytëzuar procesin e përafrimit me BE. Banka do të sigurojë financim për korporatat dhe NVM-të Kosovare për mbështetjen e investimeve në aktivitete që kanë vlerë të shtuar, përmirësojë konkurrencën kundrejt importeve, dhe mundësojë eksporte me vlerë të shtuar. Përmirësimi i qasjes në financim për NVM do të vazhdojë të jetë prioritet. Përveç financimit, Banka gjithashtu do të ofrojë shërbime të këshillimit përmes Programit Këshilla për Bizneset e Vogla në kuadër të Iniciativës për Biznese të Vogla. Banka do të përdore bankat lokale partnere për kanalizimin e financimit për NMVM-të dhe do të ofrojë shërbime të këshillimit për

biznese në kombinim me investime për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e sektorit të agrobiznesit, duke përfshirë, përmes ngritjes së standardeve të cilësisë dhe shëndetit, si dhe përmes zhvillimit të zingjirëve të furnizimit. Duke marrë parasysh likuiditetin e lartë të sektorit bankar, Banka do të vazhdojë të lançojë korniza të fokusuara, disa prej të cilave do të kenë incentiva të caktuara, siç është Programi Femrat në Biznes (FnB), Mekanizimi për Financimin e Energjisë së Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor (MFEQBP), Korniza e Financimit Direkt në kuadër të Iniciativës për Bizneset e Vogla si dhe të lançojë Mekanizmin për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë (MMK), si dhe Mekanizimin për Ndarjen e Rrezikut (MNRK). Banka do të ketë për qëllim ofrimin e qasjes në kapital për NVM-të, kur është e përshtatshme, për të adresuar mungesën e burimeve të financimit të kapitalit në Kosovë, edhe nëse mundësitë për investime të kapitalit janë të rralla për shkak të mundësive të vogla dalëse dhe informalitetit. Banka gjithashtu do të ofrojë shërbime të këshillimit me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve dhe do të shqyrtojë angazhimin në fushat të cilat e adresojnë informalitetin, raportimin financiar, kapacitetin menaxhues, qeverisjen korporatave si dhe promovimin e përfshirjes sociale duke i inkurajuar njerëzit që të marrin pjesë në mënyrë aktive në tregun e punës. Banka gjithashtu do të jetë e vëmendshme ndaj sfidave të migrimit, në kontekstin aktual, duke qenë se qeveria është duke u përpjekur të rrisë “*Kthimin e Trurit*” nga Diaspora, dhe Banka do të përpikët që të marrë pjesë në skemat e udhëhequra nga Qeveria për bashkëpunimin me pjesëtarët e diasporës Kosovare të kthyer në sektorin privat, me kusht të ekzistimit të fondeve adekuata në formë të granteve.

- Rritja e sigurtisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes financimit të investimeve në këtë sektor, mbështetjes së reformave dhe promovimit të efijencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme.** Banka do të aplikojë qasjen TEGJ në të gjithë sektorët dhe aktivitetet kur është relevante, për maksimalizimin e mbështetjes dhe zbatimit të investimeve TEGJ në Kosovë. Sektori i vjetruar energjetik në Kosovë është duke vuajtur nga vitet e shumta të mos-investimit. Mungesa e energjisë së qëndrueshme është duke i çrregulluar aktivitetet e bizneseve dhe pengon investimet dhe zgjerimin e bizneseve. Dy termocentralet me qymyr të Kosovës janë të vjetra dhe njëri prej tyre është planifikuar që të nxirret nga funksioni. Efijenca e energjisë dhe energjia e ripërtëritshme mund të ndihmojnë në zbutjen e mungesave aktuale të të parashikuara energjetike, duke rritur njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit. Për arritjen e këtij synimi duhet të fuqizohet korniza aktuale rregullatore dhe kapacitetet institucionale për efijencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme. Kosova duhet të harmonizojë më tutje legjislacionin e saj me atë të BE, duke ulur intensitetin energjetik dhe rritjen e respektimit të kërkesave mjedisore. Banka do të shqyrtojë mbështetjen e investimeve për rritjen e kapaciteteve gjeneruese, duke përfshirë nga burimet termale dhe ato të ripërtëritshme, në rastet kur këto investime janë në përputhje me Strategjinë e Sektorit Energjetik të Bankës. Paralelisht, Banka do të mbështesë fuqizimin dhe rritjen e efikasitetit të rrjetit shtetëror të transimit, si dhe investime në reduktimin e intensitetit energjetik përmes mbështetjes së investimeve për rritjen e efijencës së energjisë nga ana e kërkesës në të gjithë sektorët, si pjesë e huadhënies direkte ose mekanizmave për financimin e energjisë së qëndrueshme përmes bankave partnere. Varësisht nga përkushtimi i autoriteteve Kosovare dhe në koordinim me BE, IFN-të tjerë ndërkombëtare dhe donatorët aktiv në sektorin e energjisë, Banka do të ofrojë këshilla për politikave dhe asistencë teknike për zbatimin e reformave institucionale dhe të politika, posaçërisht në fushën e kornizës rregullatore për energjinë e ripërtëritshme si dhe për përmirësimin e kornizës ligjore për efijencën e energjisë, me fokus të veçantë në sektorin rezidencial.

- **Mbështetja e ndërlidhjes dhe integritimit rajonal.** Për përmirësimin e integritimit rajonal të Kosovës ka nevojë për përmirësimin e infrastrukturës dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD), si dhe harmonizimin me standardet e BE. Për arritjen e këtij qëllimi, Kosova duhet të zhvillojë lidhjet rrugore me korridoret kryesore Pan-Evropiane. Rrjeti hekurudhor i vjetruar i Kosovës aktualisht është i lidhur me rrjetin kryesor Evropian vetëm përmes IRJ Maqedonisë, që paraqet pengesë të konsiderueshme për trafikun nga dhe drejt shumicës së qendrave Evropiane dhe e vetmja lidhje tjetër nga Prishtina në Serbi nuk është funksionale. Banka synon të ofrojë financim afatgjatë dhe këshillim për të ndihmuar në zhvillimin e lidhjeve kryesore të transportit si dhe, kur është e aplikueshme, të ndihmojë Kosovën në arritjen e standardeve Evropiane në sektorin e transportit. Banka gjithashtu do të mbështesë investimet që kanë për qëllim përmirësimin e lidhjeve rajonale të Kosovës në fushën e energjisë. Banka do të përpiqet të bashkë-financojë investimet e Bankës Evropiane për Investime (BEI), si dhe të mbështesë Kosovën në mobilizimin e granteve nga BE në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP), që është duke u fokusuar gjithnjë e më shumë në projekte të cilat e promovojnë ndërlidhjen. Përfundimisht, integrimi i bizneseve është gjithashtu një çështje jetike, pasi që kompanitë Kosovare nuk kanë qenë në gjendje që të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e ofruara nga këto tregje të eksportit dhe Banka do të vazhdojë të mbështesë tregtinë ndër-kufitare për Programin e saj për Lehtësinë e Tregtisë, këshillimeve për bizneset e vogla për gatishmërinë për eksporte si dhe këshilla të politikave për reduktimin e Barrierave Jo-Tarifore dhe Barrierave Teknike për Tregtinë lidhur me agjendën e ndërlidhjes së BE.

1 PASQYRË E AKTIVITETEVE TË BANKËS

1.1 Portofoli aktual i Bankës

Proporcioni i sektorit privat: 30.1 përqind*, deri me 31 Gusht 2016

Grupi i Sektorëve	Ekipi i Sektorit	Portofoli i aktivitetev	Portfoli (€m)	% Portfoli	Asetet Op	% e Aseteve Op
Energjia	Burimet Natyrore	0	0	0%	0	0%
	Energjia Elektrike dhe Energjia	2	31	22%	1	3%
		2	31	22%	1	3%
Institucionet Financiare	Kredituesit Depozitues (bankat)	5	9	6%	8	24%
	Kredituesit Jo-Depozitues (jo-bankare)	8	16	11%	5	17%
		13	24	18%	13	42%
Industria, Tregtia dhe Agrobiznesi	Agrobiznesi	2	2	1%	2	6%
	Fondet e Kapitalit	4	6	5%	2	8%
	TIK	2	13	9%	13	42%
	Prodhimtaria dhe Shërbimet	0	0	0%	0	0%
	Prona dhe Turizmi	0	0	0%	0	0%
		8	21	15%	17	56%
Infrastruktura	Infrastruktura Komunale dhe Mjedisore	2	14	10%	0	0%
	Transporti	2	48	35%	0	0%
		4	62	45%	0	0%
Përmbledhje		27	139	100%	31	100%

*proporcioni 5-vjeçar i portofolit
Burimi: BERZH

1.2 Zbatimi i drejtimeve të mëparshme strategjike

Në vitin 1999, projektet e sektorit privat në Kosovë janë kualifikuar për mbështetje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) përmes fondeve të dedikuara rajonale të menaxhuara nga jashtë dhe përmes mekanizmave rajonal të Bankës për Ballkanin Perëndimor. Kosova është bërë anëtare dhe shtet pranues i Bankës në vitin 2012.

Banka aktualisht vepron në Kosovë në bazë të Strategjisë së parë Shtetërore të aprovuar në Maj 2013, përmes tri prioritetëve strategjike si në vijim:

- Mbështetja e privatizimit dhe zhvillimi i sektorit privat me synim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe vendosjes së praktikave të mira;
- Zhvillimi i komercializimit, konkurrencës dhe përfshirjes së sektorit privat në infrastrukturë, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike; dhe
- Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorëve të energjisë dhe atij mineral.

Zbatimi i Strategjisë Shtetërore është bërë në kontekstin e ekonomisë në rënie, ndërsa krizat e vazhduara politike kanë kontribuar në ngadalësimin e reformave të politikave dhe vonesave në përgatitjen dhe zbatimin e disa privatizimeve kyçe dhe projekteve infrastrukturore.

Gjatë periudhës së strategjisë, Banka ka nënshkruar 24 projekte (64 përqind e të gjitha investimeve të bëra në Kosovë deri më tani) me shumë të përgjithshme prej 113 milion Euro dhe me rritje të vazhdueshme të Investimeve Vjetore të Biznesit (IVB) me rritje të vazhdueshme nga viti në vit nga 22 milion euro deri në 56 milion euro. Aktualisht, portofoli i Bankës në Kosovë është 139 milion Euro. Megjithatë shumica e aktiviteteve të Bankës janë në sektorin privat i cili dominohet nga NVM-të, proporcioni i portofolit në sektorin privat është krahasimisht i vogël (30.1 përqind) duke marrë parasysh investimet e mëdha dhe kyçe në infrastrukturën publike.

Në pjesët në vijim janë potencuar çështjet kryesore që ndërlidhen me performancën e BERZH në Kosovë dhe mësimet kryesore për periudhën e Strategjisë së re.

Tema 1: Mbështetje për privatizimin dhe zhvillimin e sektorit privat me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe vendosjes së praktikave me të mira

Banka ka mbështetur zhvillimin e sektorit privat përmes kanalizimit të financimit afatgjatë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) kryesisht përmes bankave lokale dhe institucioneve mikro financiare (IMF) mirëpo edhe përmes financimit të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet e mesme (Asgeto dhe Viva Fresh).

Në përgjithësi, përmes Projektit për Energji të Qëndrueshme në Kosovë (KOSEP) partnerët e Bankës kanë dhënë kredi në vlerë prej 9.7 milion Euro për 20 NVM dhe për 2,839 projekte për efikasitet të energjisë rezidenciale dhe energji të ripërtitshme, ndërsa përmes Mekanizmit të Ballkanit Perëndimor për Femrat në Biznes (FnB) partneri i Bankës, banka TEB ka dhënë kredi në shumën prej 2.9 milion Euro për financimin e 228 NMVM në pronësi ose të udhëhequra nga femrat. Në veçanti, FnB i ka mundësuar TEB-it që të eksplorojë një pjesë të tregut që konsiderohet me rrezikshmëri më të madhe dhe të zhvillojë produkte të reja kreditore për FnB për bizneset ekzistuese dhe ato të reja. Programi i Bankës për Këshillimin e Bizneseve të Vogla (KBV) ka ofruar shërbime të këshillimit për 20 biznese të udhëhequra nga femrat dhe ka qenë instrumental duke i'u ndihmuar pesë prej tyre që më pas të sigurojnë financim nga TEB në kuadër të FnB.

Aktivitetet e Bankës për financimin e drejtpërdrejtë të kompanive në pronësi vendore janë kufizuar në dy projekte investive, një projekt me Asgeto, distributorin e dytë më të madh të produkteve farmaceutike (kredi në kuadër të Mekanizmit për Ndërmarrjet Lokale) ndërsa projekti tjetër me një kompani zingjir të shitjes më pakicë Viva Fresh (kredi në kuadër të Fondit për Zgjerimin e Ndërmarrjeve FZN të krijuar në vitin 2014). Përfundimisht, përmes një linje kreditore në kuadër të MNL¹, institucioni mikrofinanciar Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) ka financuar gjithsej 2.438 projekte të NMVM.

Programi i Bankës për Këshillim për Biznese të Vogla ka luajtur një rol të konsiderueshëm në mbështetjen e ndërmarrjeve në Kosovë përmes zbatimit të 226 projekteve që kanë kontribuar mesatarisht në përmirësimin e produktivitetit të NVM-ve me 21 përqind, rritjen e qarkullimit me 22 përqind dhe krijimin e 656 vendeve të punës. Gjithashtu, dy projekte këshilluese në kuadër të Programit për Këshillimin e Bizneseve të Vogla janë zhvilluar me kompaninë Asgeto dhe i kanë ndihmuar kësaj kompanie që të zhvillojë hulumtime të tregut, të identifikojë pozicionin e saj në treg dhe klientë të rinj potencial, si dhe të implementojë standardet Evropian për Praktikën e

¹ Në Prill 2015, Mekanizmi për Ndërmarrjet Lokale (MNL) është konsoliduar në Kornizën e Financimit të Drejtpërdrejtë në kuadër të Iniciativës për Bizneset e Vogla.

Mira të Distribuimit. Në kuadër të Programit KBV, NVM-të lokale kanë pranuar mbështetje përmes konsulentëve vendor dhe ekspertëve ndërkombëtar të industrisë në fusha sikurse menaxhimi financiar dhe qeverisja korporative, standardet mjedisore dhe të cilësisë, marketing dhe strategji të biznesit, zingjirët e vlerës së sektorëve dhe produkteve. Programi KBV i Bankës gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut lokal të konsulencës. Gjatë periudhës së strategjisë, KBV ka trajtuar 120 konsulentë për zhvillimin e aftësive të tyre për diagnoza biznesore, shitje dhe marketing, eficiencën energjetike industrial dhe menaxhimin e bizneseve të konsulencës.

Banka është anëtare aktive dhe gjithashtu ka kontribuar në themelimin e Këshillit të Investitorëve Evropian, së bashku me 15 investitorë që veprojnë në Kosovë dhe me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, që është shndërruar në forum për dialog publiko-privat të politikave dhe për përmirësimin e ambientit afarist.

Tema 2: Rritja e komercializimit, konkurrencës dhe përfshirjes së sektorit privat në infrastrukturë

Në vitin 2015 Banka ka ofruar një kredi prej 39.9 milion Euro për Infrakos (Ndërmarrjen e Kosovës për Infrastrukturë Hekurudhore) për financimin e rehabilitimit të pjesës Kosovare me gjatësi prej 148 km të Linjës Evropiane Hekurudhore 10, Korridori i Bashkimit Evropian TEN-T, Orienti/Mesdheu Lindor dhe lidhjes së vetme funksionale hekurudhore të Kosovës me IRJ të Maqedonisë që është jetike për integrimin e mëtutjeshëm të Kosovës dhe integrimin në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Pritjet janë që brenda disa viteve ky Projekt të rezultojë në rritjen e komercializimit të këtij sektori dhe komponentit të fuqizimit institucional dhe përmes mbështetjes së Ndërmarrjes Kosovare për Infrastrukture Hekurudhore që të operojë si entitet i pavarur dhe në pajtim me parimet komerciale. Ky ka qenë projekti i parë i Bankës në fushën e transportit në Kosovë dhe projekti i parë i bashkë financuar me BEI dhe me një investim të konsiderueshëm të BE në formë të grantit të siguruar përmes KIBP, që ka shërbyer si instrument efektiv për përgatitjen e projektit investiv dhe rritjen e koordinimit mes IFN-ve.

Në fund të vitit 2015, Banka ka nënshkruar projektin e parë rrugor në Kosovë përmes një kredie sovraane prej 29 milion Euro për të ndihmuar Qeverinë për rehabilitimin e një segmenti rrugor prej 15 km të rrjetit rrugor shtetëror nga Klllokoti në Gjilan dhe në zhvillimin e rrugëve lidhëse me gjatësi totale prej 11.2 km në qytetet Ferizaj, Gjilan dhe Prizren. Përmes këtij projekti janë adresuar disa sfida kyçe sektoriale përmes komponentëve të fuqizimit të institucioneve duke i ndihmuar qeverisë në planifikimin adekuat të investimeve prioritare në sektorin rrugor dhe trajnime në fushën e prokurimit, për të siguruar zbatimin e procedurave transparente të prokurimit.

Në anën tjetër, Banka është duke ndihmuar Qeverinë në përgatitjen e projektit dhe studimin e fizibilitetit për segmentet kyçe rrugore që janë pjesë të segmenteve të korridoreve Pan-Evropiane të transportit, duke përfshirë:

- Segmentin rrugor Kijevë – Pejë, që është pjesë e Rrugës Evropiane Jug-Lindore SEETO 6b nga Prishtina në Pejë;
- Segmentin rrugor nga Prishtina në Merdare (pjesë e Rrugës SEETO 7) që lidh Serbinë, Kosovën dhe Shqipërinë (Nish – Prishtinë – Durrës) në atë që është quajtur “Autostrada e Paqes”; dhe
- Autostrada Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë.

Dizajni preliminar i këtyre segmenteve rrugore pothuajse është përfunduar dhe qëllimi është që të përmirësohet ndërlidhja e rajonit të Ballkanit Perëndimor me BE-në. Segmenti rrugor Kijevë – Pejë në veçanti është parashikuar që ti adresoj sfidat kryesore sektoriale përmes aktiviteteve për zhvillimin institucional, siç është zhvillimi i një strategjie për mirëmbajtje rrugore që ka për qëllim rritjen e komercializimit.

Në Mars 2015, Banka ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me komunën e Prishtinës për rritjen e bashkëpunimit që ka për qëllim zhvillimin e efikasitetit operacional dhe konsolidimit të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e transportit urban, mbështetjen e investimeve në infrastrukturën rrugore urbane, ujësjellësit dhe kanalizimit, mbeturinave të ngushta, ndriçimit publik dhe efijencës së energjisë në ndërtesat publike të Komunës së Prishtinës. Projekti i parë i përgatitur në kuadër të këtij MtM është Projekti i Transportit Urban të Prishtinës sipas të cilit Banka do të japë kredi për Ndërmarrjen e Transportit Publik të Prishtinës për modernizimin e flotës së autobusëve dhe përmirësimin e performancës operationale dhe mjedisore dhe respektimin e standardeve të sigurisë. Projekti është nënshkruar në Qershor 2016 me përkushtimin e vazhdueshëm të Komunës drejt përmirësimit të standardeve operationale dhe mjedisore.

Tema 3: Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorëve të energjisë dhe atij të minierave

Në kuadër të këtij prioriteti, angazhimi i Bankës ka qenë i kufizuar, duke qenë se Kosova ka bërë shumë pak progres në reformat në sektorin e energjisë dhe minierave gjatë periudhës së strategjisë. Në vitin 2014, Banka ka ofruar një kredi prej 30 milion Euro për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, Sistemit dhe Operatorit të Tregut (KOSTT) për financimin e rehabilitimit të nën-stacioneve dhe transformatorëve dhe fuqizimin e rrjetit në 110 kV që, *ndërtjera*, të plotësojë kërkesat teknike për anëtarësim në ENTSO-E (organizatën e operatorëve Evropian të rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike). Kjo ka qenë kredia e parë për një ndërmarrje publike në Kosovë pa garanci sovraane, duke krijuar kështu mënyra të reja për financimin e infrastrukturës publike dhe inkurajimin e përfshirjes së sektorit privat.

Investimet për rritjen e efijencës së energjisë në sektorin e NVM-ve dhe atë rezidencial janë mbështetur përmes Kornizës së Projektit për Energji të Qëndrueshme në Kosovë. Këto investime kanë rezultuar në kursime energjetike prej 17,070 MWh/y dhe kanë reduktuar emetimet e CO2 me 8,681 ton/vit. Si rezultat i aktiviteteve të Bankës për energji të qëndrueshme gjatë periudhës së strategjisë, reduktimi total i CO2 gjatë periudhës së strategjisë ka qenë 25.2 kt/vit.

Në kuadër të Mekanizmit të Ballkanit Perëndimor për Financim të Drejtpërdrejtë të Energjisë së Qëndrueshme (MBPFDEQ) që ka për qëllim mbështetjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor lidhur me energjinë e ripërtitshme, Banka është duke dialoguar me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) të Kosovës për zbatimin e nevojshëm dhe gradual të tarifave që pasqyrojnë koston dhe ka organizuar disa ngjarje promotionale lidhur me efijencën e energjisë.

Në kuadër të Programit Rajonal të Ballkanit Perëndimor për Efijencë të Energjisë (PRBPEE), Banka është duke ofruar mbështetje për qeverinë për transpozimin e katër draft rregulloreve të nevojshme për transpozimin dhe zbatimin e Direktivave të BE për Performancën Energjetike të Ndërtesave (PEN) në kornizën rregullatore të Kosovës dhe ka dorëzuar një Projektligj për Efijencën e Energjisë në Ndërtesa në Departamentin e Energjisë që funksionon në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Qershor 2015. Së bashku me Sekretariatit e Komunitetit

të Energjisë, Banka ka punuar ngushtë me Qeverinë për mbështetjen e aprovimit të këtyre dokumenteve. Megjithatë, aprovimi i këtyre rregulloreve është ende në proces.

1.3 Mësimet kryesore

Pavarësisht sukseseve, Banka ka hasur në disa vështirësi të konsiderueshme gjatë zbatimit.

- **Mungesa e kërkesës për produktet standarde të financimit të Bankës** – Shkalla e lartë e likuiditetit në sektorin bankar e ka kufizuar kërkesën për produktet financiare të Bankës. Sfidat kryesore për kreditimin e tërthortë nga Banka përfshijnë portofolin e kufizuar të klientëve të bankave partnere për shkak të mungesës së diversitetit të ekonomisë, e cila është e bazuar në tregtinë me pakicë dhe aktivitetet e ndërtimit me bazë të ulët industriale dhe shkallë të lartë të informalitetit. Sektori privat korporativ është shumë i vogël dhe dominohet nga dy kompani të mëdha të përpunimit të mineraleve.
 - Banka do të fokusohet në zhvillimin e produkteve për ofrimin e ndihmës në kapital për bankat, mekanizmeve për zvogëlimin e rrezikut për bizneset e vogla, duke përfshirë në baza të portofolit dhe me mbulimin e humbjeve të para, si dhe linja të dedikuara kreditore për mbështetjen e sektorëve në të cilët shërbimi është i ulët (p.sh NVM, Femrat në Biznes, agrobiznesi, eficienca e energjisë për NVM dhe sektorin rezidencial, sikurse me linjat kreditore të KOSEP). Në kuadër të Programit për Këshillimin e Bizneseve të Vogla, Banka është duke pilotuar iniciativën për NVM me potencial të lartë të rritjes në mënyrë që këto NVM të mbështeten me këshilla dhe financim.
- **Kapaciteti i ulët zbatues i sektorit publik** – Për shkak të kufizimeve të kapaciteteve administrative dhe mjedisit mjaft sfidues politik në Kosovë, përgatitja dhe zbatimi i projekteve infrastrukturore komplekse ka marrë kohë të konsiderueshme dhe ka kërkuar asistencë të konsiderueshme teknike. Shembujt përfshijnë: kredinë për KOSTT (30 milion Euro) që është nënshkruar në vitin 2014 mirëpo është dashur shumë kohë që të përgatitet dhe të tenderohet (lëvrimi pritët të bëhet në vitin 2016) si dhe tenderët për dy projektet e para hekurudhore dhe të transportit në nënshkruara në fund të vitit 2015 (gjithsej 48 milion euro) dhe që janë ende në përgatitje pasi që ende ka disa KP që duhet të plotësohen para se të fillojë lëvrimi në vitin 2016.
 - Në retrospektivë, duke marrë parasysh fazën aktuale të zhvillimit, konsiderojmë e ka qenë e parakohshme që të parashihet si prioritet strategjik i Bankës zhvillimi i konkurrencës dhe përfshija e sektorit privat në sektorin e infrastrukturës në Kosovë.
- **Kufizimet biznesore për financimin direkt për korporatat lokale** – Problemet që ndërliken me transparencën financiare, praktikat e dobëta korporative, shkalla e lartë e borxhit dhe pronësia në asetete, posaçërisht mes NVM-ve kanë kufizuar aftësinë e Bankës për ofrimin e financimit direkt për një numër të madh të kompanive.
 - Mbështetja në kuadër të Programit për Këshillimin e Bizneseve të Vogla për NVM do të vazhdojë të përmirësojë qeverisjen korporative dhe menaxhimin financiar, planifikimin e biznesit, kontabilitetin dhe të fokusohet në zhvillim përfshirës, rritje të konkurrueshmërisë dhe promovim të tregtisë.

- **Mjedisi sfidues afarist** – Mungesa serioze e kapaciteteve administrative, ndërprerja e energjisë elektrike dhe korrupsioni i gjithanshëm janë duke penguar IHD dhe janë duke e limituar numrin e projekteve që mund të mbështeten.
 - Banka është duke u përpjekur që ti adresojë këto çështje si anëtarë e Këshillit të Investitorëve Evropian, që është organi i ngarkuar për zhvillimin e propozimeve për përmirësimin e mjedisit afarist.
- **Kufizimet për financimin direkt të komunave** – Banka ka hasur në disa vështirësi lidhur me kredi dhënie direkte për komunat. Komunat nuk mund të hyjnë në borxhe 1) përveç nëse kanë marrë opinione të pakualifikuara të auditimit nga Auditori i Përgjithshëm si pjesë e auditimeve të detyrueshme gjatë së paku dy viteve të mëparshme dhe 2) ato mund të marrin hua vetëm për investime kapitale në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Në përgjithësi, komunat e Kosovës marrin 57 përqind të të ardhurave të tyre nga grantet e kushtëzuara ose të caktuara nga Qeveria qendrore (Banka Botërore), varësisht nga transferet shtetërore nga buxhetet kapitale dhe ato operative.

2 MJEDISI OPERACIONAL

2.1 Konteksti politik

Koalicioni aktual qeverisës, “*koalicioni i madh*”, është krijuar në fund të vitit 2014. Koalicioni përbëhet nga dy partitë më të mëdha politike – Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), si dhe nga partitë që përfaqësojnë minoritetet etnike. Ky koalicion i gjerë ka shumicë solide në Kuvend. Qeveria, e udhëhequr nga Kryeministri Isa Mustafa nga LDK, ka pasur një riorganizim të vogël pas zgjedhjes së Zëvendës Kryeministrit të Parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme Hashim Thaçit si President i Kosovës (i inauguruar me 7 Prill 2016).

Pavarësisht nga orientimi i përgjithshëm pro-reformator i qeverisë dhe shumicës së mjaftueshme parlamentare, situata politike vazhdon të jetë e rënduar. Vështirësitë me të cilat ballafaqohet Kosova, që janë të përbashkëta me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshijnë kulturën e pabarabartë të dialogut politik dhe zhvillimit të konsensusit. Këto vështirësi kanë rezultuar në kriza të kohëpaskohshme politike. Në vitin 2014, pas zgjedhjeve parlamentare, Kosova është qeverisur nga një qeveri kujdestare për pothuajse gjashtë muaj.

Një krizë tjetër politike ka filluar në vjeshtën e vitit 2015, kur koalicioni i partive opozitare të orientuara nga nacionalizmi kanë filluar një bllokadë të Kuvendit dhe një seri protestash të dhunshme anti-qeveritare. Opozita në veçanti ka kundërshtuar marrëveshjet e fundit të nënshkruara me Serbinë në kuadër të dialogut të vazhdueshëm të ndërmjetuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve, si dhe marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Partitë opozitare kanë kërkuar nga Qeveria që të tërheqë nënshkrimin e marrëveshjes së kompromisit me Serbinë që hap rrugën për krijimin e asociacionit/komunitetit të komunave me shumicë etnike Serbe dhe ka kërkuar zgjedhje të parakohshme. Megjithatë ka pak mundësi që zgjedhjet të zhvillohen në vitin 2016, ndërprerja në punën e Kuvendit e shkaktuar nga protestat tashmë ka rezultuar në grumbullimin e një numri të madh të projektligjeve që kërkojnë miratim nga Kuvendi.

Përafrimi i vazhdueshëm me BE vazhdon të jetë synimi kryesor i jashtëm i reformave. Kosova viteve të fundit ka përshpejtuar procesin e integritimit në BE. Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE në Tetor 2015. MSA është aprovuar nga Parlamenti

Evropian me 21 Janar 2016 dhe ka hyrë në fuqi me 1 Prill 2016. Hyrja në fuqi e MSA paraqet një arritje të rëndësishme. Përveç krijimit të marrëdhënies kontraktuese për zbatimin e standardeve Evropiane në fushat e ndryshme të mbuluar nga MSA si dhe krijimin e një kanali shtesë për përfitim nga reformat, ky është sinjal pozitiv edhe për investorët e jashtëm. Përfundimisht, ky është një sinjal i rëndësishëm politik për shtetin dhe për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, që e ripohon të ardhmen Evropiane për tërë rajonin.

Shih Shtojcën 1 ku është bërë një vlerësim i hollësishëm politik në kontekstin e Nenit 1.

2.2 Konteksti makroekonomik

Kosova është shteti më i varfër i Ballkanit Perëndimor. I rregulluar sipas paritetit të fuqisë blerëse, BPV për kokë banori në Kosovë është më e ulëta nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, dhe pothuajse përgjysmë me shtetet e Evropës Lindore. Kjo zbrazëti paraqet pikën e ulët fillestare të tranzicionit, duke qenë se Kosova vetëm ka qenë pjesa më e varfër e ish Jugosllavisë, kombinuar me historinë e konfliktit, dobësitë serioze institucionale, problemet në arsim dhe infrastrukturë bazike. Njëkohësisht, potenciali i Kosovës për të nxënë hapin është i madh. Papunësia, pabarazia dhe sfidat në zhvillimin e një ekonomie produktive për përmbushjen e synimeve globale zhvillimore janë realitetet më të vështira me të cilat ballafaqohet Kosova, siç është theksuar në programin e Qeverisë të miratuar në Mars 2015 dhe në Strategjinë për Zhvillim Kombëtar të miratuar në Janar 2016, që fokusohen në krijimin e vendeve formale të punës, temë kjo e cila është bërë urgjente pas eksodit masiv të pothuajse 5 përqind të popullatës së Kosovës drejt shteteve të BE-së gjatë “*dimrit të pakënaqësisë*” në 2014-2015. Ky migrim ka qenë reflektim i pesimizmit lidhur me sundimin e ligjit dhe perspektivën për punësim.

Në anën pozitive, ekonomia Kosovare është menaxhuar mirë, pasi që ka qenë më e qëndrueshme se sa ekonomitë e shteteve fqinje të Ballkanit Perëndimor gjatë krizës globale dhe asaj të Eurozonës, duke u rritur me mesatarisht 3.5 përqind të vit gjatë periudhës 2009-2013, dhe duke qenë njëra nga vetëm katër shtete Evropiane që kanë pasur shkallë pozitive të rritjes në secilin vit gjatë periudhës pas krizës. Megjithatë, një eksplodim në termocentralin më të madh të Kosovës në vitin 2014 ka ndalur përkohësisht prodhimin e energjisë elektrike si dhe prodhimtarinë e furnizuesit kryesor të këtij sektori, industrisë minerare, duke shkaktuar kështu ngadalësim të rritjes ekonomike deri në 1.2 përqind në vitin 2014. Gjithashtu, bllokada politike gjashtë mujore pas zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në Qershor 2014 ka ndikuar negativisht në ekonomi dhe në shtyrjen e investimeve private.

Ekonomia është rikthyer në vitin 2015 me rritje prej 3 përqind. Kjo rritje është fuqizuar nga kërkesa e brendshme e fuqishme, më investimet të cilat kanë kontribuar më së shumti. Investimet private janë mbështetur nga IHD të fuqishme (përafërsisht 5 përqind të BPV, duke përbërë kështu shkallën më të lartë në 4 vitet e fundit), ndërkohë investimet publike janë orientuar kryesisht në seksionin e autostradës prej 65 kilometra nga Prishtina deri në kufirin me Maqedoninë. Konsumi privat është nxitur edhe nga rritja e remitencave (nga diaspora e madhe e Kosovës, shumica e të cilës ndodhet në Gjermani dhe Zvicër) dhe kreditimi i fuqishëm bankar.

Perspektiva për rritje ekonomike në kuptim afat-mesëm mbetet relativisht pozitive. Rritja ekonomike parashihet të përshpejtohet në vitet e ardhshme, duke u ngritur në 3.5 përqind në vitin 2017 dhe duke qëndruar në këtë nivel ose duke e tejkaluar atë në 2-3 vitet e mëpasshme me zhvillimin e mëtutjeshëm të reformave dhe rritjen e investimeve. Rritja pritet të mbështetet nga 1) remitencat të cilat do të vazhdojnë të mbështesin konsumin privat (mbështetja në remitenca është e lartë, me përafërsisht 16 përqind të BPV-së që vije nga remitencat personale);

2) investimet e mëdha private dhe 3) investimet jetike publike në infrastrukturë të transportit dhe enegjetikës. Një sfidë kyçe për Kosovën do të vazhdojë të jetë rritja e kapaciteteve prodhuese dhe të eksportit të ekonomisë. Për arritjen e këtij qëllimi duhet të adresohet shkalla e lartë e papunësisë strukturore, krijimi i sigurisë energjetike dhe përmirësimi i mjedisit afarist. Rikuperimi i kompleksit mineral Trepça mund të ndikojë në masë të konsiderueshme në potencialin zhvillimor të Kosovës përmes rritjes së eksporteve, krijimin e një zingjiri të ri të prodhuesve dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Në Korrik 2015, autoritetet dhe FMN kanë nënshkruar Programin Stand-By (PSB) më kohëzgjatje prej 22 muajve dhe vlerë 185 milion Euro. Ky program ka tri objektiva kryesore: (i) ruajtjen e deficitit dhe borxhit të ulët publik përmes kontrollimit të shpenzimeve aktuale, dhe duke krijuar njëkohësisht hapësire fiskale për shpenzime kapitale që ndikojnë në zhvillim; (ii) largimin e pengesave kryesore strukturore për zhvillimin, duke përfshirë krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat dhe për investime, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së Kosovës dhe fuqizimin e ndërmjetësimit bankar; dhe (iii) nxitjen e mbështetjes nga kreditorët e tjerë multilateral dhe bilateral. Në Janar 2016, Bordi Ekzekutiv i FMN ka përfunduar Shqyrtimin e Parë të këtij programi dhe ka vlerësuar se programi është në rrugë të drejtë për tu ndihmuar autoriteteve për ruajtjen e indikatorëve të favorshëm fiskal. Nivelet e borxhit publik janë të ulëta sipas standardeve rajonale (ligji për borxhin publik e ka përcaktuar proporcionin maksimal të borxhit me BPV në 40 përqind) dhe, sipas një klauzole të investimeve në PSB, Kosova ka 450 milion Euro për shpenzime kapitale. Megjithatë, më siguri do të ketë nevojë për hapësirë të konsiderueshme fiskale shtesë nëse procedohet me projektin e termocentralit të ri (Kosova C). Gjithashtu, huamarrja e jashtme nga Qeveria, duke përfshirë nga IFN-të, kërkon ratifikim nga Kuvendi me shumicë të kualifikuar.

Sektori bankar është dëshmuar si sektor i qëndrueshëm duke marrë parasysh rrethanat e jashtme. Duke marrë parasysh sistemin financiar që është i fokusuar shumë në banka, autoritetet janë duke ndërmarrë hapa kyç për t'i bërë bankat Kosovare më të sigurta, duke përfshirë përmes miratimit të një kornize për asistencë emergjente të likuiditetit, duke bërë progres për mbikëqyrjen e bazuar në vlerësim të rrezikut për të gjitha bankat, si dhe një kornizë të re të kujdesshme të politikave makroekonomike. Në krahasim me shumicën e shteteve të tjera në Ballkanin Perëndimor, sistemi bankar i Kosovës karakterizohet nga disa tipare pozitive:

- Posedon strukturë të financimit që bazohet në depozita (proporcioni i kredive me depozita ka qenë 74.8 përqind në fund të vitit 2015);
- Është mirë i kapitalizuar (përshtatshmëria e kapitalit qëndron në 19 përqind në fund të vitit 2015) dhe ka mjaft mbrojtje të likuiditetit, pa u mbështetur në financim të jashtëm edhe pse dominohet nga bankat në pronësi të huaj (që përbëjnë rreth 90 përqind të të gjitha aseteve bankare, me dy bankat më të mëdha ProCrediti Gjerman dhe Raiffeisen Austriak, secila prej tyre me 26 përqind të tregut) dhe;
- Përqindja Kredive Jo-Performuese (KJP) në sistemin financiar është e ulët në krahasim me standardet rajonale. Dispozitat për humbjen e kredive kundrejt kredive të klasifikuara dobët vazhdojnë të jenë të larta.

Rreziqet e brendshme për rritjen rezultojnë nga kapaciteti i dobët institucional, shkalla e lartë e informalitetit, të drejtat e paqarta pronësore, korrupsioni si dhe mungesa e stabilitetit politik, siç është bllokada e vazhdueshme e funksionimit normal të Kuvendit nga opozita. Gjithashtu, përfitimet marginale të shtytësve të mëparshëm të rritjes, duke përfshirë ndihmën e jashtme dhe remitencat parashikohet që të zvogëlohen dhe, pa një transformim strukturor dhe përmirësim të produktivitetit, Kosova do të ketë vështirësi që të përballojë forcat e konkurrencës së tregut që

ndërlidhen me anëtarësimin në BE si dhe presionet socio-ekonomike që ndërlidhen me profilin e ri demografik të saj.

Rreziqet e jashtme përfshijnë vështirësitë e vazhdueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në Eurozonë, që janë tregjet kryesore për eksportet Kosovare. Mungesa e stabilitetit politik në veçanti mund të ndikojë në zbatimin e Programit të FMN, pasi që për zbatimin e këtij programi, Kuvendi duhet të funksionojë në mënyrë normale për miratimin ose ndryshimin e legjislacionit të nevojshëm për zbatimin e PSB. Njëkohësisht, mungesa e stabilitetit politik mund të dëmtojë besimin e investitorëve.

2.3 Konteksti i reformave strukturore

Në mënyrë që sektori privat të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme të klimës së investimeve, zhvillimit të qeverisjes dhe sundimit të ligjit, rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë si dhe përmirësimit të infrastrukturës publike si dhe adresimin e zbrazëtirave në sektorin energjetik. Këto reforma janë ngushtë të ndërlidhura me procesin e integrimeve në BE si instrumente kyçe të politikave për tërheqjen e investimeve direkte të shkallës dhe madhësisë së nevojshme për rritjen e produktivitetit të ekonomike, gjenerimin e rritjes së nevojshme ekonomike për “nxënien e hapit” dhe përfundimisht reduktimin e shkallës së lartë të papunësisë dhe varfërisë brenda Kosovës. Prioritetet tjera kyçe përfshijnë adresimin e mospërputhshmërisë së aftësive të nevojshme me kërkesat e tregut të punës dhe sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Sfidat më të mëdha të Kosovës janë në sigurimin e energjisë së qëndrueshme, sigurinë energjetike dhe mungesën e kapaciteteve energjetike. Anketa e Fundit e Performancës së Ndërmarrjeve në Mjedisin Afarist (BEEPS) ka konstatuar se furnizimi me energji elektrike është njëra nga tri pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen kompanitë vendore dhe është duke penguar investitorët potencial që të zhvendosin veprimtarinë e tyre në Kosovë, së bashku me korrupsionin dhe sektorin informal. Kosova nuk ka furnizim të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Termocentralet e vjetruara shkaktojnë më së shumti ndotje në Ballkanin Perëndimor, duke shkaktuar ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike dhe duke penguar kështu rritjen dhe investimet. Një raport i fundit i USAID tregon se furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike është duke u kushtuar bizneseve Kosovare pothuajse 300 milion çdo vit në produktivitet të humbur. Sfidat tjera kryesore në sektorin e energjisë përfshijnë modernizimin e rrjetit të transmissioinit dhe reduktimin e humbjeve jo-teknike në rrjetin e distribucionit. Në kombinim me problemet në pjesën e ofertës, edhe eficientia e energjisë nga ana e kërkesës, të të gjithë sektorët (NVM-të privat, ndërtesat rezidenciale, institucionet publike, etj.) paraqet një sfidë të konsiderueshme pasi që intensiteti i përgjithshëm energjetik i Kosovës vazhdon të jetë në masë të konsiderueshme mbi mesataren e BE (dhe ndër më të lartat në Ballkanin Perëndimor).

Një sfidë e rëndësishme është **sigurimi i kredive për ato NVM** të cilat kanë nevojë për kredi mirëpo janë të kufizuara për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, nivelit të lartë të informalitetit, mungesës së historisë biznesore ose të kreditorëve, mungesës së kolateralit si dhe zhvillimit të ulët të tregjeve kapitale. Normat e larta të interesit karshi normave depozitore pasqyrojnë perceptimin e lartë të rrezikut kreditor nga ana e bankave komerciale për shkak të nivelit të lartë të informalitetit në sektorin korporativ dhe mjedisin ligjor.

Pavarësisht ekzistimit të një regjimi të tregtisë së lirë, **integrimi Kosovës në tregjet rajonale ka mbetur prapa.** Investimet e mëdha në infrastrukturën energjetike dhe të transportit në rajon, së

bashku me reformat përkatëse, mund të ndihmojnë të rritjen e ndërlidhjes dhe tregtisë dhe investimeve me shtetet e rajonit. Kosova ballafaqohet me deficit shumë të latë dhe ka nivel më të ulët të eksporteve në rajon, shenjë kjo e qartë e vështirësive me të cilat ballafaqohen kompanitë Kosovare në tregun ndërkombëtar që pasqyron edhe vështirësitë me infrastrukturën publike dhe pengesat në mjedisin afarist. Këto përfshijnë Barrierat Jo-Tarifore për tregti, siç janë politikat qeveritare të prokurimit dhe masat anti-damping, barrierat teknike për tregti dhe standardet/masat sanitare dhe fitosanitare.

Privatizimi i NPSH-ve të mbetura, menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, **ka bërë pak progres** dhe nuk janë gjeneruar të ardhura nga privatizimi në vitin e kaluar pasi që Agjencia nuk ka qenë funksionale.

Në prill 2015, Qeveria ka vendosur që të shtyj ende privatizimin e kompanisë së telekomunikacionit PTK. Sipas Strategjisë për Zhvillim Kombëtar është krijuar një Grup Punues për të punuar në hartimin e metodologjisë për privatizimet e ardhshme. 18 NPSH, duke përfshirë PTK dhe minierat e Trepçës, ka shumë mundësi që do të vazhdojnë të jenë nën menaxhimin e qeverisë qendrore gjatë periudhës së ardhshme të strategjisë. Kompleksi minerar aktualisht mbahet në mirëbesim dhe është në përgatitje për shitje nga një agjenci e krijuar nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Megjithatë, kompleksi minerar vuan nga problemet e pronësisë të cilat e kanë vështirësuar privatizimin e tij.

Megjithatë, disa reforma aktualisht janë në proces:

- **MSA me BE-në**, që ka hyrë në fuqi së fundmi, sugjeron se Kosova është e përkushtuar për plotësimin e standardeve të caktuara lidhur me rregulloret dhe mjedisin e përgjithshëm afarist. Si marrëdhënia e parë kontraktuese mes Kosovës dhe BE, kjo marrëveshje paraqet një arritje të konsiderueshme për përafrimin me BE; shërben si kornizë për bashkëpunim dhe dialog politik mes dy palëve, duke formalizuar qasjen preferenciale të Kosovës në tregun e BE në këmbim me zotime specifike për reforma në fushat siç janë konkurrenca dhe ndihma shtetërore.
- Në kuadër të Klauzolës së Investimeve në Programin Stand-By të FMN, Kosova ka 450 milion Euro në dispozicion për shpenzime kapitale të financuara nga donatorët.
- Qeveria ka miratuar **Strategjinë për Zhvillim Kombëtar 2016-2021** që ka për qëllim të krijojë bazën për zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirës, si dhe përsheptimin e integritetit të Kosovës në BE përmes reformave përkatëse. Kosova gjithashtu ka krijuar **Komitetin Kombëtar për Investime (KKI)**, të kryesuar nga Ministria për Integritet Evropian dhe Ministria e Financave, si dhe një **Listë të Vetme të Projekteve** që ndihmon në caktimin e prioritetëve për projektet e ardhshme madhore infrastrukturore, duke përfshirë ndikimin e tyre fiskal.
- Kosova gjithashtu ka dorëzuar **Programin e Dytë të Reformave Ekonomike** tek autoritetet e Bashkimit Evropian për periudhën 2016-2018, hap ky i rëndësishëm për thellimin e dialogut ekonomik me BE.
- Reformat kyçe që kanë për qëllim përmirësimin e kornizës ligjore, fuqizimin e administratës publike, zhvillimin e institucioneve dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike që rezultojnë në krijimin e parakushteve të nevojshme për zhvillim përfshirës dhe të qëndrueshëm. Pavarësisht nga kjo, mjedisi i përgjithshëm afarist nuk është përmirësuar në masë të mjaftueshme sa që të përmirësojë dukshëm punësimin format, kushtet sociale si dhe mirëqenien socio-ekonomike të segmenteve më të pa favorizuara të shoqërisë;
- Së fundmi, ndërtimi i linjës së koneksionit 400kV mes Shqipërisë dhe Kosovës do të mundësojë Kosovës shkëmbimin e energjisë elektrike me Shqipërinë dhe

maksimalizimin e shfrytëzimit të hidrocentraleve të Shqipërisë gjatë stinës së dimrit dhe termocentraleve të Kosovës gjatë stinëve më të ngrohta. Gjithashtu, Kosova dhe Shqipëria kanë njoftuar për fillimin e punës për krijimin e një tregu të përbashkët energjetik për të dyja shtetet.

2.4 Qasja në financim

Burimet private të kapitalit

Sistemi bankar i Kosovës është relativisht i vogël dhe aktualisht është i kapitalizuar mirë, likuid dhe profitabil. 10 banka operojnë në treg – 6 banka komerciale (4 banka më pronar të huaj dhe 2 banka me pronar vendor) dhe 4 degë të bankave të huaja me asete totale prej 3.4 miliard ose 60 përqind të BPV. Sistemi bankar është kryesisht në pronësi të huaj, dhe dominohet nga bankat Gjermane (ProCredit), Austriake (Raiffeisen), Sllovene (NLB) dhe Turke (TEB). TMK në tërë sistemin bankar është mbi 18 përqind, proporcioni i likuiditetit është shumë mbi minimumin e kërkuar nga rregullatori dhe kthimi në kapital është mbi 25 përqind. Kualiteti i aseteve është i pranueshëm. KJP-të janë më të ulëtat në rajon dhe më trend të rënies (6.2 përqind në fund të vitit 2015), si rezultat i standardeve më rigorozë kredituese, përmbarimit më efektiv për kreditë problematike dhe rritjes së përgjithshme të kreditimit nga bankat komerciale. Gjithashtu, për shkak të shkallës relativisht të ulët të integritetit ndër-kufitar me Sistemin Financiar Evropian dhe bazën e ulët të eksportit, sektori financiar ka mbetur relativisht stabil gjatë krizave. Megjithëse remitencat nga diaspora Kosovare kanë rënë fillimisht në vitin 2009, ato janë kthyer fuqishëm dhe kontribuojnë në stabilizimin e depozitave.

Megjithatë, kosto e financimit konsiderohet barrierë e madhe për zhvillim, duke marrë parasysh proporcionin e ulët mes kredive me BPV, shpërndarjen e lartë në norma të interesit, sjelljen jo-konkurruese në tregun bankar dhe nivelin e lartë të rrezikut në përmbushjen e kontratave (ERP, 2016). Qasja në financa është pengesë kyçe për shumicën e bizneseve në Kosovë. Sipas Anketës së fundit për Performancën e Ndërmarrjeve në Ambientin Afarist (BEEPS V) të zhvilluar në vitin 2013, përqindja e kompanive të cilat e kanë identifikuar qasjen në financim si njërën nga pengesat kryesore është rreth 40 përqind. Kjo është kryesisht për shkak të mjedisit të dobët ekonomik në përgjithësi, shkallës së lartë të informalitetit dhe mungesës e kapaciteteve të NVM-ve për përgatitjen e projekteve të financueshme (shkalla e edukimit financiar dhe përqindja e kompanive që mbajnë kontabilitetin e audituar është ndër më të ulëtat në Ballkanin Perëndimor).

Posaçërisht shqetësuese është niveli i ulët i aktivitetit kreditues në Kosovë. Sipas Indikatorëve Botëror të Zhvillimit (IBZH), niveli i kreditimit vendor në Kosovë i ofruar nga sektori financiar, si përqindje e BPV-së, vazhdon të jetë vetëm 18 përqind për periudhën 2009-2012, krahasuar me 46 përqind në IRJ Maqedonisë, 56 përqind në Serbi, 66 përqind në Bosnjë dhe Mal të Zi, 90 përqind në Kroaci dhe 94 përqind në Slloveni. Sipas analizës së BERZH për Zbrazëtitrat Gjimore, zbrazëtitrat gjimore në qasjen në financa gjithashtu janë shumë të mëdha.

Kosova përdor Euron si valutë të saj megjithëse një pjesë e aktiviteteve bankare gjithashtu zhvillohen në dinarë Serb në pjesën veriore të Kosovës. Proporcioni i kredive me depozitat është konservativ dhe ekziston një skemë bazike për sigurimin e depozitave që mbështetet nga një mekanizëm kreditues i BERZH. Ekspozimi i depozitave dhe kredive janë relativisht shumë të koncentruara, duke reflektuar kështu bazën shumë të ngushtë të investitorëve dhe të huamarrjes në treg.

Institucionet Jo-Bankare Financiare – posaçërisht IMF – janë aktive mirëpo përbëjnë një pjesë të vogël të kreditimit të përgjithshëm (4 përqind) në sektorin financiar të Kosovës, kryesisht në sektorin e bujqësisë. Ekziston një disbalancë e qartë gjinore sa i përket qasjes në financa, ku ka një numër shumë më të vogël të femrave që kanë xhirollogari bankare dhe qasje në financim për NVM. Tregu i sigurimeve është i vogël dhe proporcioni i premive të sigurimit me BPV është shumë më i ulët se i shteteve të rajonit të EJL – një sigurues i jetës dhe 10 sigurues jo të jetës operojnë, më shumicën e premive të mbledhura nga sigurimi i automjeteve. Ligji për sigurimet është përpjekur që të fuqizojë kornizën ligjore dhe rregullatore, ka ende mjaft probleme në implementimin dhe mbikëqyrjen e kësaj industrie.

Tregjet e kapitalit vazhdojnë të mos jenë të zhvilluara. Ekziston një treg bazik për letrat me vlerë të qeverisë në të cilin bëhet emetimi i bonove të thesarit dhe bondeve qeveritare me kohëzgjatje 2, 3 dhe 5 vjeçare ku 8 banka komerciale veprojnë si diler primar. Bankat dhe fondet pensional janë blerësit kryesor dhe ka pak aktivitete në tregun sekondar duke qenë se sistemi financiar ka tepriçë të likuiditetit dhe ka mungesë të opsioneve të tjera të investimeve brenda Kosovës. Në Kosovë nuk ka treg të kapitalit – korporatat zakonisht janë të vogla, ndërsa ato pak korporata që ekzistojnë me madhësi të mesme nuk janë të gatshme që të hyjnë në bursë për shkak të rritjes së kërkesave të raportimit dhe ndarjes së informacioneve që kërkohet për kompanitë e listuara. Kjo gjithashtu paraqet problem edhe për çështjet e bondeve korporatave publike. Përderisa një bursë vetëm për Kosovë nuk është opsion, ekziston mundësia për lidhje të ndonjë marrëveshje për hyrjen në ndonjërin nga tregjet e përfshira në Projektin EJL Link që gjithashtu ka për qëllim rritjen e nivelit të transaksioneve ndër-kufitare të kapitalit në rajon. Popullsia e vogël gjithashtu paraqet barrierë të konsiderueshme për zhvillimin e një tregu vendor të kapitalit.

Financimi nga bankat multilaterale dhe bilaterale dhe nga BE²

Disa banka multilaterale zhvillimore (BMZH) dhe institucione financiare bilaterale janë aktive në Kosovë, me nivele të ndryshme të investimeve dhe prioritete të ndryshme.

Bashkimi Evropian është donatori më i madh për Kosovën, me më shumë se 3 miliard Euro të kontribuara deri më tani. BE ka siguruar asistencë financiare për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit gjatë periudhës 2007-2013, me gjithsej 673.9 milion Euro. 38.5 milion Euro janë siguruar përmes IPA në vitin 2013 për mbështetjen e dialogut Prishtinë-Beograd, proceset e normalizimit dhe integritetit në Kosovë, duke përfshirë dialogun për viza. Sipas IPA II, Kosova do të vazhdojë të përfitojë nga asistenca para-anëtarësimit për periudhën 2014-20, në shumën totale të parashikuar prej 645.5 milion Euro, që është e dizajnuar për të mbështetur sektorët në vijim: (i) Sundimi i Ligjit; (ii) Bujqësia; (iii) Energjia; (iv) Reforma e Administratës Publike, dhe (v) Konkurrueshmëria dhe Inovacioni.

Deri më tani, **Banka Botërore** ka kontribuar me afërsisht 400 milion dollarë amerikan në më shumë se 30 projekte në Kosovë në një gamë të gjerë të sektorëve, me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e menaxhimit mjedisor. Që nga viti 2012, Banka Botërore ka zotuar 107 milion dollarë amerikan kryesisht për projekte të infrastrukturës rreth ujësjellësit, transportit, menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe energjisë, kjo e fundit paraqet element kyç për asistencën e Bankës Botërore në Kosovë. Sa i përket projekteve në fushën e eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtitshme, portofoli

² Kjo pjesë fokusohet në financimin në shkallë të lartë, ndërsa aktivitetet tjera të donatorëve dhe aktivitetet e BT janë përshkruar në Aneksin 6.

aktual i Bankës Botërore përfshin gjithsej 52.6 milion dollarë amerikan për korrigjimin e problemeve mjedisore që kanë rezultuar nga hedhja e hirit të prodhuar nga Termocentrali më i vjetër i Kosovës dhe me qëllim të reduktimit të konsumit të energjisë dhe përdorimit të lëndëve djegëse fosile në ndërtesat publike dhe mbështetjen e Kosovës në përmirësimin e mjedisit të politikave dhe atij rregullator për energjinë e ripërtitshme dhe eficiencën e energjisë (32.5 milion dollarë amerikan). Banka Botërore gjithashtu ka qenë aktive në dizajnin e projekteve për përmirësimin e mjedisit afarist dhe konkurrues dhe portofoli i saj në këtë fushë përfshin, ndër tjerash, një projekt prej 7.8 milion dollarë amerikan për fuqizimin e infrastrukturës së tregut financiar (duke përfshirë ofrimin e financimit fillestar për Fondin e Kosovës për Sigurimin e Depozitave) si dhe një projekt gjithëpërfshirës prej 8 milion dollarësh amerikan për modernizimin e sektorit publik. Gjithashtu, me qëllim të mbështetjes për zhvillimin e tregut të tokës dhe pronës në Kosovë, Banka Botërore është duke financuar Projektin për Regjistrimin Kadastral të pasurisë së patundshme dhe është duke mbështetur Qeverinë në bujqësi dhe zhvillim rural me 44 milion dollarë amerikan për promovimin e konkurrueshmërisë dhe rritjes në nën-sektorët e gjedhëve dhe hortikulturës gjatë dekadës së ardhshme. Banka Botërore gjithashtu është duke bashkëpunuar me Qeverinë për zhvillimin e Programit të Ekonomisë Digjitale në Kosovë, komponentët kryesore të së cilës janë të bazuara në projekte të cilat do të zhvillojnë infrastrukturën përkatëse broadband si dhe kapitalin njerëzor dhe bizneset digjitale për ta përfshirë Kosovën në ekonominë e ardhshme digjitale. Banka Botërore tashmë ka filluar përgatitjet për Kornizën e re Strategjike për Kosovën për periudhën 2016-20.

Shërbimet e këshillimit të **Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC)** në Kosovë kanë për qëllim përmirësimin e klimës së investimeve dhe performancën e sektorit privat si dhe shtytjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës. Kosova është bërë anëtare dhe aksionare e IFC-së në vitin 2009 dhe që nga atëherë, zotimi i IFC-së ka arritur në 389.8 milion dollarë amerikan. Investimet e IFC-së përfshijnë Projektin për Energji të Ripërtitshme në Ballkan (BREP), program këshillues rajonal prej 7 milion dollarësh amerikan për të mundësuar krijimin e tregut të energjisë së ripërtitshme (ERP) dhe mbështetjen e zhvillimit dhe financimi të iniciativave për energji të ripërtitshme në shtetet e Ballkanit Perëndimor. IFC gjithashtu financon Projektin për Klimën e Investimeve, projekt prej 2.5 milion dollarësh amerikan për ndërlidhjen në mënyrë programore të politikave rregullatore të biznesit, politikave të investimeve dhe punës specifike në agrobiznes për maksimalizimin e ndikimit. IFC gjithashtu ka investuar në tregjet financiare, prodhimtarinë e përgjithshme dhe sektorin minerar. Qeveria e Kosovës së fundmi e ka caktuar IFC-në si Këshilltarin e Transaksionit për Projektin e ri Kosova C.

FMN kryesisht është fokusuar në disa reforma strukturore që kanë për qëllim rritjen e potencialit zhvillimor të Kosovës dhe largimin nga modeli zhvillimor i bazuar në remitencë. Angazhimi i FMN deri më tani është fokusuar kryesisht në:

- Mbështetjen e Klauzolës së Investimeve që i përjashton investimet e financuar nga privatizimi nga kufiri i deficitit të rregullës fiskale si dhe krijimi i hapësirës fiskale për projektet e reja investive në infrastrukturë të financuara nga donatorët (duke përfshirë RR10 të financuar nga BERZH/BEI/BE);
- Fuqizimin e prokurimit publik përmes institucionalizimit të e-prokurimit dhe centralizimit të praktikave të prokurimit;
- Mbështetjen e amendamentimit të Ligjit për Procedurën Përmbarimore për zvogëlimin a barrës për gjykatat; dhe
- Largimin e pengesave strukturore për kreditim, përmes eliminimit të pengesave ligjore dhe gjyqësore që i pengojnë bankat në mbështetje më të madhe të zhvillimit ekonomik.

BEI në vitin 2015 ka nënshkruar Marrëveshjen Kornizë me Kosovën që i mundëson financimin e projekteve prioritare, në veçanti në fushën e mjedisit, transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike. BEI është duke mbështetur modernizimin e sistemit hekurudhor përmes një kredie prej 42 milion eurove për modernizimin e pjesës së Kosovës të Linjës Hekurudhore 10, kredia e parë e BEI për sektorin publik në Kosovë. Ndër tjera, projekti gjithashtu financohet nga një kredi prej 40 milion euro nga BERZH.

Përfundimisht, Kreditanstalt für Wiederaufbau (**KfW**) është duke e ndihmuar Kosovën që nga viti 1999 për krijimin e furnizimit të energjisë në mënyre efikase dhe të qëndrueshme, modernizimin e infrastrukturës komunale dhe promovimin e NVM-ve. Sektori bankar në Kosovë është mbështetur nga KfW për 15 vite, duke përfshirë mbështetjen e themelimit të ProCredit Bank – në të cilën BERZH ka qenë edhe njëri nga aksionarët themelues – dhe Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK). Në sektorin e energjisë, KfW ka mbështetur rehabilitimin e dy termocentraleve me qymyr dhe në vitin 2009 KfW ka financuar linjën e transmissioinit për në Shqipëri, që ka kontribuar në sigurimin e furnizimit të energjisë elektrike në Kosovë. Sa i përket infrastrukturës komunale, KfW ka qenë e përfshirë në rehabilitimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemeve sanitare në Gazivodë dhe në komunën e Leposaviqit. Aktualisht, KfW së bashku me BE janë duke financuar një investim në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza të Prishtinës, me qëllim të mbrojtjes së furnizimit higjienik me ujë të pijshëm.

2.5 Mjedi afarist dhe konteksti ligjor

Mjedi afarist

Është bërë deri diku progres në reformat e mjedisit afarist, posaçërisht në përmirësimin e kornizën themelore ligjore dhe strukturave institucionale, pjesërisht me mbështetjen e Bankës Botërore, mirëpo ende ka shumë për tu bërë. Përkushtimi i Qeverisë për përmirësimin e mjedisit afarist është njohur nga Raporti i fundit për të Bërit Biznes (Doing Business) i Bankës Botërore, sidomos në fushat sikurse fillimi i një biznesi, në të cilën Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm si dhe rangimi i përgjithshëm është përmirësuar me 40 pozita në dy vitet e fundit. Megjithatë, Kosova ende vazhdon të jetë prapa shteteve të rajonit në shumicën e indikatorëve të këtij raporti. Kërkohe vullnet më i fuqishëm politik dhe përmirësim i kapaciteteve institucionale për adresimin e disa nga kufizimeve kryesore për investime në Kosovë: konkurrenca e padrejtë nga kompanitë informale, korrupsioni, zbatimi i dobët i kontratave dhe sqarimi i të drejtave pronësore.

Strategjia për Zhvillim Kombëtar e miratuar së fundmi dhe Programi i Reformave Ekonomike pasqyrojnë progresin që ka bërë qeveria në artikullimin e qartë të prioriteteve të reformave dhe në definimin e përkushtimit për ndërmarrjen e veprimeve të konsiderueshme për përmirësimin e klimës investive. Disa nga masat e përmendura në këto dokumente, posaçërisht reforma e sistemit të lejeve dhe licencave, mund të paraqesin reforma të kapshme të cilat lehtësojnë të bërit biznes në Kosovë në afatshkurtër dhe krijojnë dinamikën e nevojshme për reforma të mëtutjeshme.

Gjatë viteve të fundit, autoritetet Kosovare kanë ndërmarrë disa masa për përmirësimin e mjedisit afarist për të nxitur zhvillimin e sektorit privat. Këto masa përfshijnë lehtësimin e procedurave për pagesën e tatimeve, duke e eliminuar tarifën vjetore për leje të biznesit. Qeveria gjithashtu ka përmirësuar procedurat për marrjen e lejeve ndërtimore përmes funksionalizimit të sistemit të inspektimeve në faza, duke reduktuar në masë të konsiderueshme tarifën për leje të

ndërtimit, eliminimin e kërkesës për kontrollimin e projektit kryesor të ndërtimit dhe eliminimin e tarifave për aprovime teknike nga komuna. Qeveria gjithashtu ka përmirësuar zbatimin e kontratave përmes funksionalizimit të sistemit të përmbaruesve privat. Përfundimisht, janë thjeshtësuar procedurat për fillimin e një biznesi përmes krijimit të one-stop-shopeve për regjistrim të bizneseve.

Në anën tjetër, transferimi i pronës është vështirësuar për shkak se autoritetet kanë ngritur tarifën për regjistrimin e transaksioneve pronësore.

Disa donatorë kanë mbështetur Qeverinë në përmirësimin e klimës së investimeve, në vënçi përmes mbështetjes së SECO-IFC – Projekti për Klimën e Investimeve që ka për qëllim përmirësimin e klimës së investimeve për investitorët vendor dhe të huaj përmes Asistencës Teknike dhe lidhjes programore të politikave rregullatorë, politikave të investimeve dhe punës specifike në agrobiznes për rritjen e impaktit. Gjithashtu Banka Botërore është duke planifikuar një kredi IDA që do të lanohet në vitin 2017, dhe që përfshin sigurimin e pajisjeve fizike posaçërisht në fushën e infrastrukturës së cilësisë.

Konteksti ligjor

Sistemi ligjor në Kosovë i është nënshtruar reformave të vazhdueshme në vitet e fundit me qëllim të fuqizimit të kornizës ligjore për bizneset. Megjithëse ka pasur progres të konsiderueshëm, ende ka nevojë për reforma në disa sektorë, siç është theksuar në vlerësimin e BERZH për legjislacionin e qeverisjes korporative dhe praktikën e kompanive.

Pronësia mbi tokën paraqet problem serioz juridik. Deri vonë, sqarimi i të drejtave pronësore ka qenë shumë i vështirë në Kosovë për shkak se shumë prona kanë mbetur të dëmtuara, të shkatërruara ose të braktisura si rezultat i konfliktit në vitin 1999 dhe transaksionet pronësore shpesh nuk janë regjistruar për shkak të problemeve në institucionet qeveritare. Projekti i Bankës Botërore në Kosovë për Pronën e Paluajtshme dhe Kadastrin ka për qëllim që të përmirësojë sistemin e të drejtave pronësore dhe të krijojë sigurinë juridike tek investitorët dhe tu mundësojë qytetarëve që ta përdorin pronën si kolateral për qasje në financim dhe zhvillim të tokës dhe për tregjet e pronës brenda shtetit. Kjo është posaçërisht e rëndësishme duke marrë parasysh faktin që Qeveria dëshiron të krijojë zona industriale, me ç'rast duhet të adresohen pengesat serioze për ofrimin e lokacioneve për bizneset të cilat mund të mbështeten në mënyrë të sigurtë në tokën e blerë për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike.

Sa i përket sektorit financiar, pavarësisht reformave të fundit, korniza ligjore për transaksionet e sigurta ballafaqohet me probleme serioze që janë rezultat i pasigurive në sistemin e regjistrimit të pronës së paluajtshme dhe fushëveprimin të informatave që mbulohen nga regjistri i kredive (kreditë tregtare dhe shërbimet komunale) që dëmton cilësinë e referencave kreditore. Për shkak të vonësive në miratimin e rregulloreve përkatëse, Ligji për Falimentimin ka filluar të zbatohet në praktikë së fundmi dhe lënda e parë është paraqitur në vitin 2015. Duket se ka mungesë të përvojës praktike në çështje të falimentimit dhe ka nevojë për trajnime të mëtutjeshme për gjyqësorin dhe komunitetin ligjor në përgjithësi.

Megjithëse Kushtetuta shprehimisht garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor, Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida në këtë drejtim. Çështjet tjera me të cilat ballafaqohet Kosova në sistemin gjyqësor përfshijnë qasjen e dobët, vonesat dhe numri i madh i lëndëve të pazgjidhura. Përpjekjet për reformë gjyqësore në Kosovë duhet të fokusohen në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe rritjen e kapaciteteve për sistemin e zgjidhjes së kontesteve. Të gjitha aktgjykimet duhet të jenë publike në një sistem me qasje të lehtë dhe me mundësi të kërimit. Kjo do të rrisë

besimin e investitorëve në sistemin e zgjidhjes së kontesteve dhe do të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit afarist.

Disa hapa pozitivë janë ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit, sidomos përmes publikimit të deklaratave të pasurisë së zyrtarëve publik. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2015 përmban një grup të rëndësishëm të rekomandimeve kryesore për autoritetet dhe katër organet kryesore të përfshira në luftën kundër korrupsionit në Kosovë, duke përfshirë edhe prioritizimin e trajtimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë sidomos në prokurimin publik, dhe rishikimin e e ligjit për konfliktin e interesit dhe të gjitha ligjeve të ndërlidhura në përputhje me standardet evropiane.

Edhe pse Kosova ka bërë progres të rëndësishëm në zhvillimin e kornizës së saj për efikasitetin e energjisë, ende mbetet shumë punë për tu bërë për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin e BE në fushën e efikasitetit të energjisë dhe mjedisit (shih Aneksin Ligjor). Kosova shumë pak kohë më parë ka miratuar legjislacionin e ri për energjinë, rregullatorin e energjisë, energjinë elektrike dhe gazin, që ka për qëllim transpozimin e Paketës së Tretë. Një vlerësim i plotë i ndikimit të këtyre akteve ligjore për sektorin përkatës është ende në pritje, mirëpo pritët që hapat e ardhshëm do të jenë përgatitja e akteve nënligjore dhe mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve të rregullatorit në funksion të liberalizimit të tregut.

Në mënyrë të ngjashme, korniza ligjore në fushën e prokurimit publik dhe telekomunikacionit duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE.

Shih Shtojcën 4 për një vlerësim më të hollësishëm të mjedisit ligjor në fusha të caktuara të rëndësishme për strategjinë e investimeve të Bankës.

2.6 Konteksti social

Tregu i punës në Kosovë vuan nga niveli i lartë i papunësisë dhe mundësitë e kufizuara për punësim, posaçërisht nga të rinjtë. Papunësia e të rinjve qëndron në 61 përqind dhe është edhe më e lartë në 71.7 përqind tek femrat e reja. Niveli i papunësisë së të rriturve për femrat e moshës madhore është 41.6 përqind, krahasuar me 33.1 përqind për meshkujt e moshës madhore. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës, vetëm 24.1 përqind e popullsisë në moshë të punës është e punësuar në mënyrë formale, që është shifër shumë më e ulët se në shtetet e rajonit, duke përfshirë Shqipërinë (44.3 përqind) dhe 35 përqind e të rinjve nuk janë në arsim, punësim ose trajnim. Papunësia është gjithashtu shumë e lartë tek femrat, ku 71 përqind e femrave janë të papunësuara. Gjithashtu, përqindja e personave të punësuar në vende të punës të cenueshme është rritur nga 23.6 përqind në vitin 2013 në 24.9 përqind në vitin 2014 dhe punësimi jo formal është shumë i përhapur. Sektori i shërbimeve vazhdon të jetë punëdhënësi kryesor formal në Kosovë (67.1 përqind) krahasuar me industrinë (28.4 përqind) dhe bujqësinë (13.9 përqind).

Vazhdon të ketë shkallë të lartë të varfërisë dhe përjashtimit të minoriteteve etnike. Sipas Bankës Botërore, 29.7 përqind e popullsisë së Kosovës jetojnë nën pragun e varfërisë prej 1.72 Euro në ditë. Varfëria ekstreme është shumë më e përhapur në familjet me fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara dhe familje të udhëhequra nga femrat, dhe në familjet që janë pjesë e minoriteteve etnike (posaçërisht të minoritetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas). Jetëgjatësia mesatare në kohën e lindjes është 71 vite, që është pesë vite më pak se në shtetet e rajonit (dhe

shumë më e ulët se mesatarja në BE prej 78.8 viteve), që është indikacion i shëndetësisë së dobët³. Infrastruktura e arsimit dhe rezultatet e arsimit janë shumë nën standardet e rajonit. Shkalla e regjistrimit në shkollë për grupet etnike minoritare është posaçërisht e ulët: vetëm 77 përqind e fëmijëve jo-Serb (Romë, Shkali, Egjiptas, Turk, Boshnjak dhe të tjerë) në moshat 6 deri në 14 vite regjistrohen në shkollë, krahasuar me mbi 97 përqind për komunitetin Shqiptar dhe Serb në Kosovë. Vazhdon të ketë disproporcion gjinor sa i përket qasjes në arsim, ku vetëm 69 përqind e vajzave nga minoritetet regjistrohen në shkollë.

Ekziston një mospërputhje e konsiderueshme mes aftësive të punëkërkuësve të rinj dhe kërkesave të tregut të punës, posaçërisht në nivelin profesional. Shkalla e papunësisë për personat pa përgatitje shkollëre qëndron në 64.6 përqind, krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme (41.2 përqind) dhe personat që kanë kryer shkollimin terciar (18.9 përqind). Sipas Indikatorëve Kryesor të Tregut të Punës të OBP, 24 përqind e personave të rinj janë të nën-arsimuar dhe nuk janë në gjendje që të ofrojnë kualifikimet e kërkuara për tregun e punës. Pothuajse qereku i bizneseve e kanë raportuar mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar si pengesë për biznesin e tyre. Njëkohësisht, kualifikimi nuk është garanci për personat e rinj që të ofrojnë aftësitë e nevojshme për punëdhënësit; shkalla e kalimit nga shkolla në punë është e ngadaltë, posaçërisht për të diplomuarit nga universitetet. OBP vlerëson se 17.6 përqind e të rinjve të Kosovë janë të mbi-arsimuar, në krahasim me llojet e vendeve të punës të cilat duhet ti pranojnë.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të papunësisë ndër të rinjtë, personat e rinj nga të gjitha nivelet arsimore vazhdimisht dhe gjithnjë e më shumë janë duke zgjedhur që ta braktisin Kosovën, në mënyrë që të përmirësojnë gjendjen e tyre Ekonomike, duke paraqitur probleme kështu edhe me largimin e trurit. Sipas Raportit për Zhvillimin Njerëzor të UNDP të vitit 2014, shumica e diasporës Kosovare jeton në Gjermani dhe Zvicër, pasuar nga Italia, Sllovenia dhe Austria. Shumica e emigrantëve Kosovarë janë të punësuar kryesisht në sektorin privat.

Niveli i **pjesëmarrjes në fuqinë punëtore** të femrave në Kosovë është ndër më të ulët në botë me 21.4 përqind, që është shumë më e ulët se mesatarja e BE prej 60 përqind. Tregu i punës në Kosovës shfaq shenja të segregimit gjinor vertikal dhe horizontal. Femrat janë të mbi-përfaqësuara në pozita administrative dhe sipas Anketës BEEP në vitin 2015, vetëm 4 përqind e femrave avancojnë në pozita menaxhuese. Sipas sektorëve, femrat janë të nën-përfaqësuara në energji, ndërtimtari dhe transport. Zbrazëtira gjinore sa i përket **qasjes në financa**, gjithashtu është e madhe. Femrat ka më pak gjasa të kenë xhirollogari bankare në një institucion formal financiar (36 përqind e femrave kanë xhirollogari bankare krahasuar me 59 përqind të meshkujve). Gjithashtu, pjesëmarrja e femrave në **ndërmarrësi** dhe në pronësi të bizneseve formale në Kosovë është e ulët krahasuar me rajonin. Në vitin 2015, vetëm 11 përqind e kompanive kanë pasur femra nga radhët e pronarëve, ndërsa proporcioni i kompanive plotësisht në pronësi të femrave ka qenë 7.8 përqind, ndër më të ulëtat nga të gjitha shtetet e operimit të BERZH.

³ Ligji për Sigurimet Shëndetësore i miratuar në Prill 2014 ka krijuar skemën e detyrueshme të sigurimit shëndetësor që ka për qëllim adresimin e shpenzimeve të pakta në sektorin e shëndetësisë (si përqindje e BPV-së) dhe reduktimin e shpenzimeve nga amvisëritë. Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas kanë të njëjtën qasje në shërbimet shëndetësore sikurse qytetarët e tjerë.

2.7 Efikasiteti i burimeve dhe Tranzicioni në Ekonominë e Gjelbër

Intensiteti energjetik i Kosovës vazhdon të jetë ndër më të lartit në rajonin ku BERZH-i operon. Krahësuar me mesataren e BE-së, Kosova ka intensitet energjetik mbi katër herë më të lartë se ai 28 shteteve anëtare të BE (0.46 TPES/BPV vs 0.11, IEA - 2013). Lëndët djegëse fosile (kryesisht qymyri) dhe nafta përfaqësojnë 85 përqind të konsumit të përgjithshëm energjetik. Sektori i energjisë elektrike dominohet nga disa termocentrale që funksionojnë me lignit dhe që prodhojnë shumicën e energjisë elektrike të Kosovës. Potenciali për kursimin e energjisë elektrike është i lartë në të gjithë sektorët. Kosova ka potencial për zgjerimin e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike. Aktualisht, hidro-energji dhe biomasa janë të vetmet burime të ripërtëritshme të energjisë në përdorim. Ka potencial për eksploatim më të madh të këtyre burimeve si dhe deri diku potencial rritjen e prodhimit të energjisë nga era dhe asaj solare. Diversifikimi i prodhimit energjetik në Kosovë përmes rritjes së prodhimit nga burimet e ripërtëritshme do të kontribuojë në rritjen e furnizimit të energjisë dhe reduktimin e emetimeve të dioksidit të karbonit dhe përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit. Kosova gjithashtu ka nevojë që të përmirësojë ndërlidhjen energjetike me shtetet fqinje.

Gjithashtu, në Kosovë, konsumi i energjisë në sektorin rezidencial në raport me konsumin e përgjithshëm të energjisë është ndër më të lartit në rajonin e Ballkanit. Më saktësisht, mbi 60 përqind e tërë kërkesës energjetike vije nga sektori rezidencial, që është shumë e lartë edhe për shkak të nivelit të lartë të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje – që nuk është aspak burim efikas për ngrohje. Shumica e ndërtesave shtëpiake në Ballkanin Perëndimor janë ndërtuar në vitet 1960-1980 dhe janë të vjetruara, ndërsa ndërtesat e ndërtuara në vitet 1990 shpesh janë ndërtuar pa marrë parasysh standardet e efikasitetit të energjisë. Një studim i fundit i tregut nga BERZH ka konkluduar se norma e përgjithshme e penetrimit të materialeve dhe pajisjeve për efikasitet të energjisë është shumë e ulët në Kosovë, rreth 9 përqind.

Nga radhët e shteteve të Ballkanit Perëndimor, në vitin 2013 Kosova ka pasur shkallën më të ulët të konsumimit të energjisë për kokë banori, rreth 32 përqind të mesatares së 28 shteteve të BE; njëkohësisht kosto mesatare e energjisë merr rreth 10 përqind të të gjitha të ardhurave për të gjitha grupet e të ardhurave dhe mbi 29 përqind për 70 përqind të popullsisë – që do të thotë se në përgjithësi shoqëria Kosovare hyn në kuadër të përkufizimit të “varfërisë energjetike”. E gjithë kjo ka ndodhur pavarësisht nga fakti se tarifat energjetike (kryesisht energjia elektrike) subvencionohet në masë të madhe. Niveli relativisht i ulët i konsumit të energjisë elektrike për kokë banori gjithashtu nënkupton se konsumi i energjisë do të rritet në Kosovë në të ardhmen në linjë me rritjen ekonomike dhe rritjen e standardeve të jetesës drejt atyre të BE, duke e rënduar kështu infrastrukturën e vjetruar energjetike, buxhetet familjare dhe financiar publike për shkak të subvencioneve energjetike, rritjen e emetimeve të dioksidit të karbonit etj. Adresimi i pjesës së furnizimit të energjisë si dhe pjesës së kërkesës, respektivisht efikasitetit të energjisë – është kyç. Ngjashëm me situatën në sektorin rezidencial, ka potencial për rritjen e efikasitetit të energjisë edhe në infrastrukturën dhe ndërtesat publike (shkolla, spitale, rrjeti i ndriçimit të rrugëve etj.). Përderisa qasja KKE për adresimin e sfidave në EE në sektorin publik nuk është aplikuar deri më tani (për shkak të tarifa të ulëta të energjisë dhe mungesës së rregulloreve përkatëse), një qasje e kreditimit sovran mund të funksionojë për adresimin e këtij sektori në ndërkohë. Përderisa NVM-të dhe sektorët rezidencial ofrojnë potencial të konsiderueshëm për kursim të energjisë, korniza jo adekuate ligjore dhe rregullatore, mungesa e vetëdijesimit dhe kostot e larta të transaksionit krijojnë barriera për investime në projektet e efikasitetit të energjisë. Adresimi i këtyre barrierave përmes vazhimit të ofrimit të financimit komercial afatgjatë për investime të efikasitetit të energjisë, me mbështetje të politikave dhe të tregut dhe zhvillim të kapaciteteve është i nevojshëm.

Nga aspekti rregullativ, ngjashëm me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova është Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që do të thotë se duhet të implementojë direktivat përkatëse të BE për energjinë e ripërtëritshme dhe EE me afate të implementimit nga 31 Dhjetori 2011 deri në Janar 2017. Obligimi kryesor në kuadër të Direktivës së Shërbimeve Energetike 2006/32/EC (DSHE) është që shtetet përkatëse të përgatisin dhe zbatojnë Planet Kombëtare për Eficiencën e Energjisë (PKEE) që përcaktojnë kornizën për një qasje strategjike për përmirësimin e EE, posaçërisht përmes caktimit të caqeve për kursimin e energjisë dhe propozimin e masave dhe veprimeve konkrete të cilat kontribuojnë në arritjen e këtyre caqeve. Kosova ka zhvilluar Planin e parë Kombëtar për Eficiencën e Energjisë (PKEE) në pajtim me kërkesat e BE, dhe ky plan është pranuar nga Sekretariati i KE. Sipas PKEE, Kosova është e obliguar që të arrijë cakun prej 9 përqind të kursimit të energjisë deri në fund të vitit 2018.

Ndryshimet klimatike paraqesin disa kërcënime për ekonominë dhe zhvillimin e Kosovës. Parashikimet rajonale janë që temperatura e përgjithshme dhe ato sezonale do të ngritën, duke reduktuar reshjet gjatë verës dhe ndryshim të volumit të reshjeve në përgjithësi. Rrjedhimisht, Kosova pritet të ballafaqohet me mungesë të ujit gjatë muajve të verës. Ndryshimi i volumit të reshjeve mund të rezultojë gjithashtu në ndryshimin e hidrologjisë së lumenjve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta, siç janë vërshimet. Burimet ujore dhe bujqësia janë identifikuar si sektorët më të ndjeshëm. Mungesa e ujit mund të ketë implikime për aktivitetet e Bankës në agrobiznes dhe në aktivitetet e prodhimtarisë që kërkojnë sasi të madhe të ujit. Agrobiznesi gjithashtu mund të ndikohet nga ndryshimet klimatike përmes ndryshimit të prodhimtarisë bujqësore, duke ndikuar kështu në disponueshmërinë e produkteve primare dhe duke rritur nevojën për ujitje. Investimet në hidro-energji gjithashtu do të duhet të marrin parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike në hidrologjinë e lumenjve. Nevoja për investime në sisteme më të mira të menaxhimit të ujërave do të rritet për shkak të mungesës së ujit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike. Rrjedhimisht, Banka do të shqyrtojë në mënyrë sistematike mundësitë për rritjen e kapacitetit për përballimin e ndryshimeve klimatike përmes investimeve të saj, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sektorëve të ndjeshëm siç janë ujësjellësi, energjia (posaçërisht hidro-energjia), agrobiznesi, infrastruktura dhe industritë që kërkojnë sasi të madhe të ujit sikurse minierat dhe prodhimtaria.

3 ORIENTIMET STRATEGJIKE

3.1 Drejtimet Strategjike

Përderisa ka pasur rritje ekonomike është në vitin 2015 dhe parashikohet të ketë rritje të mëtutjeshme në afatshkurtër, problemet strukturore janë duke e rënduar shumë ekonominë Kosovare, e cila dominohet nga industritë me vlerë të ulët të shtuar dhe, në përgjithësi është në fazat e hershme të tranzicionit krahasuar me pjesën tjetër të rajonit. Kosova vuan nga shkalla e lartë e papunësisë, posaçërisht në mesin e të rinjve dhe femrave, përderisa furnizimi i çrregullt me energji elektrike (për shkak të problemeve në sektorin energjetik) dhe infrastruktura e vjetruar janë duke i penguar investimet dhe zhvillimin.

Megjithëse sfidat strukturore janë të konsiderueshme, zhvillimet pozitive të brendshme dhe të jashtme mund të bashkohen për ti dhënë shtytje angazhimit të Bankës gjatë periudhës së re të Strategjisë. Këto zhvillime pozitive përfshijnë 1) hyrjen në fuqi të MSA-së me BE-në, 2) miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, 3) dorëzimi i Programit të Dytë të Reformave Ekonomike 2016 – që përfshin një agjendë për reforma strukturore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës – si dhe 4) harmonizimin strategjik të prioritetëve të Bankës dhe të BE për alokimin e 645.5 milion Euro në kuadër të Fondeve të IPA II 2014-2020.

Strategjia ka për qëllim aplikimin e disa filtrave selektiv në zhvillimin e aktiviteteve investive dhe të dialogut për politikat brenda Kosovës:

- **Harmonizimi i prioritetëve të Bankës me prioritetet e Qeverisë dhe pronësia;** Banka do t'i shmanget angazhimit substancial në fushat dhe sektorët në të cilën nuk ka udhëheqje të qartë politike;
- **Plotësimi i akterëve të tjerë,** duke përfshirë Komisionin Evropian, FMN-në, Grupin e Bankës Botërore (GBB) dhe IFN-të tjera; Banka nuk do të ketë angazhim substancial në fushat në të cilët partnerët tjerë janë në rol udhëheqës;
- **Përparësitë krahasuese të BERZH dhe historiku i angazhimit në Kosovë.** Këto do të rezultojnë kryesisht nga angazhimi i Bankës me sektorit privat (posaçërisht në agrobiznes, prodhimtari, TIK, energji elektrike dhe burime të ripërtëritshme të energjisë) si dhe investimet e targetuara në sektorin publik, për promovimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe mbështetjen e reformave (IKM dhe transportet).

Banka do të aplikojë **qasjen TEGJ** në të gjithë sektorët dhe aktivitetet kur është relevante, për maksimalizimin e mbështetjes dhe zbatimit të investimeve TEGJ; ofrimin e asistencës teknike për adresimin e mungesës së kapaciteteve dhe vetëdijes; si dhe angazhimin në dialog për politika me qëllim të largimit të barrierave dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për investime të gjelbërta, ndër tjera.

Në kuadër të të gjitha prioritetëve strategjike të saj, Banka do të promovojë **zhvillimin përfshirës** (të rinjve, femrave në fuqinë punëtore dhe emigrantëve të kthyer).

Shfrytëzimi i iniciativave të siguruara nga BE dhe FMN, si dhe dinamikës së reformave të vet autoriteteve Kosovare, Banka do të ketë për qëllim mbështetjen e Kosovës në përpjekjet e saj për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik mbi baza të qëndrueshme dhe përfshirëse, njëkohësisht duke thelluar dhe fuqizuar angazhimin dhe mbështetjen e nevojshme dhe në pajtim me dinamikën dhe progresin e reformave, duke u fokusuar në prioritetet strategjike në vijim:

Përmes shfrytëzimit të incentivave të siguruara nga BE dhe FMN si dhe dinamikës së reformave nga vetë autoritetet Kosovare, Banka do të mbështesë Kosovën në përpjekjet për përshejtimin e zhvillimit ekonomik në baza të qëndrueshme dhe përfshirëse përmes prioriteteve strategjike në vijim:

- Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit afarist.** Ekonomia Kosovare karakterizohet nga produktiviteti i ulët, papunësia e lartë, mospërputhja e aftësive të fuqisë së re punëtore dhe kërkesave të punëdhënësve, baza e dobët e eksportit, investimet e jashtme të kufizuara, shkalla e lartë e informalitetit dhe zbrastëritat në përfshirje, sic është pjesëmarrja shumë e ulët e femrave në fuqinë punëtore. Në mënyrë që sektori privat të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme në fushën e klimës së investimeve, qeverisjes dhe konkurrueshmërisë, duke shfrytëzuar procesin e përafrimit me BE. Banka do të sigurojë financim për korporatat dhe NVM-të Kosovare për mbështetjen e investimeve në aktivitete që kanë vlerë të shtuar, përmirësojë konkurrencën kundrejt importeve, dhe mundësojë eksporte me vlerë të shtuar. Përmirësimi i qasjes në financim për NVM do të vazhdojë të jetë prioritet. Përveç financimit, Banka gjithashtu do të ofrojë shërbime të këshillimit përmes Programit Këshilla për Bizneset e Vogla në kuadër të Iniciativës për Biznese të Vogla. Banka do të përdore bankat lokale partnere për kanalizimin e financimit për NMVM-të dhe do të ofrojë shërbime të këshillimit për biznese në kombinim me investime për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e sektorit të agrobiznesit, duke përfshirë, përmes ngritjes së standardeve të cilësisë dhe shëndetit, si dhe përmes zhvillimit të zingjirëve të furnizimit. Duke marrë parasysh likuiditetin e lartë të sektorit bankar, Banka do të vazhdojë të lançojë korniza të fokusuara, disa prej të cilave do të kenë incentiva të caktuara, siç është Programi Femrat në Biznes (FnB), Mekanizimi për Financimin e Energjisë së Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor (MFEQBP), Korniza e Financimit Direkt në kuadër të Iniciativës për Bizneset e Vogla si dhe të lançojë Mekanizmin për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë (MMK), si dhe Mekanizimin për Ndarjen e Rrezikut (MNRR). Banka do të ketë për qëllim ofrimin e qasjes në kapital për NVM-të, kur është e përshtatshme, për të adresuar mungesën e burimeve të financimit të kapitalit në Kosovë, edhe nëse mundësitë për investime të kapitalit janë të rralla për shkak të mundësive të vogla dalëse dhe informalitetit. Banka gjithashtu do të ofrojë shërbime të këshillimit me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve dhe do të shqyrtojë angazhimin në fushat të cilat e adresojnë informalitetin, raportimin financiar, kapacitetin menaxhues, qeverisjen korporatave si dhe promovimin e përfshirjes sociale duke i inkurajuar njerëzit që të marrin pjesë në mënyrë aktive në tregun e punës. Banka gjithashtu do të jetë e vëmendshme ndaj sfidave të migrimit, në kontekstin aktual, duke qenë se qeveria është duke u përpjekur të rrisë “*Kthimin e Trurit*” nga Diaspora, dhe Banka do të përpiqet që të marrë pjesë në skemat e udhëhequra nga Qeveria për bashkëpunimin me pjesëtarët e diasporës Kosovare të kthyer në sektorin privat, dhe të ofrojë financim adekuat në formë të granteve.
- Rritja e sigurtisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes financimit të investimeve në këtë sektor, mbështetjes së reformave dhe promovimit të efikasitetit të energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme.** Banka do të aplikojë qasjen TEGJ në të gjithë sektorët dhe aktivitetet kur është relevante, për maksimalizimin e mbështetjes dhe zbatimit të investimeve TEGJ në Kosovë. Sektori i vjetruar energjetik në Kosovë është duke vuajtur nga vitet e shumta të mos-investimit. Mungesa e energjisë së qëndrueshme është duke i

çrregulluar aktivitetet e bizneseve dhe pengon investimet dhe zgjerimin e bizneseve. Dy termocentralet me qymyr të Kosovës janë të vjetra dhe njëri prej tyre është planifikuar që të nxirret nga funksioni. Eficienca e energjisë dhe energjia e ripërtëritshme mund të ndihmojnë në zbutjen e mungesave aktuale të të parashikuara energjetike, duke rritur njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit. Për arritjen e këtij synimi duhet të fuqizohet korniza aktuale rregullatore dhe kapacitetet institucionale për eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme. Kosova duhet të harmonizojë më tutje legjislacionin e saj me atë të BE, duke ulur intensitetin energjetik dhe rritjen e respektimit të kërkesave mjedisore. Banka do të shqyrtojë mbështetjen e investimeve për rritjen e kapaciteteve gjeneruese, duke përfshirë nga burimet termale dhe ato të ripërtëritshme, në rastet kur këto investime janë në përputhje me Strategjinë e Sektorit Energjetik të Bankës. Paralelisht, Banka do të mbështesë fuqizimin dhe rritjen e efikasitetit të rrjetit shtetëror të transmissiionit, si dhe investime në reduktimin e intensitetit energjetik përmes mbështetjes së investimeve për rritjen e eficiencës së energjisë nga ana e kërkesës në të gjithë sektorët, si pjesë e huadhënies direkte ose mekanizmave për financimin e energjisë së qëndrueshme përmes bankave partnere. Varësisht nga përkushtimi i autoriteteve Kosovare dhe në koordinim me BE, IFN-të tjerë ndërkombëtare dhe donatorët aktiv në sektorin e energjisë, Banka do të ofrojë këshilla për politikave dhe asistencë teknike për zbatimin e reformave institucionale dhe të politika, posaçërisht në fushën e kornizës rregullatore për energjinë e ripërtëritshme si dhe për përmirësimin e kornizës ligjore për eficiencën e energjisë, me fokus të veçantë në sektorin rezidencial.

- **Mbështetja e ndërlidhjes dhe integritetit rajonal.** Për përmirësimin e integritetit rajonal të Kosovës ka nevojë për përmirësimin e infrastrukturës dhe tërheqjen e IHD, si dhe harmonizimin me standardet e BE. Për arritjen e këtij qëllimi, Kosova duhet të zhvillojë lidhjet rrugore me korridoret kryesore Pan-Evropiane. Rrjeti hekurudhor i vjetruar i Kosovës aktualisht është i lidhur me rrjetin kryesor Evropian vetëm përmes IRJ Maqedonisë, që paraqet pengesë të konsiderueshme për trafikun nga dhe drejt shumicës së qendrave Evropiane dhe e vetmja lidhje tjetër nga Prishtina në Serbi nuk është funksionale. Banka synon të ofrojë financim afatgjatë dhe këshillim për të ndihmuar në zhvillimin e lidhjeve kryesore të transportit si dhe, kur është e aplikueshme, të ndihmojë Kosovën në arritjen e standardeve Evropiane në sektorin e transportit. Banka gjithashtu do të mbështesë investimet që kanë për qëllim përmirësimin e lidhjeve rajonale të Kosovës në fushën e energjisë. Banka do të përpiqet të bashkë-financojë investimet e BEI, si dhe të mbështesë Kosovën në mobilizimin e granteve nga BE në kuadër të KIBP, që është duke u fokusuar gjithnjë e më shumë në projekte të cilat e promovojnë ndërlidhjen. Përfundimisht, integrimi i bizneseve është gjithashtu një çështje jetike, pasi që kompanitë Kosovare nuk kanë qenë në gjendje që të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e ofruara nga këto tregje të eksportit dhe Banka do të vazhdojë të mbështesë tregtinë ndër-kufitare për Programin e saj për Lehtësinë e Tregtisë, këshillimeve për bizneset e vogla për gatishmërinë për eksporte si dhe këshilla të politikave për reduktimin e Barrierave Jo-Tarifore dhe Barrierave Teknike për Tregtinë lidhur me agjendën e ndërlidhjes së BE.

3.2 Sfidat kryesore dhe aktivitetet e Bankës

Tema 1: Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit afarist

Sfidat e tranzicionit

- Megjithëse cilësia e **klimës investive** (që përbën efektshmërinë e institucioneve shtetërore, sundimit të ligjit dhe mjedisit operacional) është përmirësuar në vitet e fundit, bizneset ende ballafaqohen me disa pengesa serioze, duke përfshirë në marrjen e lejeve të ndërtimit dhe përfundimin e një biznesi (falimentimi). Kosova është ranguar në vendin e 66 nga gjithsej 189 ekonomi të përfshira në Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes për vitin 2016. Koha dhe kosto e nevojshme për marrjen e një leje të eksportit gjithashtu janë shumë të larta sipas standardeve rajonale. Informaliteti dhe korrupsioni janë ndër pengesat kryesore për mjedisin afarist të identifikuar nga kompanitë Kosovare në anketën e fundit të BERZH-Bankës Botërore (BEEPS V), duke qenë se praktikat korruptive konsiderohen se janë më të lartat në Ballkanin Perëndimor me më shumë se 50 përqind të kompanive të anketuara nga Banka Botërore kanë identifikuar korrupsionin si pengesë të madhe për zhvillim, krahasuar me 3.1 përqind në Mal të Zi, 12.2 përqind në Slloveni, 13.4 përqind në IRJ Maqedoni, 17 përqind në Shqipëri, 18.9 përqind në Serbi dhe 26.4 përqind në Bosnjë.
- Pasiguria lidhur me **pronësinë mbi tokën dhe infrastrukturën bazike** pengojnë investimet vendore dhe të huaja. Kosova duhet të fuqizojë sistemin e të drejtave pronësore, në veçanti me qëllim të zhvillimit të një kornize ligjore në të cilën definohen në mënyrë të qartë të drejtat dhe krijohen kushtet ligjore për të drejtat pronësore që mund të qarkullojnë në treg, vënien në përdorim të tokës, fuqizimin e kapaciteteve gjyqësore dhe trajtimin e të drejtave pronësore si dhe aktivitetet tjera për të siguruar mbrojtjen më të mirë të të drejtave pronësore për gupet e marginalizuara, duke përfshirë minoritetet etnike dhe femrat.
- Ka nevojë për përmirësime të mëdha për **përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së eksporteve**. Kosova aktualisht është në fazën e hershme të ekonomisë së tregut pasi që modeli ekonomik i saj bazohet në tregti dhe me bazë shumë të vogël industriale. Gjithashtu, kapaciteti i Kosovës për përballimin e presionit të konkurrencës me BE është shumë i ulët, sipas vlerësimeve të KE. Ndërmarrjeve të vogla u mungojnë njohuritë për zgjerimin e bizneseve të tyre, përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë dhe për inovacion.
- Një sfidë tjetër e rëndësishme është **aftësia e kufizuar e sektorit bankar për ofrimin e shërbimeve financiare efektive** për ato NVM të cilat kanë nevojë për financim mirëpo që nuk i plotësojnë kushtet e financimit, kryesisht për shkak të mjedisit të përgjithshëm të dobët ekonomik, shkallës së lartë të informalitetit dhe mungesës së kapacitetit për menaxhim financiar të nevojshëm për qasje në financierët tjerë në nivel të NVM-ve. Niveli jo i kënaqshëm i edukimit financiar dhe baza e ulët e kolateralit i pengon shumicën e NVM-ve nga sigurimi i financimit. Shpërndarja e normave të interesit mes huave dhe depozitave, pavarësisht nga trendi në rënie në vitet e fundit, vazhdon të jetë e lartë në krahasim me shtetet e ngjashme, duke sinjalizuar kështu konkurrencë jo të plotë në sektorin bankar, ndërsa investimet konsiderohet me rrezik të lartë nga bizneset e huaja si dhe ato nga diaspora Kosovare. Sipas Analizës së BERZH për Zbrazëtitrat Gjimore, Kosova ka zbrazëtira të konsiderueshme gjimore në aspektin e qasjes në financa

dhe penetrimi i shërbimeve bankare vazhdon të jetë i dobët në segmentin e ndërmarrëseve femra. Gjithashtu nuk ka ndonjë fond të kapitalit vendor ose të huaj.

- Siç është shpjeguar më hollësisht në seksionin (2.6) për kontekstin social, ka **mospërputhje të konsiderueshme të aftësive** të kërkuara nga tregu i punës dhe atyre që prodhohen nga sistemi arsimor i Kosovës, posaçërisht në nivelin e arsimit profesional dhe terciar, dhe paradoksi është në këtë periudhë të papunësisë së lartë, shumë ndërmarrje në fakt kanë vështirësi në punësimin e punëtorëve me aftësitë e nevojshme. Kosova ballafaqohet me sfida të mëdha ekonomike dhe të përfshirjes sociale: papunësia është veçanërisht e lartë në mesin e të rinjve dhe ka migrim të vazhdueshëm, kryesisht në Evropën Perëndimore. Rritja e sektorit privat është kyçe për krijimin e vendeve të punës për grupet e përjashtuara, posaçërisht në pjesët rurale të Kosovës, si dhe femrat, të rinjtë dhe minoritetet si dhe për kapitalizimin e aftësive të pjesëtarëve të diasporës Kosovare, duke qenë se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dekurajon investimet dhe është pengesë për konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve.
- **Sektori i bujqësisë** – që është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomik në Kosovë për shkak të:
 - o Pjesëmarrjes së përgjithshme në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik (14 përqind e BPV në vitin 2011)
 - o Është punëdhënësi më i madh privat me gjithsej 20 përqind të punësimit – dhe si i tillë ka potencial të fuqishëm për tu shndërruar në motor të zhvillimit në afat të shkurtër dhe të mesëm.
 - o 53 përqind e territorit të Kosovës konsiderohet tokë e mirë dhe e punueshme dhe me kushte të favorshme klimatike për bujqësi.

Megjithatë, ky sektor ballafaqohet me sfida sistimore dhe strukturore që duhet të adresohet në mënyrë që të arrihet potenciali konkurrues dhe i rritjes (PRE 2016 dhe SKZH) pavarësisht nga rritja e qëndrueshëm e këtij sektori gjatë viteve të kaluara, bilanci i përgjithshëm tregtar për produkte bujqësore është ende negativ. Aktualisht, bujqësia karakterizohet (ende) nga produktiviteti i ulët i përgjithshëm, kryesisht për shkak të:

- o Parcelizimit dhe fragmentimit të tokës me madhësi mesatare prej 1.5 hektarë (shpesh të shpërndara në një mesatare prej shtatë parcelave më të vogla, që e keqëson ekonominë e shkallës) dhe që kërkon përmirësimin e rregullimit të tokës bujqësore;
- o Teknologjisë së vjetruar bujqësore dhe mungesa e njohurive moderne bujqësore nga radhët e bujqve dhe agro-përpunuesve,
- o Mungesës së diversitetit të produkteve bujqësore;
- o Mungesës së investimeve në ujtjen e tokës dhe mungesa e sistemit pjesëmarrës në menaxhimin e ujitjes;
- o Stabilimenteve të kufizuara për përpunim, duke përfshirë mungesën e pajisjeve për ruajtje në formë të ngrirjes, paketim, transport, që janë të rëndësishme për prodhimin e frutave dhe perimeve me vlerë të shtuar;
- o Zbatimit të kufizuar të standardeve të sigurisë së ushqimit dhe higjienës;
- o Qasjes së kufizuar dhe koston e lartë për marrjen e kredive dhe kapitalit investues, që pasqyron pjesërisht nivelin e lartë të informalitetit dhe pamundësinë për realizimin e vlerës së kolateralit. Kjo e fundit kontribuon në

teknologjinë e vjetruar bujqësore dhe mungesën e njohurive moderne bujqësore në radhët e bujqve dhe agro-përpunuesve.

Qeveria është duke mbështetur tranzicionin nga kulturat primare bujqësore në produkte me kthim më të madh në investime dhe bujqësi organike. Gjithashtu është duke adresuar disa masa të politikave që përfshijnë çështjet e pronësisë së tokës përmes zhvillimit të një strategjie nga Ministria e Drejtësisë.

- Sektori i **TIK** konsiderohet se ka potencial të konsiderueshëm zhvillimor (PRE, 2016). Megjithatë, shpërndarja e infrastrukturës së TIK në Kosovë është shumë e pabarabartë. Sfidat kryesore për këtë sektor përfshijnë zhvillimin infrastrukturës moderne të telekomunikacionit (interneti broadband) dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i zbatimit të një kornize moderne ligjore dhe rregullatorë. Bizneset ballafaqohen me kosto shumë të lartë për shkak të dështimit për përfshirjen e TI në veprimtarinë e tyre dhe nuk ka pasur incentiva për sektorin privat që të investojë në proceset e TI.
- Qeveria është duke planifikuar mbështetjen e komunave për vënien në funksion të 5 deri 7 **zonave ekonomike dhe industriale**, d.m.th zona të caktuara në të cilat ofrohet infrastruktura bazike për investitorët (rrugët e qasjes, energjia elektrike, trajtimi i ujërave) për zbutjen e rreziqeve për bizneset e reja. Megjithatë ka shumë pengesa në arritjen e këtij qëllimi. Zonat do të menaxhoheshin në baza komerciale, me qasje të barabartë për investitorët vendor dhe të huaj.
- Përdorimi i potencialit mineral të Kosovës është kyç për realizimin e potencialit ekonomik të Kosovës. E ardhmja e kompleksit **minerar Trepça** vazhdon të jetë e paqartë për shkak të komplikimeve lidhur me çështjet pronësore dhe kërkesave potenciale të kreditorëve nga Serbia. Gjykata Supreme e Kosovës ka caktuar 1 Nëntorin 2016 si afatin e fundit për dorëzimin e planit për riorganizimin e kompleksit Trepça. Rikthimi i këtij kompleksi mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes ngritjes së ekspertizës, krijimit të një zingjiri të ri të prodhuesve dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Megjithatë, sfidat kryesore përfshijnë historinë e degradimit mjedisor dhe praktikën e papërgjegjshme minerare, nevoja për kompletimin e ristrukturimit dhe zgjidhjen e çështjeve juridiko pronësore.
- Një dobësi e vazhdueshme e NVM-ve në Kosovë ka të bëjë me **qeverisjen korporative** të tyre, dhe posaçërisht lidhur me **standardet e raportimit financiar**. Kosova duhet të lëvizë drejt plotësimi të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira të kontabilitetit. Bazuar në anketën e fundit të ndërmarrjeve të zhvilluar nga Banka Botërore, vetëm 20 përqind e ndërmarrjeve në Kosovë kanë pasqyra financiare vjetore të audituara nga një auditor i jashtëm. Standardet e dobëta të brendshme të kontabilitetit janë duke i parandaluar NVM-të në Kosovë nga arritja e potencialit të tyre zhvillimor.
- **Privatizimi** nuk ka avancuar në vitet e fundit duke qenë që Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka qenë funksionale për shkak të mos plotësimi të Bordit. Ende ka nevojë për komercializimin dhe – kur është e përshtatshme – privatizimin gradual të NPSH-ve dhe krijimin e klimës tërheqëse për IHD.
- Që nga vjeshta e vitit 2014, Kosova ka pasur një shkallë të përshpejtuar të migrimit të jashtëm në shtetet e Bashkimit Evropian (kryesisht në Gjermani dhe Austri), si dhe në Zvicër, që kjo që pasqyron pasigurinë politike dhe mundësitë e kufizuara ekonomike në Kosovë. Megjithatë, në anën pozitive, **Diaspora Kosovare** ka fituar aftësi dhe njohuri, bartja e të cilave në Kosovë mund të sjellë përfitime të shumta për ekonominë Kosovare. Studimet tregojnë se emigrantët e kthyer nga diaspora kanë arritur të gjejnë punë në Kosovë shumë më lehtë se sa personat që nuk kanë asnjë aftësi, që tregon vlerën e kapitalit njerëzor. Megjithatë, deri më tani, procesi i deritanishëm i kthimit të trurit ka qenë sporadik dhe i ka munguar mbështetja institucionale. Krijimi i një mekanizmi për

angazhimin e diasporës do të mundësonte transferimin e aftësive dhe do të ndihmonte në kthimin e një numri të anëtarëve të diasporës me aftësi të caktuara. Sa i përket skemave për transferimin e aftësive, ekziston vetëm një program që ka për qëllim kthimin e studiuesve dhe asnjë skemë për të mundësuar angazhimin e diasporës në sektorin privat.

Përgjigjja operationale

- Banka do të mbështesë korporatat dhe NVM-të Kosovare përmes rritjes së efikasitetit, standardizimit dhe produktivitetit, mbështetjen e konkurrueshmërisë kundrejt importeve, dhe inkurajimin e eksporteve me vlerë të shtuar përmes një kombinimi të këshillave investive dhe biznesore. Banka do të vazhdojë të zhvillojë një infrastrukturë të qëndrueshme për mbështetjen e NMVM përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe zhvillimit të konsulentëve vendor.
- Banka do të përdorë bankat lokale partnere si kanal kryesor për targetimin e produkteve të NMVM, fokusin në ofrimin e kapitalit për bankat, mekanizmeve për ndarjen e rrezikut, garantimin e kredive dhe linja të dedikuara kreditore për promovimin e ndërmjetësimit bankat dhe targetimin e segmenteve të caktuar dhe forcimin e konkurrencës dhe efektivitetit të sektorit financiar. Duke marrë parasysh likuiditetin e lartë të sektorit bankar, Banka do të vazhdojë të ofrojë instrumente të përziera sikurse Programi Femrat në Biznes, Mekanizmi për Financim të Energjisë së Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor dhe lancimin e Mekanizmit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë, si dhe ofrimin e Mekanizmit për Ndarjen e Rrezikut.
- Banka do të ofrojë shërbime të këshillimit të bizneseve me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve, varësisht nga zotimi i qeverisë, do të shqyrtojë mundësinë e angazhimit në fushat për adresimin e informalitetit, raportimit financiar dhe kapacitetit menaxhues, si dhe qeverisjen korporatave.
- Përmes KBV, Banka do të vazhdojë të zhvillojë një infrastrukturë mbështetëse për NMVM përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe zhvillimit të konsulentëve lokal.
- Banka do të ofrojë shërbime për këshillimin e bizneseve në kombinim me investimet për rritjen e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e sektorit të agrobiznesit, duke përfshirë ngritjen e standardeve shëndetësore, si dhe zhvillimin e zingjirëve të furnizimit. Në kuadër të Iniciativës për Bizneset e Vogla, Banka do të vazhdojë mbështetjen e sektorit bankar me linja të kreditit për NVM-të në sektorin e agrobiznesit. Banka gjithashtu do eksplorojë mundësi të financimit de zgjerimin e sistemit të ujitjes për qëllime bujqësore, duke u bazuar në mbështetjen aktuale për TC dhe vazhdon të jetë e gatshme për mbështetjen e kanalit të Ibër-Lepencit.
- Duke pasur parasysh faktin që sektori i TIK konsiderohet prioritet për zhvillim nga qeveria, Banka mund të shqyrtojë mbështetjen e bizneseve Kosovare në fushën e TI si pjesë e një projekti rajonal, duke marrë parasysh tregun e vogël dhe potencialin e ngjashëm në shtetet fqinje, në mënyrë që të eksportojë shërbimet jashtë shtetit dhe për bizneset tjera për modernizimin e veprimtarisë së tyre përmes përdorimit të TI.
- Gjatë angazhimit në transaksione të drejtpërdrejta me korporatat private, duke përfshirë përmes investimeve në kapital dhe jo vetëm në borxhin e bankave, Banka do të përpiqet që të zhvillojë më tutje modelin e saj të fokusuar në sektorin privat përmes përmirësimit të programeve të trajnimit dhe programeve të mësimi në punë (p.sh praktika) dhe iniciativave mbështetëse për rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në përcaktimin e standardeve kombëtare të aftësisë që reflektojnë nevojat e tregut të punës, posaçërisht në nivelin e edukimit profesional. Kjo do të ndihmojë në promovimin e mundësive formale të punësimit dhe transferimit të aftësive, posaçërisht për personat që hyjnë në tregun e punës për herë të parë, femrat dhe emigrantët e kthyer. Përveç kësaj, Banka gjithashtu

do të kërkojë mundësi për përmirësimin e pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore dhe mundësitë e karrierës për femrat.

- Banka do të mbështesë IHD si dhe procesin e privatizimit të ndërmarrjeve të mbetura në pronësi shtetërore përmes tenderimit transparent dhe përfshirjes së investitorëve strategjik të kualifikuar, posaçërisht në sektorin e postës dhe telekomunikacionit.
- Varësisht nga progresi i cili do të bëhet në privatizim dhe nga prania e investitorëve të huaj strategjik me reputacion, Banka do të shqyrtojë në mënyrë selektive projektet e investimeve në sektorin e minierave, me qëllim të realizimit të potencialit të konsiderueshëm që ka ky sektor.
- Banka do të përpiqet që të rrisë pjesëmarrjen e sektorit privat në mirëmbajtjen e rrugëve sipas kontratave të bazuara në performancë në projektet aktuale rrugore.
- Për rritjen e angazhimit në politikat e përfshirjes dhe zhvillimin e partneritetit strategjik të saj me Fondacionin Evropian për Trajnime (FET), Agjencinë e BE për edukim profesional dhe politikat e trajnimit në zonën fqinjësore të BE dhe shtetet kandidate për anëtarësim, Banka do të fokusohet në zhvillimin e standardeve teknike dhe profesionale të edukimit, si dhe zgjerimin gjeografik të mekanizmave për testimin e aftësive profesionale si dhe mbështetjen e punësimit të rinjve përmes këshillave për karrierë, me përfshirjen e sektorit privat dhe implementimin e garancive për të rinjtë.
- Banka do të përpiqet të marrë pjesë në skemat e udhëhequra nga qeveria dhe kompanitë për të mundësuar angazhimin e emigrantëve të kthyer nga diaspora në sektorin privat, duke përdorur kapitalin njerëzor të diasporës për transferimin e njohurive, varësisht nga financimi në formë të granteve, në veçanti përmes krijimit skemave për grante paralele për stimulimin e investimeve të Diasporës në krijimin e kompanive brenda Kosovës.

Dialogu për politika

- BERZH në koordinim të ngushtë me IFN-të tjera do të punojë për përmirësimin e qeverisjes korporative dhe klimës së investimeve, duke zhvilluar më tutje ekspertizën në fushat specifike, duke përfshirë përmirësimin e procedurave administrative dhe gjyqësore, ristrukturimin e NPSH-ve në mënyrë që ato të jenë më efikase, si dhe në zhvillimin e tregjeve financiare. Këto aktivitete do të bazohen në një vlerësim të hollësishëm të nevojave, sipas pajtimit me autoritetet Kosovare.
- Qeveria e ka inkurajuar përfshirjen e BERZH fillimisht në ofrimin e këshillave në politika dhe asistencë teknike në krijimin e zonave industriale dhe për krijimin e një kornize ligjore dhe rregullative më liberale, shërbime publike efikase, dhe infrastrukturë më të mirë (duke përfshirë rrugë më të mira, ujësjellës dhe trajtim të ujërave të zeza) si dhe krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për investitorë.
- Banka do të zhvillojë aktivitete të BT dhe këshillëdhënëse për promovimin e konsolidimit, modernizimit dhe rritjes së efikasitetit në agrobiznes si dhe për përmirësimin e ndërlidhjeve në zingjirët e vlerës së agrobiznesit (nga bujqësia, përpunimi i ushqimit dhe deri tek shitja e ushqimit), duke punuar me korporata të mëdha si shtylla të këtij procesi si dhe me NVM për miratimin e praktikave të mira në menaxhimin e zingjirit të vlerës. Objektivi është që të zhvillohet një qasje e qëndrueshme dhe integruese, duke përfshirë përmes investimeve për modernizimin e veprimtarisë dhe promovimin e krijimit të platformave për mbledhje dhe distribuim të produkteve bujqësore.

Korniza e Rezultateve për Temën 1: Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit afarist

	SFIDAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	INDIKATORËT
1.1	Prodhimi me vlerë të shtuar pengohet nga kapacitetet e brendshme të kufizuara, teknologjia e vjetruar, mjedisi i vështirë afarist dhe qasja e kufizuar në financim	Fuqizimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat përmes rritjes së efikasitetit, praktikave operacionale inovative, përmirësimit të praktikave të menaxhimit, përmirësimit të mjedisit afarist dhe qasjes në financim	- Sigurimi i financimit (borxhit dhe kapitalit) për NVM, plotësuar me BT, në kuadër të Programit për Këshillim të Bizneseve të Vogla për investim në përmirësimin e standardeve të cilësisë, zhvillimit të kompetencave themelore dhe transferimit të njohurive me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë në krahasim me importet dhe inkurajimin e eksporteve me vlerë të shtuar - Ofrimi i kornizave të targetuara të kredimit (p.sh FnB, CSF, RSF) dhe produktet në dispozicion për ndarjen e rrezikut. - Programi për Këshillimin e Bizneseve të Vogla pritet të përmirësojë menaxhimin financiar dhe qeverisjen korporative, të risë prodhimit përmes implementimit të standardeve të cilësisë, promovimit të tregtisë dhe rritjes së potencialit të konkurrueshmërisë dhe eksporteve.	- Prova për vendosjen e praktikave më të avancuara të qeverisjes korporative dhe standardeve të biznesit nga klientët (<i>Baza fillestare – N/A</i>) - Numri i përgjithshëm / volumi i kredive për NVM të ofruara nga bankat klientë, duke përfshirë për fushat e caktuara (ndërmarrëset femra, agrobiznesi). (<i>Baza fillestare përcaktohet në kohën e miratimit të projekteve</i>) - Numri i projekteve për KBV që raportojnë rritje të produktivitetit, qarkullimit dhe/ose numrit të punëtorëve (<i>Baza fillestare përcaktohet në kohën e miratimit të projekteve</i>)
1.2	Agrobiznesi është duke u penguar nga zhvillimi i bujqësisë në nivel shumë të vogël dhe të pamjaftueshëm dhe mungesa e financimit	Rritja e prodhimit, efikasitetit dhe cilësisë në zingjirët e vlerës së agrobiznesit përmes mbështetjes për qasje në financim, zhvillimit të aftësive teknike dhe të tregut.	- Kreditimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë përmes bankave, duke përfshirë ndarjen e rrezikut, të fokusuar në agrobiznes për përmirësimin e stabilimenteve dhe pajisjeve, për mbështetjen e zingjirëve të vlerës përmes konsolidimit të aktiviteteve bujqësore dhe përmirësimit të kapaciteteve përpunuese (në veçanti për industrinë e mishit, bulmetit, frutave dhe perimeve, dhe rritjen e standardeve të cilësisë dhe shëndetit. - Investime dhe shërbime të këshillimit për zhvillimin e zingjirëve të vlerës në agrobiznes, promovimi i përmirësimit të lidhjeve në hallkat e ndryshme të zingjirit të vlerës në agrobiznes (nga bujqësia deri tek përpunuesit e ushqimit dhe shitësit me pakicë). - Këshilla për agrobizneset para dhe pas investimit, për përmirësimin e standardeve, efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së veprimtarisë së tyre. - Eksplorimi i mundësive të financimit për zgjerimin e mbulimit të sistemit të ujësjellësit.	- Shembuj të implementimit të suksesshëm të trajnimeve/zhvillimit të kapaciteteve për bujqit (<i>Baza fillestare – N/A</i>) - Numri i agro-kompanive të mbështetura përmes projekteve dhe lidhjeve (<i>Baza fillestare – 0</i>)
Indikatori për kontekst: Δ % e kompanive në Kosovë që kanë identifikuar qasjen në financa si pengesë kyçe për veprimtarinë e tyre (BEEPS V) (<i>Baza 2013 – 40%</i>)				

Tema 2: Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes financimit të investimeve në këtë sektor, mbështetjes së reformave në këtë sektor, promovimit të efijencës së energjisë dhe të energjisë së ripërtëritshme

Sfidat e tranzicionit:

- Ristrukturimi i sektorit të energjisë për të mundësuar investimet është në prioritetet më të rëndësishme për qeverinë, duke qenë se 9 nga 10 kompani kanë potencuar energjinë elektrike si pengesën kryesore për investime. Sfidat në këtë sektor janë shumë të mëdha, si në aspektin e **energjisë së qëndrueshme** ashtu edhe në **mungesën e kapaciteteve**. Opsionet për furnizim me energji elektrike janë të kufizuara për shkak të gjendjes së dobët të termocentraleve të vjetruara (TMC), me ndotje të lartë dhe të paqëndrueshme, mungesës së burimeve të ripërtëritshme, lidhjeve të dobëta energjetike rajonale që e kufizojnë aftësinë e Kosovës për importimin e energjisë elektrike si dhe mungesës së burimeve ose gypave të gazit natyror për importimin e gazit. Kjo e pengon zhvillimin dhe investimet, përderisa termocentralet e vjetruara të Kosovës (që prodhojnë 97 përqind të energjisë elektrike sipas vlerësimeve tona) kanë intensitetin më të lartë të dioksidit të karboni në Ballkanin Perëndimor.
- Si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në direktivat e BE për kontrollimin e emetimeve. Për adresimin e problemeve me furnizimin energjetik dhe sfidat përkatëse mjedisore, Kosova, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe partnerët tjerë zhvillimor, ka zhvilluar një **strategji energjetike shumë drejtimëshe që mbulon nevojat e saj afatgjate energjetike** dhe që ka për qëllim (i) të sigurojë furnizim adekuat dhe të qëndrueshëm me energji elektrike; (ii) të reduktojë nevojën për subvencionimin shtetëror të sektorit të energjisë; (iii) të kufizojë ndotjen e mjedisit; dhe (iv) të tërheqë investimet nga sektori privat për prodhimin dhe distribuimin e energjisë elektrike.
- Planet e qeverisë për **Termocentralin e ri me linjit Kosova C** po avancojnë ngadalë që nga viti 1999. Projekti është ende në zhvillim e sipër me përfshirjen e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), si këshilltare e transaksionit, si dhe Grupin e Bankës Botërore nga e cila Kosova ka kërkuar një Garanci të Pjesëshe të Rrezikut (GPRR) për tërheqjen e investitorëve privat për ndërtimin e termocentralit.
- Importet neto të energjisë elektrike janë shumë të ulëta në 152 GWh ose 10 përqind të furnizimit me energji elektrike. Pasi që **siguria energjetike e Kosovës nuk duhet të barazohet me vetë-mjaftueshmërinë vendore** dhe progresi në diversifikimin e burimeve energjetike është kyç, duhet të inkurajohet hapja e tregut dhe rritja e ndërlidhjeve me qëllim të shfrytëzimit të kapaciteteve hidroenergjetike në rajon. Një linjë e re e transmisionit 400 kV në kufi me Shqipërinë është inauguruar dhe integrimi rajonal gjithashtu do të ndihmojë në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme.
- **Energjia e ripërtëritshme mund të zbusë hendekun e parashikuar energjetik dhe të rrisë sigurinë energjetik dhe stabilitetin mjedisor.** Prioritetet kryesore lidhur me **energjinë e ripërtëritshme** përfshijnë eliminimin e barrierave administrative dhe zhvillimin e një kornize të qëndrueshme për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Kosova aktualisht nuk i shfrytëzon në masë të mjaftueshme burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), duke prodhuar vetëm 3 përqind të energjisë nga këto burime, ndërsa ka për qëllim që ta arrijë shifrën prej 25 përqind deri në vitin 2020 sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim. Zyra e Rregullatorit të Energjisë tashmë i ka aprovuar tarifat për të gjitha llojet e energjisë së

ripërtëritshme. Sfidat kryesore përfshijnë nevojën për krijimin e procedurave adekuate të koncesionimit dhe licencimit si dhe MBEE të qëndrueshme. Qeveria është duke shqyrtuar gjithashtu edhe krijimin e një One Stop Shop për mbështetjen e zhvillimit të projekteve për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë brenda shtetit.

- Në kombinim me çështjet që ndërlidhen me pjesën e ofertës së energjisë, **pjesa e kërkesës dhe eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët** (NVM-të privat, ndërtesat rezidenciale, institucionet publike) paraqet një sfidë të rëndësishme pasi që intensiteti i përgjithshëm energjetik i Kosovës vazhdon të jetë në masë të konsiderueshme më i lartë se mesatarja e BE-së (dhe ndër më të lartat në Ballkanin Perëndimor).
 - Infrastruktura për eficiencën e energjisë është duke u zhvilluar me ritëm të ngadalshëm. Eficienca e energjisë mund të ndihmojë në zbutjen e mungesës së energjisë, duke rritur njëkohësisht sigurinë energjetike dhe mbrojtjen e mjedisit. Ekziston një potencial shumë i lartë për kursimin e energjisë elektrike në ndërtesat publike (prej 38-47 përqind në ndërtesat komunale dhe deri në 49 përqind në ndërtesat e qeverisë qendrore (Banka Botërore). Aktualisht, konsumi jo efikas i energjisë e rrit koston e të bërit biznes dhe ndikon drejtpërdrejtë në konkurrueshmërinë e kompanive. Kosova ka njërën nga shkallët më të larta të konsumit të energjisë nga sektori rezidencial në rajonin e Ballkanit. Më saktësisht, mbi 60 përqind e kërkesës totale për energji elektrike shkon për konsum rezidencial. Industritë gjithashtu janë mjaft intensive nga aspekti energjetik ndërkaq vazhdojnë të ekzistojnë edhe barrierat që nuk ndërlidhen me çmimin për eficiencën e energjisë. BE ka planifikuar ofrimin e asistencës teknike për periudhën 2016-18 për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë për përmirësimin e kornizës ligjore për eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme si dhe për zhvillimin e procesit të planifikimit qendror (përditësimin e planit kombëtar afatgjatë për eficiencën e energjisë dhe rishikimin e caceve kombëtare për BRE), si dhe për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal/komunal, duke përfshirë masat për eficiencën e energjisë dhe kostot e ndërlidhura të implementimit.
 - Kosova duhet të **përmirësojë dhe modernizojë më tutje sistemin e transmissiionit të energjisë dhe të reduktojë humbjet komerciale dhe teknike në rrjetin e distribuimit**, që aktualisht përbën 28.46 përqind të konsumit bruto të energjisë elektrike. Një pjesë e konsiderueshme e humbjeve u atribuohet vjedhjeve, që nuk mund të adresohet plotësisht pa kryerjen e përmirësimeve përkatëse teknike. Gjithashtu, njëra nga pengesat kryesore lidhur me humbjet komerciale dhe teknike ka të bëjë me mbledhjen e borxheve dhe të ardhurave në Kosovën Veriore (PRE, 2016).
 - **Tarifat janë tejet nën nivelin e reflektimit të kostos** dhe autoritetet janë duke përgatitur një plan për rritjen graduale të tarifave të energjisë për reflektimin e kostos faktike, së bashku me masa mbështetëse për grupet e cenueshme të konsumatorëve. Autoritetet duhet të fuqizojnë kapacitetin institucional të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, që është përgjegjëse për rregullimin e sektorit të energjisë dhe tarifave në Kosovë si dhe përmirësimin e mbledhjes.
- Përfundimisht, Kosova duhet të sigurojë **menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore**, duke qenë se infrastruktura mjedisore është përgjithësisht e nën-financuar në Kosovë.

- Kosova ka burime të kufizuara të ujit të ndara në katër bazamente kryesore të ujit që paraqet kufizim për zhvillimin socio-ekonomik të shtetit për shkak të kërkesës së rritur për ujë. Nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë, që e rrit mundësinë e kontaminimit të ujit.
- Mungesa e masave adekuate për mbrojtje të mjedisit ka rezultuar në ndikime serioz mjedisore nga mbeturinat industriale për shkak të aktiviteteve të mëparshme minerare. Aktualisht, nuk ka një proces adekuat për menaxhimin e cilitdo lloj të mbeturinave.

Përgjigjia Operacionale

- Intensiteti energjetik i Kosovë është ndër më të lartit në rajonin e veprimit të BERZH për shkak të disa termocentraleve të vjetruara. Në përpjekjet për të ndihmuar qeverinë për plotësimin e nevojave aktuale dhe të ardhshme energjetike dhe për adresimin e “*mungesës energjetike*”, njëkohësisht duke balancuar kostot ekonomike, financiare dhe mjedisore, Banka do të shqyrtojë mundësinë e investimeve në ndërtimin e **kapaciteteve të reja gjeneruese** në koordinim me INF-të dhe donatorët e tjerë. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e energjisë elektrike përmes termocentraleve me qymyr, nëse këto termocentrale i plotësojnë kërkesat e Strategjisë për Sektorin Energjetik të Bankës të vitit 2013.
- Banka do të shqyrtojë mundësinë e financimit të **projekteve për energjinë e ripërtëritshme** përmes kreditimit të drejtpërdrejtë (duke përfshirë Mekanizmin për Financim të Drejtpërdrejtë) ose përmes linjave të dedikuara të kreditimit me institucionet lokale financiare, përfshirë këtu edhe NVM-të.
- Për reduktimin e intensitetit relativisht të lartë energjetik të Kosovës, Banka do të vazhdojë të përfshihet në diskutime me Komisionin Evropian lidhur me MFEQBP, duke marrë parasysh se tani Kosova kualifikohet për investime përmes këtij mekanizmi. Sipas kësaj kornize, Banka është duke ofruar financim afatgjatë me grante dhe asistencë teknike për **investime të qëndrueshme energjetike** për nën-kredituesit në NVM dhe ndërtesa private rezidenciale (në kuadër të PREE).
- Banka do të shqyrtojë mundësitë për lancimin e produkteve të reja financiare për mbështetjen e **investimeve për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesat publike** përmes strukturave më të përshtatshme të financimit (KKE, komunale ose sovrane).
- Banka gjithashtu do të shikojë mundësinë e lancimit të linjave të kreditimit për **Efikasitetin e Burimeve** për ujësjellësin, mbeturinat dhe materialet efikase si dhe për zbutjen e pasojave të ndryshimeve klimatike.
- Banka do të shqyrtojë mundësinë e fuqizimit dhe modernizimit të **infrastrukturës kombëtare të rrjetit të transmisionit**.

Dialogu për politika

- Banka do të angazhohet në dialog të politikave me qeverinë dhe ZRE lidhur me projektet e mundshme për energjinë e ripërtëritshme. Përmes mbështetjes teknike dhe koordinimit me INF-të dhe donatorët e tjerë, Banka do të rekomandojë zhvillimin e zgjidhjeve të përshtatshme. Kjo përfshin Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë që janë të ligjshme dhe të pranueshme, masat e përballueshmërisë si dhe sigurimin e suksesit të këtyre projekteve. Realizimi i projekteve për eksploatimin e potencialit për energji

të ripërtëritshme të Kosovës varet në masë të madhe nga përkushtimi i vazhdueshëm i Qeverisë për zhvillimin e kornizës përkatëse ligjore.

- Nëse kërkohet nga autoritetet, Banka do të ofrojë këshilla për politika dhe mundësisht të bashkë-financojë Fondin për Eficiencën e Energjisë i cili është duke u shqyrtuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me kontributin potencial nga fondet e BE për subvencionimin e investimeve në eficiencën e energjisë në ndërtesat publike dhe sektorin rezidencial.
- Në kuadër të fazës së ardhshme të Programit Rajonal për Eficiencën e Energjisë në Ballkanin Perëndimor, Banka planifikon të vazhdojë implementimin e aktiviteteve për dialogun e politikave në shtetet e Ballkanit Perëndimor (duke përfshirë Kosovën) që kanë për qëllim përmirësimin e kornizës ligjore për eficiencën e energjisë me fokus të veçantë në sektorin e ndërtesave (duke përfshirë legjislacionin dhe rregulloret lidhur me shoqatat e pronarëve të shtëpive dhe marrëveshjet kolektive për menaxhimin e ndërtesave rezidenciale me qëllim të përmirësimit të eficiencës së energjisë në ndërtesa).

Korniza e Rezultateve për Temën 2: Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes financimit të investimeve në këtë sektor, mbështetjen e reformave të sektorit, promovimin e eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme

	SFIDAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	INDIKATORËT
2.1	Kosova vuan nga mungesa e kapaciteteve energjetike dhe ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike	Mundësimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji vendore përmes rritjes së shfrytëzimit të burimeve vendore energjetike	- Investimi në kapacitetet e reja energjetike në koordinim me IFN-të dhe donatorët tjerë, duke përfshirë prodhimin e energjisë elektrike përmes termocentraleve në pajtim me Strategjinë e Bankës për Sektorin e Energjisë. - Financimi i investimeve më të mëdha të ER përmes kreditimit të drejtpërdrejtë. - Financimi i stabilimenteve më të vogla të ER përmes linjave të dedikuara të kreditimit dhe produkteve për ndarjen e rrezikut me institucionet lokale financiare me fokus të veçantë në hidro-energji të shkallës më të vogël, biomasë dhe biogaz në shkallë më të vogël.	- Rritja e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme e financuar me mbështetjen e Bankës (në MW) (<i>Baza fillestare – 0</i>) - Shembuj të klientëve që përdorin teknologjinë më të mirë në dispozicion dhe/ose plotësojnë standardet mjedisore përmes investimeve në kapacitetet e reja gjeneruese. (<i>Baza fillestare – përcaktohet në kohën e aprovimit të projektit</i>)
2.2	Intensiteti energjetik i Kosovës vazhdon të jetë ndër më të lartit në rajonin e veprimit të BERZH	Përmirësimi i eficiencës së energjisë	- Financimi i investimeve të EE, duke përfshirë ndërtesat rezidenciale (PREE) dhe NVM, potencialisht në bashkëpunim të ngushtë me Fondin qeveritar për Eficiencën e Energjisë (që do të themelohet), duke pranuar parimet e qeverisjes dhe operimit të fondit. - Shqyrtimi i mundësive për financimin e investimeve në EE në ndërtesat publike përmes strukturave më të përshtatshme të financimit (KKE, komunale ose sovrane). - Dialogu për politika, duke përfshirë ofrimin e asistencës teknike, për të lehtësuar zhvillimin e strukturës rregullatore për EPC.	- Reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit (CO₂) si rezultat i aktiviteteve të Bankës në tCO₂e/vit (<i>Baza fillestare – 0</i>) - Numri i projekteve të energjisë / efikasitetit të burimeve të implementuara me sukses dhe/ose nën-projekteve të financuara përmes bankave lokale në kuadër të kornizave për eficiencën e energjisë/burimeve (p.sh. MFEQBP) (<i>Baza fillestare – përcaktohet në kohën e aprovimit të projekteve</i>)
Indikatori i kontekstit: Δ Intensiteti Energjetik i Kosovës (<i>Baza Fillestare 2013: 0.46 TPES/BPV – ton/mijëra 2005 Dollar Amerikan</i>). Burimi: ANE 2013				

Tema 3: Mbështetja e ndërlidhjes dhe integritetit rajonal

Sfidat e tranzicionit

- Integrimi i Kosovës në tregjet rajonale është duke hasur në vonesa. Investimet madhore në infrastrukturën e rajonit, së bashku me reformat përkatëse, mund të ndihmojnë në nxitjen e ndërlidhjeve dhe rrjedhimisht edhe tregtisë dhe investimeve me shtetet fqinje.
- **Transportet:** Duhet të ndiqen rritja e bashkëpunimit rajonal në agjendën e ndërlidhjeve për transport d.m.th zgjerimin e rrjetit Trans-Evropian në Ballkanin Perëndimor, përmirësimi dhe harmonizimi i politikave të transportit rajonal dhe i standardeve teknike, si dhe zhvillimi i kapaciteteve për implementimin e programeve investive.
 - Në **sektorin e hekurudhave** ka nevojë për ristrukturim të thellë për të siguruar që rrjeti dhe operacionet janë të qëndrueshme dhe në kohë afatgjatë dhe konkurruese me metodat alternative të transportit. Nga perspektiva rajonale, sfidat kryesore janë përmirësimi i lidhjeve në rrjetin TEN-T dhe prioritetet e financimit, si dhe përfshirja e konkurrencës në fushën e transportit hekurudhor të mallrave.
 - Mbështetja në **ndërtimin e terminaleve multi-modale** do të kontribuojë në plotësimin e standardeve mjedisore të BE, duke qenë se Qeveria është ende prapa me implementimin e Strategjisë së Transportit Multi-Modal (të përgatitur me mbështetjen e BE në vitin 2009) që përfshin:
 - Ndërlidhjen e sistemit të propozuar të transportit multi-modal me rrjetet relevante të transportit multi-modal të BE përmes bashkëpunimit me entitetet lokale/rajonale/ndërkombëtare dhe aleancave strategjike me kompanitë përkatëse;
 - Zhvillimi dhe modernizimi i terminalit ekzistues multi-modal në Miradi për pranimin e trenave të ngarkuar me gjatësi 550 m që vijnë nga BE.
 - Zhvillimi dhe modernizimi potencial i terminaleve të tjera, posaçërisht në veri të vendit, për shkurtimin e lidhjeve me rrjetin e BE (Korridori Hekurudhor X) përmes Beogradit (Serbi).
 - Në **sektorin e rrugëve**, sfidat kryesore janë financimi i sektorit të rrugëve, themelimi i Agjencisë së Rrugëve me përgjegjësi të definuara, alokimi i financimit dhe sqarimi i bashkëpunimit mes qeverisë dhe Agjencisë së Rrugëve, si dhe rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e rrugëve, duke përfshirë edhe Partneritetin Publiko Privat (PPP) në kohën e duhur.
- **Energjia:** Në sektorin e energjisë, Kosova ballafaqohet me sfidën e ndërlidhjes me tregun e energjisë në Evropën Juglindore (EJL) si dhe modernizimin dhe fuqizimin e infrastrukturës së rrjetit të transmisionit për përmirësimin e tregtisë ndër-kufitare, reduktimin e humbjeve dhe mundësimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në këtë sektor, posaçërisht në segmentin e tregtisë. Kosova e ka përfunduar ndërtimin e pjesës së saj të linjës së tensionit të lartë me Shqipërinë. Duke përdorur këtë linjë, Kosova mund të fillojë zhvillimin e një tregu të përbashkët të energjisë me Shqipërinë, që do të rriste në masë të konsiderueshme sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

- Disbalancat e konsiderueshme në tregtinë aktuale janë shqetësuese (PRE, 2016). Kapaciteti eksportues i Kosovës vazhdon të jetë i dobët, megjithëse është në rritje e sipër. Njëra nga dobësitë kryesore, dhe të vazhdueshme, në konkurrueshmëri dhe kapacitetin eksportues është mungesa e pajtueshmërisë me standardet e BE për cilësi, ndërsa IHD janë të pamjaftueshme për të pasur ndikim domethënës zhvillimor. Pavarësisht regjimit liberal tregtar me normë doganore të rrafshët prej 10 përqind për importe dhe anëtarësisë së Kosovës në Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë që nga Janari 2015 dhe qasjen pa norma doganore në BE dhe SHBA sipas Sistemit të Përgjithshëm Preferencial, kompanitë Kosovare nuk kanë qenë në gjendje të shfrytëzojnë (plotësisht) mundësitë e ofruara nga këto tregje të eksportit. Në veçanti, duhet adresuar masat për lehtësimin e tregtisë sikurse Barrierat Jo-Tarifore, Barrierat Teknike për Tregti dhe Standardet Sanitare dhe Fitosanitare, në mënyrë që të rritet qarkullimi tregtar ndër-kufitar, duke përfshirë koordinimin e aktiviteteve në nivelin shtetëror dhe rajonal. Autoritetet Kosovare, në veçanti Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), duhet të vazhdojnë përpjekjet për modernizimin e Infrastrukturës së Cilësisë (duke përfshirë standardizimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe akreditimin) për reduktimin e barrierave tregtare dhe mundësimin e qasjes më të mirë në tregun e BE dhe në tregjet ndërkombëtare për kompanitë Kosovare.

Përgjigjja operacionale

- **Transportet:**
 - o Angazhimi i planifikuar BERZH në Agjendën e Ndërlidhjes (Konektivitetit) ka mbështetjen e fuqishme të BE. Banka do të shqyrtojë mundësitë për promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës së transportit ndër-kufitar për fuqizimin e lidhjeve ekonomike rajonale, duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët në KIBP për mobilizimin e granteve për investime si dhe të asistencës teknike. Në kuadër të këtyre iniciativave, është jetike që të sigurohet konsistenca me iniciativat ekzistuese, siç është Lista e Vetme e Projekteve dhe Komiteti Kombëtar për Investime.
 - o **Hekurudhat:**
 - Banka do të vazhdojë të mbështesë modernizimin dhe zgjerimin e infrastrukturës hekurudhore, me qëllim të ndërlidhjes së rrjetit hekurudhor të Kosovës me rrjetin Evropian përmes Serbisë dhe IRJ të Maqedonisë përmes Korridorit X dhe Korridorit VIII (ky i fundit e lidh bregdetin e detit të zi në Bullgari me bregdetin Adriatik në Shqipëri si dhe Turqinë).
 - Me rëndësi të njëjtë duke marrë parasysh investimet e reja në rrjetin hekurudhor, Banka do të promovojë reformat në këtë sektor përmes fuqizimit të kapaciteteve të akterëve kyc, kryesisht INFRAKOS, TRAIKOS dhe Autoritetit Rregullator të Hekurudhave.
 - Banka do të shqyrtojë mundësinë për përfshirje në implementimin e strategjisë së transportit multi-modal (të përgatitur me mbështetje të BE në vitin 2009).
 - o **Rrugët:**

- Banka do të synojë financimin e modernizimi dhe zgjerimi të rrjetit kombëtar dhe rajonal të rrugëve, në veçanti seksionet rajonale dhe Pan-Evropiane të transportit në Kosovë, si vijon:
 - Segmenti rrugor Kijevë – Pejë që është pjesë e Rrugës Transportues të Evropës Juglindore SEETO 6b nga Prishtina në Pejë;
 - Segmenti rrugor Prishtinë-Merdare (Pjesë e Rrugës 7 SEETO) që lidh Serbinë, Kosovën dhe Shqipërinë (Nish – Prishtinë – Durrës), që është pagëzuar si “Autostrada e Paqes”;
 - Autostrada Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë.
- Banka do të punojë ngushtë me BE-në dhe INF-të tjera për identifikimin e strukturës së përshtatshme të financimit të këtyre projekteve duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e sektorit privat (gjithashtu përmes kontratave të mirëmbajtjes të bazuara në performancë) në rastet kur kjo është e mundshme.

O Aeroportet:

- Banka do të synojë të mbështesë planet investive të agjencisë së navigimit ajror me qëllim të modernizimit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë ofrimin e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve institucionale.

• Energjia:

Banka do të synojë të mbështesë investimet private që kanë për qëllim përmirësimin e ndërlidhjeve energjetike rajonale të Kosovës (Kosova është afër përfundimit të pjesës së saj të linjës së transmisionit 400 kV me Shqipërinë, që i mundëson Kosovës shkëmbimin e energjisë elektrike dhe maksimalizimin e shfrytëzimit të hidrocentraleve të Shqipërisë në dimër).

- Banka do të vazhdojë të mbështesë **tregtinë ndër-kufitare** përmes Programit për Lehtësimin e Tregtisë, si dhe përmes këshillimit të bizneseve të vogla lidhur me gatishmërinë për eksport. Përmes iniciativës për Këshillimin e Bizneseve të Vogla, Banka do të mbështesë promovimin e tregtisë për ndërlidhjen më të ngushtë të rajonit me tregun e BE-së.

Dialogu për politika

- Banka do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Infrastrukturës për zhvillimin e një mekanizmi dhe procedurave të përshtatshëm për aprovimin e brendshëm të investimeve prioritare. Gjithashtu, Banka do të mbështesë Ministrinë për zhvillimin e kapaciteteve të prokurimit dhe menaxhimit mjedisor si dhe të shëndetit dhe sigurisë. Varësisht nga përkushtimi i autoriteteve, Banka do të ndihmojë në krijimin e Agjencisë së Rrugëve, si një organ i pavarur me përgjegjësi të definuara.
- Banka do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Infrastrukturës në rritjen e financimit për mirëmbajtjen e rrugëve, me qëllim të arritjes së një niveli të qëndrueshëm brenda një kohe të arsyeshme, përmes reformave dhe rritjes së mundshme të tarifave për

përdoruesit e rrugëve. Banka do të ndihmojë në kryerjen e një studimi për financimin e rrugëve për të përcaktuar nivelet adekuate dhe të arritshme të financimit si dhe burimet e të ardhurave për financimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore.

- Banka do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Drejtorinë e Rrugëve për zhvillimin e ekspertizës vendore në fushën e sigurisë rrugore në mënyrë që auditimet e sigurisë rrugore të jenë pjesë standarde e të gjitha projekteve rrugore dhe gjitha çështjet e identifikuara nga këto auditime të adresohen.
- Varësisht nga përkushtimi i qeverisë, Banka do të ndihmojë agjencinë për navigim ajror që të zhvillojë kapacitetet e saj institucionale dhe ta përgatisë këtë agjenci që të operojë në mënyrë adekuate pasi Kosova të marrë kontrollin e plotë të hapësirës së lartë ajrore në të ardhmen.
- Banka do të mbështesë Kosovën në harmonizimin e legjislacionit dhe procedurave sipas MSA dhe koordinimin me Komisionin Evropian dhe IFN-të tjera për mbështetjen e realizimit të masave që përfshijnë reduktimin e Barrierave Jo-Tarifore, Barrierave Teknike për Tregti si dhe Standardeve Sanitare dhe Fitosanitare.

Korniza e Rezultateve për Temën 3: Mbështetja e ndërlidhjes dhe integritetit rajonal

	SFIDAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	INDIKATORËT
3.1	Cilësia e infrastrukturës së raportit është prapa shteteve të tjera të rajonit dhe është pengesë për integrimin rajonal	Mbështetja e zgjerimit dhe rehabilitimit të lidhjeve të transportit për lehtësimin e shkëmbimeve ndër-kufitare dhe uljen e kostove të transportit	- Kredi për mbështetjen e ndërlidhjeve rrugore ndër-kufitare, rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit kombëtar rrugor (segmenti rrugor Kijevë – Pejë; segmenti rrugor Prishtinë - Merdare; dhe autostrada Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë. - Kredi për mbështetjen e lidhjes hekurudhore Lindje-Perëndim Kosovë-Serbi. - Mbështetje për sistemin e navigimit ajror. - BT për zhvillimin e kapaciteteve të prokurimit, sigurisë rrugore dhe mekanizmave dhe procedurave të përshtatshme për aprovimin e brendshëm të investimeve prioritare. - Dialogu i politikave për krijimin e Agjencisë së Rrugëve si organ të pavarur me përgjegjësi të definuara në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës.	- Numri i projekteve dhe llogarive kualitative të shërbimeve rajonale të transportit (Baza fillestare – 0) - Themelimi i Agjencisë së Rrugëve me mbështetjen e Bankës përmes dialogut për politika. (Baza fillestare – N/A)
3.2	Siguria energjetike e Kosovës është e rrezikuar nga prodhimi i kufizuar vendor (shih gjithashtu seksionin e mëparshëm) dhe izolimi relativ i tregut energjetik të Kosovës	Zhvillimi i ndërlidhjeve energjetike me shtetet fqinje për përmirësimin e integritetit rajonal dhe rritjen e sigurisë energjetike	- Fuqizimi dhe modernizimi i rrjetit kombëtar të transmisionit, si pjesë e projekti me KOSTT. - Këshilla të investimeve dhe të politikave për përmirësimin e lidhjeve ndër-kufitare të Kosovës, duke përfshirë krijimin e një tregu të përbashkët me Shqipërinë.	Numri i projekteve dhe llogarive kualitative të projekteve të Bankës për zgjerimin e suksesshëm të infrastrukturës energjetike rajonale ndër-kufitare (Baza fillestare – 0)
3.3	Vështirësitë në tregtinë përtej kufijve vazhdojnë, përderisa investimet në rajon duhet të inkurajohen	Mbështetja e rritjes së investimeve dhe qarkullimit tregtar me rajonin në përgjithësi	- Zgjerimi i PLT - Mbështetje në kuadër të Programit për Këshillimin e Bizneseve të Vogla për rritjen e potencialit eksportues të kompanive të vogla. - Hulumtimi i mënyrave për mbështetjen e zhvillimit të masave të buta duke përfshirë reduktimin e Barrierave Jo-Tarifore për tregtinë.	- Numri total dhe volumi i projekteve të financimit TFP të kryera nga bankat klientë (Baza fillestare – përcaktohet në kohën e aprovimit të projekteve) Δ në pjesën e eksporteve në qarkullimin e përgjithshëm të klientëve të KBV (Baza fillestare – përcaktohet në kohën e aprovimit të projekteve)
	Indikatori i kontekstit: Δ Rangimi i Kosovës në Indikatorin “Tregtia Përtej Kufijve” (Baza fillestare 2016: 71). Burimi: Të Bërit Biznes 2016 (Grupi i Bankës Botërore)			

3.3 Menaxhimi i Rreziqeve për Zbatimin e Strategjisë për Kosovën

Strategjia e propozuar për Kosovës është ambicioze, për shkak se reflekton ambiciet e vetë Qeverisë së Kosovës për programin e reformave. Perspektiva e një përgjigje graduale operationale në infrastrukturë, kreditim të sektorit privat dhe privatizim është e ndërlidhur me reformat dhe progresin në zhvillimin e kapaciteteve administrative, programin e privatizimit të qeverisë për NPSH-të e mbetura (duke përfshirë PTK dhe kompleksin mineral Trepça), shfrytëzimin e hapësirës shtesë fiskale të parapare në PSB të FMN dhe situatën politike me Serbinë.

Kapaciteti i Bankës për zbatimin e Strategjisë për Kosovën do të varet nga disa faktorë që janë jashtë kontrollit të Bankës. Kur është e përshtatshme, Banka do të punojë në adresimin dhe zbutjen e këtyre rreziqeve përmes angazhimit proaktiv dhe të qëndrueshëm me klientët, autoritetet dhe akterët e tjerë.

- **Qëndrueshmëria e përkushtimit të Qeverisë për reforma.** Progresi i përgjithshëm do të varet nga përkushtimi dhe vazhdimi i dinamikës së reformave nga ana e qeverisë. Këtu përfshihen jo vetëm reformat legjislative, mirëpo, e rëndësishme së veçantë, edhe implementimi efektiv, pavarësisht nga kapacitetet e kufizuara administrative.
- **Rreziqet makro-ekonomike.** Sektori i jashtëm në Kosovë pengohet nga fuqia punëtore jo konkurruese. Pagat e larta, posaçërisht në sektorin publik dhe kapitali i ulët njerëzor janë pengesë për zhvillimin e sektorit të tregtisë. Përdorimi i Euros nga ana e Kosovës e eliminon mundësinë e devalvimit për rritjen e konkurrueshmërisë. Eksportet e dobëta kombinuar me remitencat e konsiderueshme nga diaspora Kosovare kanë krijuar deficit të konsiderueshëm (8 përqind të BPV në vitin 2015). Për krijimin e një sektori privat që është në gjendje të konkurrojë në tregun ndërkombëtar, vecanërisht në prodhimin e të mirave, kërkohet reforma të thella strukturore.
- **Ekzistojnë disa rreziqe politike dhe të qeverisjes.** Është bërë progres në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes grupeve të ndryshme etnike, posaçërisht sa i përket krijimit të Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë (AKSK), përmes të cilit rajoni verior i banuar nga Serbët do të ketë kuvendit e vet dhe përfaqësimin në Prishtinë. Megjithatë, grupet opozitare kanë kontestuar ligjshmërinë e marrëveshjes për themelimin e AKSK. Kosova vazhdon të mos njihet nga një numër i madh i shteteve, duke përfshirë Serbinë, dhe potenciali për tension mes grupeve të ndryshme etnike dhe bllokadës politike vazhdon të jetë i lartë. Pasiguria politike do të vazhdojë të paraqes pengesë për investimet e jashtme të nevojshme për zhvillimin e sektorit privat.
- **Mungesa e projekteve investive.** Rritja e volumit të investimeve në sektorin privat nga baza aktuale e ulët për mbështetjen e konkurrueshmërisë në sektorin privat (Tema 1) do të varet kryesisht nga progresi në përmirësimin e klimës së investimeve si dhe IHD-të. Kjo përfshin, për shembull, luftimin e informalitetit për të mundësuar zhvillimin e zingjirëve të vlerës brenda shtetit dhe zgjerimin e bazës së kompanive që kualifikohen për financim nga BERZH. Gjithashtu, aftësia e Kosovës për tërheqjen e investimeve të huaja direkte do të varet nga respektimi i marrëveshjeve aktuale dhe respektimi i ‘rregullave të lojës’. Në mënyrë që Banka të jetë në gjendje të mbështesë zhvillimin e sektorit privat duhet të ketë vazhdimisht projekte cilësore të investimeve me investitorë vendor ose të huaj si dhe kanale adekuate për ndërmjetësim financiar.

Megjithatë, ekziston mundësia që shumica e volumit të biznesit do të jetë në sektorin publik, posaçërisht duke marrë parasysh rëndësinë e Temës 3.

- **Hapësira shumë e kufizuar fiskale.** Shumë projekte – nga infrastruktura dhe deri tek promovimi i NVM-ve – do të kërkojnë burime të konsiderueshme nga donatorët, si në formë të BT ashtu edhe granteve investive.

3.4 Implikimet Mjedisore dhe Sociale të Aktiviteteve të Propozuara nga Banka

Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE në Tetor 2015 do të vazhdojë përafrimin e legjislacionit mjedisor me legjislacionin e BE, që paraqet një bazë të mirë për strukturimin e aktiviteteve të Bankës në pajtim me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale (PMS) dhe Kërkesat e Performancës (KP). Këto përfshijnë kërkesat sociale kur projektet mund të kenë ndikim negativ në minoritetet etnike, personat e zhvendosur ose të cenueshëm.

Aktivitetet e Bankës që ndërlidhen me privatizimin dhe zhvillimin e sektorit privat do të jenë mënyrë efektive për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës për periudhën 2016-2021, që ka për qëllim të shërbejë si bazë e qëndrueshme për zhvillim gjithëpërfshirës. Duhet të ketë kujdes të shtuar për të siguruar që ndotja nga aktivitetet e të shkuarës të hetohet për të shmangur mundësinë që operatorët privat të jenë përgjegjës për kontrollimin dhe pastrimin e ndotjes historike.

Në sektorin e infrastrukturës mjedisore të komunave, nevojat për investime në ndërtimin, rehabilitimin dhe modernizimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sisteme për trajnimit e ujërave të zeza si dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave të ngurta janë substanciale. Financimi i projekteve në këtë sektor do t'i ofrojë Bankës mundësi të konsiderueshme për arritjen e përfitimeve të prekshme mjedisore dhe sociale dhe përmirësimin e shëndetit publik. Kufizimet lidhur me përballueshmërinë financiare që ka të bëjë me rritjen e tarifave për shërbimet komunale duhet të merren parasysh, duke marrë parasysh që një numër i konsiderueshëm i njerëzve vlerësohet se jetojnë nën kufirin e varfërisë dhe se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, përafërsisht 17 përqind, ballafaqohen me varfëri të skajshme.

Projektet që përfshijnë ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës së transportit do t'i mundësojnë Bankës që të kontribuojë në përmirësimin e mobilitetit dhe kohezionit social dhe përfshirjes. Standardet mjedisore dhe sociale të Bankës, kërkesat dhe proceset do të duhet të respektohen në mënyrë që të shmangen ose zbuten pasojat negative që ndërlidhen me ndërtimin e infrastrukturës së re të transportit. Konsultimi publik dhe zbulimi i informacionit do të jetë pjesë e rëndësishme e zhvillimit të projekteve, në veçanti për projektet që mund të kenë ndikim të madh tek grupet e cenueshme dhe minoritetet. Projektet e infrastrukturës së transportit e obligojnë BERZH që të ketë qasje të kujdesshme për të siguruar që këto projekte nuk ndikojnë në mënyrë negative në biodiversitetin përmes ndarjes së habitateve të ndjeshme, zonave të mbrojtura ose zonave të propozuara në Emerald ose Natura 2000.

Në sektorin e energjisë, nga Banka mund të kërkohet që të shqyrtojë investimin në kapacitetet e reja gjeneruese, duke përfshirë në termocentrale me linjit. Çdo vlerësim i Bankës do të ndërmerret në koordinim të ngushtë me IFN dhe donatorët, dhe të përfshijë një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social ("VNMS"). Kjo do të përfshinte një analizë të alternativave dhe teknologjive për kapjen dhe ruajtjen e karbonit. Banka gjithashtu pret që të ketë një

proces të pjesëmarrjes publike dhe konsultime. Gjithashtu, çfarëdo financimi nga Banka për gjenerim të energjisë elektrike me linjit do të duhet të plotësojë kërkesat në Strategjinë e Sektorit të Energjisë të Bankës të vitit 2013. Sa i përket projekteve për transmisionin dhe distribuimin, Banka do të sigurojë plotësimin e kërkesave lidhur me shëndetin dhe sigurinë publike dhe zhvendosjen jo vullnetare të popullatës. Projektet e energjisë së qëndrueshme të financuara ose drejtpërdrejtë nga BERZH ose përmes programeve financiare me bankat lokale të fokusuara në projekte të vogla për energjinë efiçiente dhe energjinë e ripërtëritshme paraqesin mundësi të konsiderueshme për reduktimin e emetimeve në ajër dhe ndikimit të ndërlidhur me shëndetin publik. Gjatë vlerësimit të projekteve hidroenergjetike, Banka do të sigurojë që çfarëdo ndikimi potencial i drejtpërdrejtë, i tërthortë ose kumulativ në mjedis dhe biodiversitet të vlerësohet dhe adresohet në mënyrë adekuate.

Shëndeti dhe siguria vazhdojnë të jenë faktorë të rëndësishëm që merren parasysh në të gjitha projektet e BERZH. Në infrastrukturën e transportit dhe projektet e transportit urban, Banka do të kërkojë kryerjen e vlerësimeve të sigurisë rrugore dhe të mbështesë iniciativat për promovimin e sigurisë rrugore. BERZH do të punojë me klientët në sektorin e energjisë, energjisë elektrike, minierave dhe transportit për minimizimin e rrezikut nga aksidentet dhe fatalitetet përmes dizajnit të mirë të projekteve dhe praktikave të mira në menaxhimin e sigurisë.

3.5 Bashkëpunimi i BERZH me BMZH

Koordinimi i donatorëve dhe IFN në Kosovë udhëhiqet nga Ministria e Integritimit Evropian, ndërsa Delegacioni i BE organizon takime të rregullta të donatorëve. Banka është ngushtë e angazhuar në procesin e koordinimit përmes këtyre institucioneve si dhe përmes takimeve për projekte specifike dhe kontakte të shpeshta bilaterale:

- Sa i përket projekteve të konsiderueshme të ardhshme investive, **Banka Botërore** është shumë e përfshirë në projektin Kosova C dhe projektin për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit që ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit të Kanalit Ibër-Lepenc dhe përmirësimin e shtratit të lumit Ibër. Këto projekte gjithashtu mund të ofrojnë mundësi për bashkëpunim të ardhshëm dhe bashkë-financim të Bankës me Bankën Botërore.
- Deri më ani, Banka nuk ka pasur mundësi të bashkëfinancimit të Projekteve në Kosovë me **IFC** mirëpo mund të ketë mundësi të tilla në të ardhmen.
- Përfshirja e **BEI** do të lehtësojë bashkëfinancimin e projekteve me donatorët tjerë dhe të mbështesë zbatimin e FFnB dhe FZHIN në Ballkanin Perëndimor. Në sektorin e transportit, Banka është duke punuar ngushtë me BEI në disa projekte, duke përfshirë Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10, segmentit rrugor Kijevë-Pejë dhe autostradës Prishtinë-Merdare, pjesë e Rrugës 7 që lidh Kosovën, Shqipërinë dhe Serbinë.
- Gjatë periudhës së strategjisë, mund të ketë potencial për bashkëfinancim me KfW në sektorin e energjisë dhe ujit.

ANEKSI 1 – VLERËSIMI POLITIK

Kosova është e përkushtuar tu përmbahet parimeve të demokracisë shumë-partiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut në pajtim me kushtet e përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës.

Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Çështja e ligjshmërisë së këtij veprimi u shqyrtua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) pas referimit të kësaj çështje nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (APKB). GJND nxori vendimin e saj me 22 korrik 2010 në të cilin konstaton se “Shpallja e Pavarësisë nuk shkel ndonjë rregull të aplikueshme të drejtësisë ndërkombëtare”⁴. Megjithëse ky vendim kishte statusin e Opinionit Këshillëdhënës, që si i tillë nuk është detyrues për asnjë shtet, ky vendim u konfirmua në shtator të vitit 2010 përmes një Rezolute të APKB e cila “pranon përmbajtjen e vendimit të GJND”. Megjithëse shumë shtete ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe njohja e saj mbetet të vendoset në mënyrë individuale nga secili shtet anëtar i bashkësisë ndërkombëtare, numri i njohjeve bilaterale është rritur gradualisht dhe deri në mes të vitit 2016 ka kaluar 110 njohje. Kundërthëniet e vazhdueshme lidhur me njohjen ndërkombëtare të Kosovës mes akterëve të ndryshëm në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare ndikojnë në vlerësimin e situatës në Kosovë nga akterë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Korniza kushtetuese dhe legjislativë për një demokraci pluraliste dhe demokratike me ndarje të qartë të pushteteve dhe sistem të kontrolleve dhe balancave, garantimi i të drejtave themelore dhe mbrojtja e minoriteteve, si dhe roli i shoqërisë civile në Kosovë janë kryesisht në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane.

Dobësitë kryesore të Kosovës, që janë të përbashkëta me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor përfshijnë sundimin e dobët të ligjit, kapacitetin e ulët të administratës publike, posaçërisht në nivelin lokal, raportet komplekse ndër-etnike dhe kulturën e pabarabartë të dialogut politik dhe ndërtimit të konsensusit. Progresi në këto fusha ka qenë i ngadalshëm.

Përpjekjet për përafrim me BE vazhdojnë të jenë gurthemeli i reformave të përgjithshme. BE vazhdimisht ka theksuar se Kosova ka të njëjtën perspektivë Evropiane sikurse shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE në tetor 2015. Kjo marrëveshje është aprovuar nga Parlamenti Evropian me 21 janar 2016 dhe ligjërisht ka hyrë në fuqi me 1 prill 2016. Kosova dhe Serbia kanë qenë të angazhuara në një dialog të lehtësuar nga BE qëllimi i të cilit është normalizimi i marrëdhënieve të tyre, që mbetet vendimtare për të dy vendet për të ecur përpara në rrugën e tyre përkatëse evropiane.

Zgjedhjet e Lira dhe Qeveria Përfaqësuese

Zgjedhjet e lira, të drejta dhe konkurruese

Korniza ekzistuese ligjore, që kryesisht përbëhet nga dy akte ligjore (Kushtetuta e vitit 2008 dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i miratuar në të njëjtin vit), mundëson mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, me kusht që autoritetet dhe partitë politike të kenë vullnetin e mjaftueshëm për ta zbatuar këtë kornizë ligjore. Duke filluar në vitin 2010, ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme për ndryshimin e sistemit elektoral, përpjekje këto që kanë dështuar për shkak të mungesës së konsensusit mes akterëve kryesor.

⁴Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Deklaratës Njëanshme të Pavarësisë së Kosovës, Opinion Këshillëdhënës, Raportet e GJND 2010, f.53

Zgjedhjet në Kosovë në përgjithësi janë konkurruese mes partive të ndryshme politike, duke përfshirë partitë që përfaqësojnë minoritetet etnike, dhe zgjedhjen e lirë për votuesit. Kandidatët janë të lirë që të bëjnë fushatën e tyre politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm dhe i pavarur i cili emërohet nga Kuvendi për një mandat katërvjeçar dhe vepron në mënyrë efikase dhe transparente. Mediat mbulojnë fushatat elektorale në mënyrë të përgjithshme dhe me mbulim të gjerë. Kodi Zgjedhor mundëson vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendor dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

Në të kaluarën, zgjedhjet në Kosovë janë organizuar nga OSBE. Duke filluar në vitin 2008, organet vendore zgjedhore kryejnë funksionet ekzekutive, ndërsa OSBE vazhdon të veprojë në rol këshillëdhënës jo-ekzekutiv. Zgjedhjet e fundit të përgjithshme, që janë mbajtur në qershor 2014, kanë qenë të dytat të organizuara vetëm nga autoritetet e Kosovës dhe të parat që janë zhvilluar në tërë territorin e shtetit, duke përfshirë në Kosovën Veriore me popullsi shumicë Serbe. Zgjedhjet janë vëzhguar nga Misioni i BE për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). MVZ i ka vlerësuar këto zgjedhje si transparente, ka theksuar faktin që ato janë zhvilluar në mënyrë paqësore dhe në përgjithësi ka konkluduar se këto zgjedhje “paraqesin përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me zgjedhjet e mëparshme”.⁵

Ndarja e pushteteve dhe sistemi efektiv i kontroleve dhe balancave

Korniza e nevojshme kushtetuese dhe legjislative për një demokraci parlamentare me ndarje të qartë të pushteteve dhe sistem efektiv të kontroleve dhe balancave, me legjislativ të pavarur aktualisht ekziston në Kosovë dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane. Gjykata Kushtetuese është e pavarur dhe relativisht efikase dhe është duke luajtur një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Gjatë viteve kjo gjykatë ka nxjerrë disa vendime me ndikim të fuqishëm politik.

Kuvendi unikameral i Kosovës është institucioni kryesor legjislativ i cili zgjidhet me mandat katërvjeçar dhe me 120 vende, duke përfshirë 20 vende të rezervuara për subjektet politike që përfaqësojnë minoritetet etnike. Kompetencat e Kuvendit për kontrollimin e qeverisë dhe ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare janë përgjithësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare, megjithëse parlamenti dhe komisionet e tij duhet të rrisin monitorimin e zbatimit në praktikë të politikave qeveritare. Ka hapësirë për përmirësimin dhe fuqizimin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura, autoriteteve dhe agjencive rregullatore, dhe vendosjen e mekanizmave të përshtatshëm të raportimit dhe llogaridhënies.

Krizat e vazhdueshme politike gjatë viteve të fundit kanë penguar seriozisht punën e Kuvendit. Kuvendi i ri nuk ka qenë në gjendje që të takohet për disa muaj pas zgjedhjeve të përgjithshme, të mbajtura në tetor 2015, ku nuk ka pasur fitues bindës. Puna e Kuvendit është penguar vazhdimisht dhe fizikisht nga protestat e opozitës nacionaliste kundër marrëveshjeve të fundit të nënshkruara në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe kundër marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Kosova është duke vazhduar procesin e decentralizimit dhe fuqizimit të administratës lokale. Gjatë viteve të fundit, numri i komunave është rritur nga 30 në 37, kryesisht për të plotësuar nevojat specifike të minoriteteve etnike në nivel lokal. Sfidat kryesore vazhdojnë të jenë

⁵ Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar për Kosovë 2014, 7 korrik 2014, f.1.

mungesa e ekspertizës profesionale në nivel lokal, kufizimet buxhetore dhe absorbimi i përgjithshëm i kapaciteteve. Decentralizimi vazhdon të jetë sfidë në veriun e Kosovës për shkaqe politike.

Pushteti efektiv për të qeverisur i zyrtarëve të zgjedhur

Kosova ka krijuar mekanizmat institucional, ligjor dhe financiar që nevojiten për ushtrimin efektiv të pushtetit nga ana e zyrtarëve të zgjedhur dhe ata nuk janë të penguar nga ushtrimi i këtij pushteti nga ndonjë veto jo demokratike apo ndikime të padrejta.

Kosova dallon nga shtetet e rajonit për shkak të pranisë së konsiderueshme ndërkombëtare, megjithëse roli i kësaj pranie aktualisht është i kufizuar. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, autoritetet ftuan praninë civile ndërkombëtare siç ishte paraparë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisarit). Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) krijoi Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN) e cila drejtohej nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) që ishte përgjegjës për të siguruar zbatimin e Planit të Ahtisarit. Me 10 shtator 2012, GDN, duke u bazuar në vlerësimin e progresit të arritur nga Kosova, unanimisht shpalli përfundimin e “pavarësisë së mbikëqyrur” të Kosovës dhe i dha fund mandatit të PCN.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB 1244 (RKSKB 1244), e cila në vitin 1999 kishte themeluar Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK) vazhdon të jetë formalisht në fuqi dhe shërben si bazë për praninë neutrale ndaj statusit të KB dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). EULEX është misioni më i madh i organizuar ndonjëherë sipas Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Synimi i këtij misioni është mbështetje e autoriteteve të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, posaçërisht policinë, gjyqësorin dhe doganat. EULEX ushtron funksion të mentorimit, këshillit dhe ruan një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive. Mandati aktual i EULEX skadon në qershor 2018.

Në Kosovë gjithashtu ekziston edhe prania ushtarake e NATO's - Kosovo Force (KFOR) – e cila në pajtim me RKSKB ka mbështetur ruajtjen e paqes në Kosovë që nga qershori 1999. Sot, një numër i reduktuar i trupave të KFOR-it (5,000 trupa) kontribuojnë për ruajtjen e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes së të gjithë qytetarëve.

Shoqëria Civile, Media dhe Pjesëmarrja

Madhësia dhe pavarësia e shoqërisë civile

Kosova ka një kornizë të kënaqshme ligjore për organizatat e shoqërisë civile. Ligji i vitit 2009 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare u jep qytetarëve të drejtën për themelimin, bashkimin dhe angazhimin me organizata joqeveritare (OJQ), dhe ofron një kornizë efektive për mbrojtjen e të drejtave të OJQ-ve. Strategjia për Bashkëpunimin mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile për periudhën 2013-2018 si dhe plani përkatës i veprimit 3 vjeçar janë miratuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës. Në bazë të strategjisë është formuar edhe Këshilli për Implementimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Sikurse edhe në shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, OSHC vazhdojnë të jenë shumë të varura nga fondet e jashtme dhe fondet janë pengesa më e madhe për funksionimin e tyre.

Në Kosovë aktualisht ka rreth 8,000 OJQ të regjistruara, mirëpo vetëm 200 prej tyre janë funksionale. Shumica e OJQ-ve janë të bazuara në projekte dhe kanë specializim relativisht të

ngushtë. Megjithatë, për dallim nga shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, OJQ-të në Kosovë janë të shpërndara në mënyrë të barabartë, madje edhe në zonat rurale.

E drejta për formimin e sindikatave është e garantuar me ligj dhe respektohet në praktikë.

Pavarësia dhe pluralizmi i mediave që veprojnë pa censurë

Pluralizmi medial dhe numri i mediave që veprojnë gjerësisht të lira dhe pa censurë dhe qasja në informata publike është rritur në përgjithësi në vitet e fundit. Korniza ligjore kryesisht është kompletuar dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare. Këshilli i Mediave të Shtypit të Kosovës, që është organ vetë-rregullator për mediat e shtypit ndihmon në promovimin e lirisë së fjalës, të drejtave të qytetarëve për informim dhe respektimin e Kodit të Shtypit në Kosovë. Aktualisht ekzistojnë dy Kode të Etikës që e rregullojnë profesionin e gazetarisë: Kodi i Etikës i Këshillit të Mediave të Shtypit të Kosovës, dhe Kodi i Etikës i Komisionit të Pavarur të Mediave.

Njëkohësisht, duhet të bëhet më shumë për të siguruar që liria e shprehjes dhe mediave e cila garantohet me Kushtetutë të respektohet edhe në praktikë, për shkak se ekziston një perceptim i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës se mediat janë shumë të politizuara dhe nën presion nga partitë politike. Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, Këshilli i Mediave të Shtypit në Kosovë dhe Komisioni i Pavarur i Mediave kanë ngritur zërin kundër ndërhyrjeve politike. Struktura pronësore e mediave, në veçanti për mediat e shtypit, vazhdon të jetë e paqartë. Megjithëse mediat janë të obliguara që të dorëzojnë raportet e pronësisë në baza vjetore, nëse nuk janë të regjistruara si biznese dhe nëse nuk paguajnë tatime ato nuk janë të obliguara që ti raportojnë për strukturën e pronësisë askujt.⁶ Gjithsej 26 raste të sulmeve, kërcënimeve dhe pengimit të gazetarëve janë nën hetim në fillim të vitit 2016.⁷

Në Kosovë ka nëntë gazeta ditore me tirazh prej 25,000-35,000 kopje secila, numër ky që është relativisht i ulët në krahasim me rajonin. Mediat elektronike e dominojnë tregun dhe televizioni është burimi kryesor i informacionit. Transmetuesit kryesor janë tri televizione kombëtare (RTK, KTV, dhe RTV21). Gjatë viteve të fundit ka pasur rritje eksplozive të qasjes në internet (nga 5.4 përqind në vitin 2009 në 84.4 përqind në vitin 2014). Shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë është e krahasueshme me atë të shteteve të Evropës Perëndimore. Mediat sociale janë duke luajtur një rol gjithnjë më të madh, dhe Facebook është rrjeti kryesor social i përdorur nga Kosovarët.⁸

Kanalet e shumëfishta të pjesëmarrjes qytetare dhe politike

Në Kosovë ka kanale të shumëfishta të pjesëmarrjes qytetare dhe politike. Qeveria raporton në baza vjetore për zbatimin e dokumenteve kryesore strategjike. E drejta për qasje në informata publike është e rregulluar me ligj. Kuvendi i Kosovës ka përmirësuar aktivitetet e komunikimit, duke përfshirë përmes dëgjimeve publike. Qeveria ka krijuar një mekanizëm për konsultime me shoqërinë civile për projektligje të reja. Duke filluar nga tetori i vitit 2015, pjesëmarrja civile në punën e Kuvendit (si punë e vetë Kuvendit) është penguar nga bllokada politike opozitare.

Liria për formimin e partive politike dhe ekzistenca e opozitës së organizuar

⁶ Liria e Mediave në Ballkanin Perëndimor, Parlamenti Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Jashtme të Unionit, tetor 2014, f. 33.

⁷ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, 10 nëntor 2015, f. 22.

⁸ Statistikat botërore të internetit: <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm#europe>; shih gjithashtu: STIKK, Penetrimi dhe Përdorimi i Internetit në Kosovë, gusht 2013.

Liria për formimin e partive politike është e garantuar me Kushtetutë dhe zbatohet në praktikë siç dëshmohet edhe nga opozita e konsiderueshme e cila është në gjendje që të bëjë fushatë lirshëm dhe të kundërshtojë iniciativat e qeverisë. 30 subjekte politike kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit të përgjithshme, dhe më shumë se 10 parti të ndryshme politike janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Koalicioni i partive opozitare aktualisht mban më shumë se 25 ulëse në Kuvend.

Sundimi i Ligjit dhe Qasja në Drejtësi

Sundimi i ligjit

Aktualisht janë në fuqi shumë garanci legislative dhe institucionale për sundimin e ligjit. Gjatë viteve të fundit Kosova ka miratuar legjislacionin e ri për reformën e sistemit gjyqësor dhe korniza kryesore ligjore dhe institucionale për sundimin e ligjit ekziston. Qytetarët kanë të drejtë në gjykim të lirë dhe të pavarur dhe janë të mbrojtur nga arrestimi ose mbajtja arbitrare.

Strategjia për modernizimin e administratës publike 2015-2020 dhe plani i veprimit, të miratuara në shtator 2015, duhet të mundësojnë tejkalimin e politizimit të administratës publike dhe fuqizimin e përgjithshëm të sundimit të ligjit.

Kosova mbështetet në mënyrë aktive nga EULEX, që ka më shumë se 1,500 njerëz në terren dhe mandati aktual i të cilit skadon në qershor 2018. Autoritetet e Kosovës janë përkushtuar që të bashkëpunojnë plotësisht me EULEX-in, duke përfshirë Task Forcën për Hetime Speciale e cila heton pretendimet që janë bërë në Rezolutën 1782 të APKE në janar 2011, dhe Gjykata Speciale e cila pritet të themelohet në pjesën e dytë të vitit 2016.

Pavarësia e gjyqësorit

Pavarësia e gjyqësorit është e garantuar me Kushtetutë dhe ka mekanizma për sigurimin e paanshmërisë. Megjithatë zbatimi i këtyre mekanizmave është i pabarabartë. Autoritetet Kosovare janë të vetëdijshme për nevojën e adresimit të kësaj çështje, siç është përcaktuar në planet strategjike për gjyqësorin për vitet 2014-2019, strategjinë e komunikimit 2014-2019 dhe strategjinë kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra.⁹

Fuqizimi i pavarësisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor ka qenë njëri nga objektivat kryesor të reformave gjithëpërfshirëse sipas BE e cila ofron mbështetje të konsiderueshme për Kosovën në këtë fushë. Si BE ashtu edhe APKE kanë vlerësuar se në këtë fushë është bërë progres i konsiderueshëm. Korniza e re gjithëpërfshirëse ligjore është miratuar, duke përfshirë ligjin për gjykatat, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për Prokuroritë. Sistemi i ri gjyqësor është bërë funksional me 1 janar 2013. Pavarësia e gjyqësor mbështetjet edhe funksionimi i Gjykatës Supreme të Pavarur, Gjykata Kushtetuese, Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor që ka mandat për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit.

Njëkohësisht, raportet relevante të BE kanë identifikuar disa sfida serioze sa i përket pavarësisë së gjyqësorit. Procedura e zgjedhjes së Këshillit Gjyqësor duhet të ndryshohet për të qenë në pajtim me standardet relevante Evropiane dhe për të siguruar që shumica e

⁹ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, 10 Nëntor 2015, f.13.

anëtarëve të KGJK të zgjidhen nga vetë gjyqtarët. Ky ka qenë rekomandim edhe i Komisionit të Venecias.¹⁰ Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias (i arritur në qershor 2014) do të duhej të lehtësonte përmirësimet e mëtutjeshme. Sipas ekspertëve të BE, ende ka mungesë të kapaciteteve në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial për hartimin e rregulloreve të nevojshme për implementimin e vendimeve të tyre. Aktualisht nuk ka një sistem zyrtar për monitorimin e performancës së gjykatave dhe e-drejhtësia vazhdon të mos jetë e zhvilluar.

Barazia e qeverisë dhe qytetarëve para ligjit

Autoritetet kanë marrë masa për parandalimin e shpërdorimit të pushtetit nga zyrtarët publik. E drejta e qasjes në informata publike është e garantuar me ligj, dhe numri i kërkesave pa përgjigje ose të refuzuara është relativisht i ulët. Ligjet për deklarimin e pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesit janë miratuar nga Kuvendi. Reformat që janë bërë kohëve të fundit në administratën publike kanë krijuar kushtet për krijimin gradual të një shërbimi civil stabil dhe profesional, që është një element i rëndësishëm për parandalimin e shpërdorimit të pushtetit dhe të sigurojnë që qeveria dhe qytetarët të jenë të barabartë para ligjit. Reformat e përfshira në ligjin për shërbimin civil të miratuar, krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit, miratimi i ligjit të ri për Avokatin e Popullit (maj 2015) dhe zgjedhja e Avokatit të ri të Popullit (korrik 2015).

Politika dhe institucione efektive për parandalimin e korrupsionit

Në Indeksin e Transparency International për Perceptimin e Korrupsionit të (IPK) për vitin 2015, rangimi i Kosovës ka mbetur i pandryshuar gjatë tri viteve të fundit. Aktualisht Kosova është e ranguar në vendin 103 nga gjithsej 168 vende, rangimi më i keq në Evropën Juglindore. Pavarësisht progresit në disa fusha, ende ka dobësi që mbeten për tu adresuar. Raporti i fundit i Progresit për Kosovën nga KE e ka kualifikuar korrupsionin në Kosovë si “endemic”.¹¹ Këshilli i BE në konkludimet e datës 15 dhjetor 2015 në veçanti ka theksuar nevojën për “ndjekjen penale të rasteve të profilin të lartë”.¹² Deri më tani nuk ka pasur dënime në ato pak hetime të rasteve të korrupsionit të profilin të lartë.

Një vlerësim i plotësimin nga Kosova të standardeve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit është kryer nga Këshilli i Evropës përmes Projektit Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKKEK). Vlerësimi është bazuar në metodologjitë dhe kriteret e përdorura nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) dhe organet tjera relevante ndërkombëtare. Në raportin përfundimtar, PKKEK ka konkluduar se nga 62 rekomandimet e dhëna, 5 janë implementuar në mënyrë të kënaqshme; 25 janë implementuar pjesërisht dhe 32 nuk janë implementuar. Megjithatë, është theksuar se autoritetet Kosovare kanë bërë përpjekje për adresimin e mungesave të identifikuara në menaxhimin e policisë, administratës publike, financimit të partive politike, fushën e prokurimit dhe fushën penale.¹³

Autoritetet kanë bërë hapa të rëndësishëm gjatë viteve të fundit në luftën kundër korrupsionit përmes miratimit të akteve ligjore, duke përfshirë ligjin për deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit, zbulimit të rasteve, prokurimit publik dhe financimit të partive politike. Aktualisht janë katër institucione kryesore të përfshira në luftën kundër

¹⁰ Komisioni i Venecias, Raporti për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve, 16 mars 2010, f.8

¹¹ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, 10 nëntor 2015, f.5.

¹² Konkludimet e Këshillit, Procesi i Zgjerimit dhe Stabilizim Asociimit, Këshilli i Bashkimit Evropian, 15 dhjetor 2015, f.19.

¹³ Këshilli i Evropës, Projekti Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKKEK), Raporti Përfundimtar, 2015.

korupsionit në Kosovë; Agjencia Kundër Korupsionit, si agjenci e pavarur dhe e specializuar e themeluar në vitin 2006; Këshilli Kombëtar Kundër Korupsionit, si organ konsultativ i kryesuar nga Presidenti i Kosovës; Koordinatori Kombëtar Kundër Korupsionit, që emërohet nga Kryeprokurori i Shtetit; dhe Drejtori për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korupsionit në kuadër të Policisë së Kosovës. Sigurisht që ka dyfishime në mandatin e këtyre katër organeve dhe mungesë të koordinimit.

Në fund të vitit 2014, Agjencia Kundër Korupsionit ka lancuar fushatën kundër korupsionit, duke i inkurajuar qytetarët që të raportojnë sjelljet korruptive para organeve të rendit dhe ligjit. Përderisa shoqëria civile është e përfshirë në zhvillimin e politikave kundër korupsionit, ekziston nevoja që të përmirësohet konsultimi përmes komunikimit të rregullt, transparent dhe konstruktiv.

Të Drejtat Civile dhe Politike

Liria e shprehjes, informimit, besimit fetar, ndërgjegjjes, lirisë, asociimit, mbledhjes dhe pronës private

Kosova ka një bazë solide ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që janë garantuar me Kushtetutën e miratuar në vitin 2008. Kushtetuta radhit instrumentet kryesore ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore dhe Protokollet e saj, që janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj ligjeve shtetërore. Ky është një mekanizëm i rëndësishëm, posaçërisht kur marrin parasysh faktin se Kosova nuk është anëtare e KB ose e këshillit të Evropës me instrumentet e tyre monitoruese dhe nuk është palë nënshkruese e ndonjë instrumenti ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ligji i ri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i miratuar në Maj 2015, është një hap i rëndësishëm përpara.

Kushtetuta u jep qytetarëve të drejtën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutë para Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjithashtu mund të bëhet nga Avokati i Popullit. Gjatë viteve të fundit janë krijuar struktura shtesë në nivel qendror dhe lokal për të forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore. Komuniteti ndërkombëtar vazhdon të jetë i përfshirë në ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë.

Pasi që Kosova nuk është anëtare e KB, nuk i nënshtrohet vlerësimit në kornizën e Shqyrtimeve Periodike Universale (proces përmes të cilit shqyrtohet periodikisht respektimi i të drejtave të njeriut në Shtetet Anëtare të KB). Grupi punues Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, i themeluar nga UNMIK në shtator 2015, ka ndihmuar në implementimin e mekanizmave për të drejtat e njeriut kornizave nga institucionet relevante Kosovare, duke përfshirë shqyrtimin e draft Strategjisë së Kosovës për të Drejtat e Njeriut (2016-2020).¹⁴

Përderisa të drejtat themelore në përgjithësi mbrohen dhe respektohen nga institucionet shtetërore, raportet e fundit të BE kanë identifikuar disa dobësi në fushën e lirisë së shprehjes (mbrojtja dhe ndjekja penale dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve) dhe të drejtat pronësore (si në zbatimin e kornizës ligjore ashtu edhe në reduktimin e numrit të rasteve të vjetra). Mangësitë në zbatimin konsistent të të drejtave të garantuara gjithashtu përfshijnë zbardhjen e fatit të

¹⁴ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 1 shkurt 2016, f. 7.

personave të zhdukur pas konfliktit të viteve 1990 (sipas KB, më shumë se 1,600 raste deri në fund të vitit 2015), dhe integrimi i personave me aftësi të kufizuara.

Përfshirja politike e femrave, minoriteteve etnike dhe të tjera

Për shkak të historisë së konfliktit ndëretnik, si dhe vazhdimit të kundërthënies në komunitetin ndërkombëtar sa i përket statusit të Kosovës, çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e minoriteteve etnike në Kosovë janë shumë të ndjeshme.

Në Kushtetutën e Kosovës janë përmendur shprehimisht gjashtë komunitete etnike. Sipas regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2011, shqiptarët etnik përbëjnë 93 përqind të popullsisë; serbët etnik 1.5 përqind; turqit etnikë 1 përqind; romë, ashkali dhe egjiptas (RAE) 2 përqind; goranët 0.6 përqind; boshnjakët 1.5 përqind. Megjithatë duhet të theksohet se serbët e kanë bojkotuar plotësisht pjesëmarrjen në regjistrimin e popullsisë në veriun e Kosovës dhe pjesëmarrja e tyre në regjistrim në vendet tjera ka qenë e pabarabartë. Vlerësimet jo-zyrtare nga të dhënat e përdorura për qëllime praktike nga prania ndërkombëtare në Kosovë janë se popullsia totale serbe në Kosovë është 5-7 përqind. Gjatë zgjedhjeve të fundit të përgjithshme në Serbi, që janë zhvilluar në prill 2016, administrata zgjedhore e Serbisë ka përdorur numrin prej 106,000 banorëve Serb të Kosovës të regjistruar për të votuar në këto zgjedhje, mirëpo jo të gjithë domosdoshmërisht janë serb etnikë.

Korniza legjislative për mbrojtjen e minoriteteve etnike është funksionale në Kosovë. Të drejtat e tyre garantojnë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare është drejtpërdrejtë e aplikueshme në Kosovë dhe ka përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës. Interesat e minoriteteve etnike mbrohen edhe nga një mekanizëm kompleks në nivel qendror.

Në krahasim me shtetet e rajonit, minoritetet etnike janë shumë mirë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe në qeveri. Në Kuvendin e Kosovës janë të rezervuara 20 vende për minoritetet etnike nga gjithsej 120 vende, 10 prej të cilave janë të rezervuara për serbët etnik. 20 ulëset e “garantuara” janë të parapara në Kushtetutë. Zgjedhjen e vitit 2014 kanë qenë të parat në të cilat sistemi i ulëseve të “garantuara” është zëvendësuar me sistemin e ulëseve të “rezervuara”, që praktikisht në të kaluarën u ka mundësuar minoriteteve që të kenë të 25 deputetë dhe jo 20 në Kuvend. Dy nga pesë Zëvendës-Kryetarët e Kuvendit përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Koalicioni aktual qeverisës përfshin shumicën e partive politike që përfaqësojnë minoritetet etnike, duke përfshirë serbët etnikë, që kanë dy pozita ministrore dhe një pozitë të Zëvendës-Kryeministrit. Gjuha Serbe është njëra nga dy gjuhët zyrtare në Kosovë, së bashku me gjuhën shqipe.

Janë bërë përpjekje për përmirësimin e situatës në nivel lokal, duke përfshirë krijimin e komunave në të cilat serbët etnik përbëjnë shumicën e popullsisë në mënyrë që të lehtësohet qasja në shërbimet themelore. Janë krijuar disa komuna veçanërisht për përmbushjen e interesave të minoriteteve etnike. Deri më sot, nga gjithsej 37 komuna sa ka Kosova, shtatë prej tyre kanë shumicë ose një numër të konsiderueshëm të popullsisë serbe. Njëri nga elementet kyç të marrëveshjes së ndërmjetësuar nga BE mes Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënies parasheh krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe, për të cilin asociacion vazhdon puna (dhe debatet).

Kosova ka ndërmarrë masa për zbatimin e konventave për të drejtat kulturore të UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës si dhe për mbrojtjen fizike të lokacioneve kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe. Njëra nga masat specifike të rekomanduara nga KE ka qenë krijimi i një organi të posaçëm për konsultim të drejtpërdrejtë për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me komunitetet minoritare.

Megjithatë, mungesa e besimit ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe disa komuniteteve minoritare vazhdon. Agjenci të ndryshme raportojnë për incidente kohë pas kohe që kanë për motivacion urrejtjen etnike dhe fetare dhe rastet e diskriminimit, si dhe sulmet fizike kundër minoriteteve etnike. Megjithatë sipas Raportit të fundit APKE, zhvillimet në veriu të Kosovës dëshmojnë se tensionet mund të ulen pas progresit në normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës.¹⁵

Autoritetet duhet të bëjnë më shumë për të siguruar integrimin e plotë të minoriteteve etnike. Raporti i OSBE-së për Vlerësimin e të Drejtave të Komuniteteve, i publikuar në nëntor 2015, ka konkluduar se pavarësisht nga zhvillimet pozitive në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, shumë sfida vazhdojnë të mbesin që kërkojnë punë të vazhdueshme nga institucionet Kosovare¹⁶. Duhet të bëhet më shumë për mbrojtjen e minoriteteve etnike më të vogla, posaçërisht komunitetit të cenuar RAE. Janë ndërmarrë disa masa, posaçërisht për adresimin e çështjes së personave pa dokumente dhe për integrimin e PZHB dhe refugjatëve romë nga Kosova. 12 komuna kanë miratuar planet lokale të veprimit për integrimin e komunitetit RAE. Programi i ndërmjetësimit për shëndetin e romëve ka filluar në 16 komuna. Projektet e edukimit janë vazhduar të implementohen për rritjen e shkallës së regjistrimit të fëmijëve romë në shkollimin e mesëm. Megjithatë, implementimi i strategjive ekzistuese duhet të fuqizohet. Shkalla e lartë e papunësisë vazhdon, ndërsa qasja në asistencën e papunësisë vazhdon të jetë problematike. Stereotipet për RAE vazhdojnë, duke përfshirë në media.

Elementet kryesore legislative për barazinë gjinore, duke përfshirë dispozitat kushteve dhe ligji i posaçëm për barazinë gjinore (i aprovuar në vitin 2015) janë në fuqi në Kosovë. Në krahasim me shtetet e rajonit, femrat kanë përfaqësim relativisht të madh në Kuvend, duke tejkaluar 30 përqind. Ky është rezultat i “diskriminimit të dyfishtë pozitiv” (garantimi i 30 përqind të kandidatëve dhe garantimi i 30 përqind të ulëseve në Kuvend), që në njërin anë ndërhyr në zgjedhjen e lirë të qytetarëve, mirëpo është pranuar si masë e nevojshme e përkohshme. Presidentja e mëparshme e Kosovës, mandati i të cilës ka skaduar në fillim të vitit 2016, ishte femër, dhe aktualisht janë dy femra anëtare të kabinetit qeveritar. Megjithatë, në nivelin lokal, femrat vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në nivelin e vendimmarrjes. Gjithashtu ka shumë pak femra nga minoritetet etnike që mbajnë pozita të larta politike. Zakonet diskriminuese dhe stereotipet janë ende të pranishme në zonat rurale, duke i cenuar kështu të drejtat themelore të femrave. Një numër shumë i madh prej 14 përqind të femrave në zonat rurale janë analfabete, sipas të dhënave të KB, të krahasim me katër përqind të meshkujve.

Liria nga keqtrajtimi, frikësimi dhe tortura

¹⁵ Asambleja Parlamentare, Këshilli i Evropës, Situata në Kosovë dhe Roli i Këshillit të Evropës, 8 Janar 2016, f. 14.

¹⁶ Raporti për Vlerësimin e të Drejtave të Komuniteteve, Edicioni i Katërt, OSBE, Nëntor 2015, f.35.

Kushtetuta përmban garanci kundër keqtrajtimit, frikësimit dhe torturës dhe këto kryesisht respektohen në praktikë. Përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Avokatin e Popullit në vitin 2015, Kosova është harmonizuar me kërkesat e Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës. Një delegacion i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Jo Njerëzor ose Degradues ose Dënimit e ka vizituar Kosovën në vitin 2015. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit dhe kushteve të mbajtjes së personave nga policia dhe gjendjes në institucionet korrektuese (duke përfshirë regjimin për të miturit, të burgosurit të burgjet e sigurisë së lartë dhe gjendjen e tyre shëndetësore).¹⁷ Task Forca Speciale Hetuese e BE ka hetuar pretendimet e krimeve të kryera në periudhën 1998-2000 që janë paraqitur në Rezolutën e APKE të Janarit 2011 për pretendimet e trajtimit jo human të njerëzve dhe trafikimin e organeve. Kjo punë do të vazhdohet nga Gjykata Speciale, që pritet të themelohet në pjesën e dytë të vitit 2016.

¹⁷ Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Degradimit Jo Human dhe Dënimit: <http://www.cpt.coe.int/documents/kosovo/2015-04-28-eng.htm>

ANEKSI 2 – INDIKATORËT E PËRZGJEDHUR EKONOMIK

*Kosova përdor Euron si valutë zyrtare

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhimi dhe shpenzimet <i>(Ndryshimi i përqindjes në terma real)</i>							
BPV	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2	3.0
Konsumi privat	2.3	3.5	3.5	2.9	2.0	4.9	n/a
Konsumi publik	-5.4	-2.9	0.1	2.2	3.3	-2.5	n/a
Formimi i kapitalit bruto fiks	13.5	11.0	8.1	-13.6	-0.2	-3.3	n/a
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	12.3	12.5	3.3	0.5	2.5	17.1	n/a
Importi i mallrave dhe shërbimeve	5.4	9.1	3.5	-7.7	-1.5	8.4	n/a
Tregu i punës <i>(Ndryshimi i përqindjes)</i>							
Të ardhurat mesatare bruto në ekonomi (mesatarja vjetore) <i>(Sektori i buxhit, siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës)</i>	20.4	16.0	20.1	3.1	0.7	16.8	7.4
Rritja reale e pagave LCU	22.8	12.5	12.8	0.6	-1.1	16.4	7.9
<i>(Në përqindje të fuqisë punëtore)</i>							
Shkalla e papunësisë	45.4	n/a	n/a	30.9	30.0	35.3	n/a
Çmimet <i>(Ndryshimi i përqindjes)</i>							
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	-2.4	3.5	7.3	2.5	1.8	0.4	-0.5
Çmimet e konsumit (fundi i vitit)	0.1	6.6	3.6	3.7	0.5	-0.4	0.2
Indikatorët Fiskal <i>(në përqindje të BPV)</i>							
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	0.1	-1.8	-1.1	-1.2	-2.5	-2.9	n/a
Të ardhurat e përgjithshme qeveritare	28.1	25.9	27.2	27.3	25.5	24.2	n/a
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare	28.0	27.7	28.3	28.6	28.0	27.2	n/a
Borxhi i përgjithshëm qeveritar	6.4	6.2	5.5	8.4	9.1	10.6	13.0
Sektorët monetar dhe financiar <i>(Ndryshimi i përqindjes)</i>							
Paratë në kuptimin e gjerë (M2, fundi i vitit) *	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Kreditë për sektorin privat (fundi i vitit)	8.8	12.3	13.5	4.5	2.6	6.3	7.3
<i>(Në përqindje të kredive totale)</i>							
Proporcioni i kredive jo performuese <i>(nuk përfshin kreditë nën-standard)</i>	4.3	5.9	5.8	7.5	8.7	8.3	7.2
Interesi dhe normat e këmbimit <i>(Në përqindje për vit)</i>							
Norma e politikave *	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Norma e depozitave	4.0	3.4	3.6	3.7	2.4	1.1	1.2
Norma e kredive	14.1	14.0	13.3	12.2	10.9	9.3	7.7
<i>(Euro në Dollar Amerikan)</i>							
Norma e këmbimit (fundi i vitit) *	0.69	0.75	0.77	0.76	0.73	0.82	0.92
Norma e këmbimit (mesatarja vjetore) *	0.72	0.76	0.72	0.78	0.75	0.75	0.90
Sektori i jashtëm <i>(Në përqindje të BPV)</i>							
Llogaritë aktuale	-9.2	-11.7	-13.7	-7.5	-6.4	-7.8	-9.2
Balanci i mallrave dhe shërbimeve	-34.9	-35.6	-37.2	-34.1	-31.6	-30.9	-30.8
Balanci tregtar i mallrave	-40.5	-39.6	-42.5	-40.5	-37.5	-37.0	-37.0
Eksportet e mallrave	4.2	6.8	6.6	5.6	5.5	5.8	5.7
Importet e mallrave	44.7	46.4	49.1	46.1	42.9	42.8	42.6
Balanci tregtar i shërbimeve	5.6	4.0	5.3	6.4	5.9	6.0	6.2
Investimet e huaja direkte, net	6.8	7.5	7.9	4.2	4.7	2.2	5.0
Rezervat ndërkombëtare, bruto *	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Stoku i borxhit të jashtëm	n/a	n/a	29.7	30.0	30.2	31.2	33.8
Borxhi i jashtëm publik	n/a	n/a	6.6	7.9	7.2	7.1	7.7
Borxhi i jashtëm privat	n/a	n/a	23.0	22.1	23.0	24.1	26.1
<i>(Në muaj të importit të mallrave dhe shërbimeve)</i>							
Rezervat ndërkombëtare bruto *	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Pikat e Memorandumit <i>(Denominimet e përcaktuara)</i>							
Popullsia (fundi i vitit, miliona)	2.18	2.21	1.80	1.82	1.82	1.80	1.80
BPV (në miliarda Euro)	4.1	4.4	4.8	5.1	5.3	5.6	5.7
BPV për kokë banori (në Euro)	1,866	1,995	2,677	2,786	2,926	3,085	3,170
Pjesëmarrja e industrisë në VSHB (në përqindje)	19.3	20.7	19.7	19.9	20.3	19.3	n/a
Pjesëmarrja e bujqësisë në VSHB (në përqindje)	15.4	16.2	15.6	14.8	14.4	13.6	n/a
IHD, net (në miliona Euro)	277	331	379	213	250	124	287
Borxhi i jashtëm (në miliona Euro)	n/a	n/a	1,428	1,517	1,608	1,737	1,932

ANEKSI 3 – VLERËSIMI I SFIDAVE TË TRANZICIONIT

Struktura e tregut	Institucionet e tregut	Sfidat kryesore
KORPORATAT		
Agrobiznesi		
Mesme	Madhe	- përmirësimi i strukturës së të drejtave pronësore me qëllim të konsolidimit dhe kolateralizimit; - përmirësimi i mjedisit afarist për tërheqjen e IHD në këtë sektor.
Prodhimtaria dhe Shërbimet		
Mesme	Madhe	- përsheptimi i procesit të privatizimit; - përmirësimi i mjedisit afarist përmes përmirësimit të zbatimit të kontratave dhe reduktimit të burokracisë; - përmirësimi i qeverisjes korporative dhe praktikave biznesore.
Tregu i paluajtshmërive		
Madhe	Madhe	- sigurimi i zbatimit efektiv të të drejtave pronësore dhe qasjes në tokë dhe informata pronësore; - rritja e furnizimit me prona moderne komerciale në të gjitha nën-segmentet; - paraqitja e teknikave moderne dhe teknologjisë së ndërtimtarisë, duke përfshirë eficiencën dhe qëndrueshmërinë e energjisë.
TIK		
Mesme	Mesme	- zhvillimi i infrastrukturës moderne të telekomunikacionit (interneti broadband); - privatizimi i operatorit të linjave fikse PTK; - përmirësimi i mëtutjeshëm i implementimit dhe zbatimit të një kornize moderne rregullatore (duke përfshirë masat për mbrojtjen e konkurrencës, siç është bartja e numrit, shlyerja lokale e qarkut dhe qasja me volum të madh në broadband internet).
ENERGJIA		
Burimet Natyrore		
Mesme	Madhe	- përfundimi i ristrukturimit dhe zgjidhja e çështjeve pronësore juridike lidhur me kompleksin minerar Trepça; - mbështetja e zhvillimit të tregut rajonal dhe vendor të gazit dhe fuqizimi i pavarësisë së rregullatorit të energjisë; - eliminimi i tarifave doganore në produktet e naftës; - përmirësimi i kornizës ligjore në industrinë minerare.
Energjia Elektrike		
Madhe	Madhe	- modernizimi i rrjetit të transmisionit dhe distribuimit; - reduktimi i humbjeve në rrjetin e distribuimit; - implementimi i tarifave reflektuese të kostos; - reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit.

INFRASTRUKTURA		
Uji dhe Ujërat e Zeza		
Madhe	Mesme	- decentralizimi i pronësisë së shërbimeve publike; - përmirësime të konsiderueshme për reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale; - përmirësimi i shkallës së mbledhjeve; - përmirësimi i tarifave për arritjen e nivelit në të cilin tarifat e rimbursojnë koston; - krijimi i marrëdhënieve të orientuara në shërbime mes komunave dhe operatorëve; - strukturimi i PPP-ve në sektorin e ujit.
Transporti Urban		
Mesme	Madhe	- zhvillimi i një politike të transportit për qytetet (d.m.th strategjia e transportit të integruar urban); - rritja e autonomisë së ndërmarrjeve në pronësi publike dhe krijimi i marrëdhënieve kontraktuese me komunat; - përmirësimi i qëndrueshëm i cilësisë së shërbimeve dhe performancës operacionale dhe financiare.
Rrugët		
Mesme	Madhe	- krijimi i një marrëdhënie të pavarësisë mes qeverisë dhe agjencisë rrugore; - rritja e vazhdueshme e buxhetit për mirëmbajtjen e rrugëve dhe alokimi i parashikueshëm afatgjatë i financimit për mirëmbajtjen e rrugëve; - pjesëmarrja më e madhe e sektorit privat, përfshirë këtu edhe PPP-të atëherë kur duket e përshtatshme; - reforma institucionale dhe përmirësimi i praktikave të prokurimit në ndërtimin e rrugëve dhe kontratat e mirëmbajtjes – futja në përdorim e kontratave të bazuara në performancë.
Hekurudhat		
Mesme	Madhe	- ristrukturimi i thellë i veprimtarive aktuale për të siguruar që rrjeti dhe operacionet të jenë të qëndrueshme në afatgjatë dhe konkurruese me metodat e tjera të transportit; - inkurajimi i qasjes së hapur; - krijimi i shërbimeve biznesore për pasagjer dhe implementimi i plotë i kontakteve me OSHP; - fuqizimi i kapaciteteve dhe pavarësisë së rregullatorit

INSTITUCIONET FINANCIARE		
Sektori bankar		
Mesme	Mesme	• rritja e proporcionit mes depozitave/BPV; • rritja e cilësisë së kornizës ligjore dhe rregullatore.
Sigurimet dhe shërbimet tjera financiare		
Madhe	Madhe	• rritja e penetrimit të sigurimeve; • përmirësimi i legjislacionit të sigurimeve, me qëllim të harmonizimit me standardet e SHNMS.
Kapitali privat		
Madhe	Madhe	• përmirësimi i mjedisit afarist për ta bërë më tërheqës për investimet e brendshme të kapitalit me fonde rajonale; • zhvillimi i një baze institucionale vendore për investime.
Tregjet e kapitalit		
Madhe	Madhe	• kompletimi i themelimit të infrastrukturës bazike financiare; • zhvillimi i mëturjeshtëm i tregut të bondeve qeveritare; • eksplorimi i partneriteteve rajonale me bursat në Ballkan.
Zhvillimi i NVM-ve		
Madhe		• rritja e kreditimit bankar për NVM që nuk janë të shërbyera në masë të mjaftueshme pavarësisht nga bankat e kapitalizuara mirë dhe likuide; • fuqizimi i të drejtave të kreditorëve, në veçanti sa i përket procedurave të pasigurta përmbartimore në rast të mos pagesës; • zhvillimi i opsioneve jo-bankare financiare siç është lizingu dhe faktoringu (për të cilat ka nevojë për bazë më të qartë ligjore); • përmirësimi i edukimit financiar dhe edukimit në fushën e kontabilitetit, që është ndër më të ulëtat në rajon; • mbështetja e formalizimit të sektorit të madh informal me qëllim të krijimit të një baze më të mirë për veprimtarinë e bizneseve.
INICIATIVA PËR BURIME TË QËNDRUESHME		
Efikasiteti i Ujit		
Madhe	Madhe	• zbatimi dhe rritja e mëturjeshtëm e tarifave për abstragim; • zhvillimi i tarifave sipas volumit; • miratimi i akteve nënligjore përkatëse dhe fuqizimi i bazës institucionale (p.sh të autoriteteve për shtretërit e lumenjve); • adresimi i humbjeve të ujit dhe infrastrukturës së vjetruar për trajtimin e ujërave të zeza.
Efikasiteti i materialeve		
Madhe	Mesme	• priorizimi i menaxhimit të mbeturinave në aspektin e kapaciteteve dhe të financimit, duke përfshirë miratimin e akteve nënligjore dhe të planeve të veprimit; • rritja e tarifave të deponive dhe mbyllja e deponive ilegale; • Zhvillimi i Përgjegjësisë së Prodhuesit dhe skemave të riciklimit;
Energjia e qëndrueshme		
Madhe	Madhe	• eliminimi i barrierave administrative dhe përmirësimi i kornizës rregullatore për tërheqjen e investimeve në energjinë e ripërtëritshme; • zhvillimi dhe implementimi i një plani të qartë të veprimit për arritjen e caceve të efijencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme; • Zhvillimi i një kornize strategjike për ndryshimet klimatike.

PËRFSHIRJA EKONOMIKE^[1] VLERËSIMI I ZBRAZËTIRAVE

PËRFSHIRJA EKONOMIKE		
Dimensioni i zbrazëtirave të përfshirjes	Zbrazëtitat e përfshirjes	Sfidat kryesore
Të rinjtë		
Papunësia e të rinjve	E madhe	Krijimi i trajnimeve dhe mundësive për mësim në punë për të rinjtë (p.sh praktika) përmes përmirësimit të bashkëpunimit mes punëdhënësve nga sektori privat dhe institucioneve arsimore për të siguruar rrugën adekuat për gjetje të punës formale për të rinjtë.
Mospërputhja e aftësive	E mesme	Iniciativat mbështetëse për rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në përcaktimin e standardeve kombëtare të aftësive që pasqyrojnë nevojat reale të tregu të punës, posaçërisht në nivelin e arsimit profesional.
Dimensioni gjinor		
Qasja në financa	E madhe	Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve të bankave lokale për zhvillimin e linjave të kreditit që targetojnë NVM-të e udhëhequra nga femrat, duke kombinuar qasjen në financa, trajnime dhe shërbimet e këshillimit për biznese.

¹ Zbrazëtitat në Përfshirje Ekonomike të BERZH i vlerësojnë institucionet, tregjet dhe sistemet edukuese në të gjitha shtetet e operimit të BERZH sa i përket kapacitetit për ofrimin e mundësive ekonomike për të gjithë individët, pavarësisht nga gjinia, mosha ose vendi i lindjes. Këto zbrazëtira masin *diferencat* në mundësi – ndërmjet 15 deri 24 vjeçarëve dhe punëkërkesve më të vjetër, si dhe ndërmjet femrave dhe meshkujve – dhe jo *nivelet* e mundësive. Zbrazëtitat janë raportuar në këtë Strategji aty ku ekziston një zbrazëti përtej të voglës. Këto zbrazëtira janë në përputhje me azhurnimin e Zbrazëtirave të Përfshirjes të BERZH-it në vitin 2015. Ju lutem të keni parasysh se zbrazëtitat rajonale në përfshirjes janë nga viti 2013 dhe do të azhurnohen në fund të vitit 2016.

ANEKSI 4 – TRANZICIONI LIGJOR

Hyrje

Ky aneks përmban një analizë kritike të temave të zgjedhura ligjore që janë relevante për strategjinë e investimeve të Bankës në Kosovës gjatë periudhës së ardhshme. Aneksi përmban një vlerësim të ligjeve komerciale të kryer nga Programi për Tranzicion Ligjor i BERZH-it.¹⁸ Për të lehtësuar referimin, analiza është bërë në kuadër të orientimeve kryesore strategjike të Bankës të paraqitura në këtë strategji, në veçanti veprimeve të paraqitura në kuadër të ‘Dialogut për Politika dhe BT’.

Tema 1: Mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të kompanive dhe përmirësimit të mjedisit afarist

Qeverisja Korporative

Në vlerësimin e BERZH-it të vitit 2015 për legjislacionin e qeverisjes dhe praktikave korporative në rajonin e BERZH-it janë theksuar nevojat për reforma në shumicën e fushave nën shqyrtim.

Ligji kërkon që kompanitë e mëdha dhe bankat të ketë drejtorë të pavarur, mirëpo në praktikë asnjëra nga dhjetë kompanitë më të mëdha nuk ka deklaruar të ketë drejtorë të pavarur në bordet e tyre. Gjithashtu, përkufizimi i pavarësisë është dhënë në tri ligje dhe rregullore të veçanta, gjë kjo që shkakton konfuzion. Ende nuk është themeluar bursa e aksioneve, që rezulton në informata të kufizuara dhe minimale për kompanitë. Aktualisht ekziston kërkesa për zbulimin e informatave për bankat dhe ndërmarrjet publike për publikimin e pasqyrave financiare dhe raporteve vjetore.

Sa i përket kontrollit të brendshëm, ligji kërkon që Bankat dhe NP-të të kryejnë auditimin e brendshëm si dhe të formojnë komisione të auditimit. Në NP, komisioni i auditimit duhet të përbëhet vetëm nga anëtarët e bordit. Në banka, së paku një anëtar i komisionit të auditimit duhet të jetë ekspert në fushën e kontabilitetit ose auditimit. Praktika e përfshirjes së anëtarëve të jashtëm në komisione të auditimit duhet të shqyrtohet me kujdes. Së pari, është e rëndësishme që komisionet e auditimit të përfshijnë vetëm anëtarë të bordit nëse funksionet të cilat i janë deleguar komisionit janë funksione tipike të bordit. Së dyti, është esenciale që ata anëtarë që shërbejnë në komision dhe që rekomandojnë veprime specifike për bordin, t’i përcjellin këto rekomandime dhe të votojnë për rekomandimet e komisionit në bord, duke e përforcuar pozicionin e tyre dhe të bordit për “gjykim objektiv”. Përfundimisht, komisionet që përfshijnë persona të jashtëm mund të shkaktojnë probleme me konfidencialitetin dhe llogaridhënien, pasi që këta persona të jashtëm nuk i nënshtrohen parimeve të besnikërisë dhe kujdesit të arsyeshëm sikurse anëtarët e bordit. Një qasje e arsyeshme është që struktura do të jetë më efektive nëse bordi përbëhet nga një numër i duhur i anëtarëve jo-ekzekutiv, të cilët gjithashtu do të shërbejnë në komisione. Në vend të kësaj, në Kosovë nuk ekziston ndonjë kërkesë që komisioni i auditimit të përbëhet nga anëtarë të pavarur të bordit me kualifikimet përkatëse.

¹⁸ Shih www.ebrd.com/law

Sa i përket të drejtave të aksionarëve, dispozita e plotë e ligjit lejon që ndryshimet e mëdha korporative të miratohen më shumicë të thjeshtë të votave, që do të thotë se nëse kjo çështje nuk është e rregulluar në aktin e themelimit të korporatës, mund të rrezikojë të drejtat e aksionarëve të vegjël.

Megjithëse nuk ka bursë funksionale në Kosovë – dhe rrjedhimisht nuk ka kornizë të avancuar të qeverisjes korporative – duket se Njësia për Politika dhe Monitorim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik është mjaft aktive në promovimin e qeverisjes së mirë korporative në NP. Ministria ka zhvilluar një kod model të qeverisjes korporative për NP-të dhe ka kërkuar që të gjitha NP-të të miratojnë kodet e tyre sipas kodit model. Vendimet e agjencive rregullatore dokumentohen dhe përgjithësisht janë në dispozicion për publikun, mirëpo shpesh jo lehtë të çasshme. Kompanitë ndërkombëtare të auditimit kanë prezencë të konsiderueshme në Kosovë. Prania e kompanive ndërkombëtare ligjore është e kufizuar.

Qasja në Financim

Sigurimi dhe zbatimi i sigurimit mbi pronën e paluajtshme (hipoteka) dhe pronën e luajtshme dhe të drejtat e paprekshme (pengu) është e rregulluar me Ligjin për Pronën dhe të Drejtat tjera Sendor të vitit 2009 (Ligj për Pronën). Në përgjithësi, Ligji për Pronën ofron një kornizë mjaft të avancuar për sigurim. Si hipoteka ashtu edhe pengu mund të sigurojnë pretendimet aktuale, të ardhshme dhe të kushtëzuara dhe mund të përmbrohen edhe në rast të skadimit të afatit të parashkrimit të kërkesës.

Megjithëse procedurat e regjistrimit janë formalisht të thjeshta dhe regjistrimi i hipoteke nuk merr shumë gjatë (rreth një javë), shpesh ka probleme të konsiderueshme që rezultojnë nga fakti se pjesë të caktuara të tokës nuk janë të regjistruara dhe dokumentacioni për këto pjesë mungon për shkak të së kaluarës së trazuar.

Ligji për Regjistrimin e Pengut në Regjistrimin e Pronave të Luajtshme i vitit 2012 (Ligji për Regjistrin e Pengut) përcakton procedurat dhe kërkesat për regjistrimin e pengut në Sistemin e Regjistrimit të Pengut. Regjistrimi në Regjistrin e Pengut është i vlefshëm për tri (3) vite nga koha e regjistrimit, afat ky që mund të vazhdohet. Një regjistër elektronik operohet nga Agjencia e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve (Agjencia) dhe është në dispozicion online për regjistrimin dhe kërkimin e pengjeve. Kërkimi mund të bëhet online sipas emrit të debitorit ose numrit serik të asetit të vënë peng.

Sa i përket procedurës përmbartimore, në rast të vonësave ose shkeljeve tjera kontraktore nga debitori, kreditori hipotekar mund të fitojë të drejtën për shitjen e pronës që është hipotekuar përmes procedurës gjyqësore sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore të vitit 2013 (Ligji për Procedurën Përmbartimore). Kreditorët mund të iniciojnë procedurën përmbartimore përmes dorëzimit të propozimit për përmbartim para një Përmbartuesi Privat. Megjithatë, duke marrë parasysh që Urdhrat për Përmbartim nga Përmbartuesit Privat mund të nënshtrohen ankesës pranë gjykatës dhe debitori mund të paraqet kundër-përmbartim, procedura e përmbartimit gjyqësor mund të jetë e gjatë. Në anën tjetër Ligji i Pronës i jep të drejtën pengmarrësit për dorëzimin e kërkesës pranë gjykatës kompetente për lëshimin e një urdhri *ex parte* dhe pa njoftim për pengdhënësin, që urdhëron marrjen dhe dorëzimin e pengut tek pengmarrësi.

Tema 2: Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë energjetike përmes instrumenteve të financimit në këtë sektor, mbështetjes së reformave në këtë sektor, promovimit të eficiencës së energjisë dhe të energjisë së ripërtëritshme

Eficienca e Energjisë dhe Energjia e Ripërtëritshme

Si nënshkruese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë, Kosova duhet të respektojë kërkesat e përcaktuara në direktivat e BE në fushën e energjisë dhe mjedisit. Në qershor 2016, Kosova ka miratuar ligjet për energjinë, rregullatorin e energjisë, energjinë elektrike dhe gazin, që kanë për qëllim transpozimin e Paketës së Tretë Energjetike të BE. Pritet që këto akte të reja ligjore të liberalizojnë tregun e energjisë dhe të adresojnë hendeqet aktuale siç janë ndarja (shthurja) dhe eliminimi i ndër-subvencioneve mes kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Pritet që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të ketë pavarësi edhe më të madhe në përcaktimin e tarifave energjetike dhe gradualisht të bëjë de-rregullimin e çmimit. Në muajt e ardhshëm, Qeveria duhet të koordinojë zbatimin e kornizës ligjore të miratuar së fundmi duke hartuar aktet nënligjore përkatëse.

Skemat ekzistuese për mbështetjen e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) që janë të fokusuara në hidrocentralet e vogla, erën, biomasën, biogazin dhe energjinë solare, përfshijnë garantimin e transmissimit dhe distribuimit të energjisë elektrike të gjeneruar nga BRE përmes rrjetit si dhe prioritetit në distribuim. Megjithatë, energjia e gjeneruar nga këto burime është e kufizuar sipas tarifës përkatëse për shkak të barrierave ekzistuese rregullatore. Kosova duhet që edhe më shumë të lehtësojë integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme në rrjet dhe implementimin e procedurave për garantimin e origjinës.

Megjithëse Kosova ka bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e kornizës së politikave për eficiencën e energjisë me miratimin e Planit të dytë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë në Dhjetor 2013, ende ka shumë punë për t'u deri në sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Intensiteti energjetik në Kosovë vazhdon të jetë relativisht i lartë. Megjithëse Ligji për Eficiencën e Energjisë është miratuar, implementimi i disa masave të EE, siç janë matja, faturimi, menaxhimi i energjisë, auditimi i energjisë, instrumentet e financimit të ESCO, roli si shembull i sektorit publik, janë ende në zhvillim e sipër. Gjithashtu, ende mbetet për tu miratuar një Ligj për performancën energjetike të ndërtesave si dhe rregulloret implementuese për zbatimin e Direktivës 2010/31/EU.

Tema 3: Mbështetja e ndërlikohjes dhe integritetit rajonal.

Partneriteti Publiko Privat (PPP)

Në përgjithësi, Ligji për Partneritetin Publiko Privat (PPP) është ligj mjaft modern dhe i avancuar dhe që është përmirësuar dukshëm në krahasim me ligjin e mëparshëm, që si i tillë ishte konsideruar si bazë solide ligjore për projektet e PPP. Në kuadër të Ministrisë së Financave është krijuar një organ i veçantë (Komiteti për Partneritete Publiko-Private "KPPP") për mbikëqyrjen dhe koordinimin e projekteve PPP. KPPP është përgjegjëse, *ndër tjera* për zhvillimin dhe menaxhimin e programi kombëtar të PPP, zhvillimin e politikave të PPP dhe shqyrtimin, miratimin ose refuzimin e projekt propozimeve si dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të projekteve. Në Ministrinë e Financave gjithashtu është themeluar Departamenti për Partneritete Publiko-Private ("Departamenti për PPP") i cili është

përgjegjës për mbështetjen e punës së KPPP, të Ministrit të Financave dhe autoriteteve tjera për projektet PPP.

Korniza ligjore për PPP përbëhet nga Ligji për PPP që është hartuar me qëllim të harmonizimit të legjislacionit vendor me kërkesat e *acquis* BE si pjesë e përpjekjeve të Kosovës për tu bërë shtet kandidat për anëtarësim në BE. Raporti i Progresit i BE theksohet se Ligji për PPP është “kryesisht në përputhje” me legjislacionin e BE. PPP-të mund të implementohen ose në formë kontraktuese (përmes koncesionit ose kontratës publike) ose në formë institucionale, sipas zgjedhjes së partnerit publik bazuar në ndarjen optimale të rrezikut dhe përgjegjësi. Ligji për PPP gjithashtu përmban disa masa mbrojtëse të përshtatshme, siç është e drejta e palëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e kontesteve që rezultojnë nga kontrata e PPP dhe mundësinë për huadhënësin që të ndërhyjë në rast të dështimit për zbatimin e kontratës.

Prokurimi Publik (PP)

Nga rishikimi i legjislacionit rezulton se korniza ligjore në fushën e prokurimit sa i përket integritetit, llogaridhënies, transparencës, zbatueshmërisë, proporcionalitetit, stabilitetit dhe përmbartimit është mjaft e avancuar. Megjithatë, procesi nuk është plotësisht i rregulluar dhe disa vendime kyçe nuk janë të standardizuara dhe janë në diskrecion të plotë të autoriteteve kontraktuese. Ligji për Prokurimin i vitit 2011 (me ndryshime dhe plotësime) përmban dispozita preferenciale të çmimit dhe lejon zgjedhjen e ofertave nga kompanitë vendore me kusht që çmimi i kompanisë vendore nuk është më shumë se 10 pikë më pak se sa çmimi më i ulët i një kompanie të huaj. Trajtimi preferencial i kompanive vendore nuk është në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. E-prokurimi është lancuar në vitin 2016; megjithatë, në mënyrë që të ketë procedura të njëtrajtshme të prokurimit ka nevojë për ndryshim substancial të legjislacionit dhe ose miratim të akteve nënligjore përkatëse.

Draft Strategjia Kombëtare e Kosovës për Prokurimin Publik 2015 – 2020 vendos prioritetet, ndër tjera, në vendosjen e praktikave të gjelbra dhe të përgjegjshme nga aspekti social të prokurimit publik, mbështetjen e NVM-ve në procesin e prokurimit publik; si dhe harmonizimin e mëtutjeshëm të kornizën ligjore për prokurimin me direktivat e BE. Ky harmonizim ende duhet të kompletohet.

ANEKSI 5 – PROFILI GJINOR

Pabarazia Gjinore dhe Zhvillimi Njerëzor¹⁹

Kushtetuta e Kosovës garanton trajtimin e barabartë të meshkujve dhe femrave para ligjit. Meshkujt dhe femrat kanë të drejta të barabarta pronësore dhe trashëgimore. Nuk ka ligje të cilat i kufizojnë industrinë në të cilat mund të punojnë femrat. Përderisa Kosova ka një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe disa mekanizma për avancimin e barazisë gjinore, duke përfshirë Ligjin për Barazinë Gjinore të vitit 2004 i cili është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2015, implementimi i kornizës ligjore vazhdon të jetë sfidues.

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Kosova ka një rën ndërkallë të ulët të pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore me gjithsej 21.4 përqind. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2015), pjesëmarrja e femrave të moshës 15 deri 64 në punësim është 21.4 përqind krahasuar me 61.8 përqind për meshkujt, që është nën mesataren e BE (59.6 përqind për femrat dhe 70.1 përqind për meshkujt). Niveli i papunësisë është posaçërisht i lartë në mesin e të rinjve, që paraqet shqetësim të veçantë, duke marrë parasysh që Kosova ka popullatën më të re në Evropë.

Tregu i punës në Kosovë paraqet shenja të segregimit vertikal dhe horizontal. Femrat janë të mbi-përfaqësuara në pozita administrative dhe sipas Anketës BEEP në vitin 2015, vetëm 4 përqind e femrave avancojnë në pozita menaxhuese. Femrat kanë më shumë gjasa të zhvillojnë karrierën dhe të kenë role mbikëqyrëse në sektorin publik se sa në kompanitë private: 79 përqind e të gjitha femrave mbikëqyrëse punojnë në institucione qeveritare ose ndërmarrje në pronësi shtetërore. Sipas Ankesës së Punës të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2013) femrat janë të nën-përfaqësuara në energji, ndërtimtari dhe transport. Në Kosovë, arsimi kontribuon në segregimin gjinor në tregun e punës, për shkak se studentet femra kanë tendencë të zgjedhin degën e edukimit, filologjisë, medicinës dhe filozofisë ndërsa studentët meshkuj përbëjnë pothuajse dy të tretat e të gjithë studentëve në degët e ekonominë, ndërtimtarisë, arkitekturës dhe inxhinierisë kompjuterike.

Tabela 1. Pjesëmarrja në Fuqinë Punëtore sipas moshëse

	Niveli i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, moshë 15-64, %		Niveli i punësimit, moshë 15-64, %		Niveli i papunësisë, moshë 15-64, %		Niveli i papunësisë të të rinjve (15-24 vite), %	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Kosova	21.4	61.8	12.5	41.3	41.6	33.1	71.7	56.2

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2015). *Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2014.*

Qasja në financa dhe ndërmarrësia

¹⁹ Ju lutem vini re se duke marrë parasysh statusin e Kosovës në komunitetin ndërkombëtar, disa nga të dhënat që zakonisht përdoren për Aneksin Gjinnor mungojnë në rastin e Kosovës.

Hendeku gjinor sa i përket qasjes në financim është shumë i lartë për shkak të mungesës së qasjes për femrat në kolateral për kredi. Ndër tjera, kjo është për shkak të ligjit për trashëgiminë dhe përdorimit të 'klauzolës për heqje dorë nga trashëgimia'; si dhe zakoneve kulturore sipas të cilave femrat heqin dorë nga të drejtat pronësore në favor të të afërmeve të tyre meshkuj. Sipas anketës BEEPS, femrat kanë shumë më pak gjasa të kenë xhirollogari bankare në një institucion financiar (36 përqind e femrave kanë xhirollogari bankare krahasuar me 59 përqind të meshkujve). Hendeku në kursime është më e vogël, me 26 përqind të femrave që kanë kursime formale, krahasuar me 29 përqind të meshkujve, sipas të dhënave të Bankës Botërore për të Dhënat e Përfshirjes Financiare.

Pjesëmarrja e femrave në ndërmarrësi dhe pronësi formale të bizneseve është gjithashtu shumë e vogël në krahasim me standardet rajonale. Sipas të dhënave të anketës BEEP për vitin 2015, vetëm 11.1 përqind e bizneseve kanë femra nga radhët e pronarëve, ndërsa përqindja e bizneseve plotësisht në pronësi të femrave qëndron në 7.8 përqind, që është ndër më të ulëtat në shtetet e operimit të BERZH. Ngjashëm, në bizneset e anketuara, vetëm 7.2 përqind e bizneseve kanë femra në pozitat e larta menaxhuese.

Indikatorët tjerë gjinor

Kosova ka bërë progres në përmirësimin e përfaqësimit të femrave në politikë gjatë dekadës së fundit, duke vendosur kuotën prej 30 përqind për pjesëmarrjen e femrave në Kuvendin e Kosovës dhe në nivelin lokal. Aktualisht 32.5 përqind e deputetëve të Kuvendit të Kosovës janë femra. Në degën gjyqësore, nga 9 gjyqtarë në gjykatën kushtetuese, katër prej tyre janë femra – njëra prej tyre është Kryetare e Gjykatës. Megjithatë, femrat vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale kur nuk ka kuota. Pavarësisht nga mungesa e të dhënave, prevalenca e Dhunës mbi Baza Gjinore (DHBGJ) vazhdon të jetë e lartë në Kosovë. Legjislacionit kundër dhunës ndaj femrave në Kosovë është kryesisht në përputhje me standardet Evropiane dhe qeveria ka miratuar një ligj për dhunën në familje në vitin 2010. Megjithatë, vazhdon të ketë sfida lidhur me cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve për viktimat e dhunës mbi baza gjinore.

ANEKSI 6 – BERZH DHE KOMUNITETI I DONATORËVE

Bashkëpunimi teknik (BT) i financuar nga donatorët në Kosovë i ka mundësuar Bankës që të kryejë vlerësime të hershme diagnostike, duke përfshirë përgatitjen e projekteve për investime në infrastrukturë, zhvillimin e kapaciteteve të klientëve potencial dhe shkëmbimin e përvojave të tranzicionit nga politik bërësit dhe akterët privat nga Shtete e Operimit të BERZH në Evropën Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu, fondet për BT janë ofruar për mbështetjen e transferimit të aftësive dhe zhvillimit të NMVM-ve private, duke përfshirë përmes konsulentëve ndërkombëtar dhe vendor në kuadër të Këshillave për Bizneset e Vogla, që është pjesë e Iniciativës për Bizneset e Vogla.

Kosova gjithashtu ka përfituar nga grantet e bashkë-financuara në formë të incentivave financiare për mbulimin e humbjeve në sektorin e energjisë së qëndrueshme dhe atë financiar.

Fokusi i granteve nga donatorët pritet të vazhdojë të jetë në zhvillimin e infrastrukturës bazike, rritjen e sigurisë energjetike dhe rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve. Për adresimin e këtyre nevojave, BERZH do të mbështetet në disa fonde të donatorëve të administruara nga Banka, përveç burimeve që janë vënë në dispozicion nga aksionarët e saj:

- **Bashkimi Evropian** mbështet Kosovën përmes Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit dhe ka kanalizuar mbi 3.6 milion Euro përmes bankës në BT dhe grante të bashkë-financimit. Në kuadër të IPA II (2014 – 2020) gjithashtu pritet që BE do të vazhdojë të mbështetë arritjen e prioritetëve kombëtarë dhe rajonale që janë të fokusuara në zhvillimin socio-ekonomik dhe të konkurrueshmërisë së NVM-ve, përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, rritjen e lidhjeve rajonale dhe progresit drejt anëtarësimit në BE.

Në Tetor 2010, Projekti për Energji të Qëndrueshme në Kosovë është krijuar për mbështetjen e bankave partnere dhe institucioneve financiare jo-bankare që operojnë në Kosovë dhe që i plotësojnë standardet përkatëse bankare dhe të qeverisjes korporative për kreditimin e NVM-ve dhe/ose sektorit rezidencial për përfituesit përfundimtar në fushën e eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sektorët rezidencial dhe komercial përmes BT dhe granteve të bashkë-financuara në formë të stimulimit financiar. Mbështetja pritet të rritet në kontekstin rajonal përmes fondeve që do të ofrohen në kuadër të fazës së dy të Programit Rajonal për Eficiencën e Energjisë për Ballkanin Perëndimor (PREEBP Plus).

Mbështetja financiare në kuadër të KIBP do të rritet dhe do të përdoret gjithnjë e më shumë për bashkë-financimin e projekteve me interes rajonal, respektivisht të atyre projekteve të cilat e rrisin ndërlidhjen mes shteteve të rajonit dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, në vitin 2015, BE ka konfirmuar financimit përmes KIBP të një granti investues prej 38.5 milion Euro për plotësimin e financimit nga BERZH prej 80.9 milion Euro për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 nga kufiri me Serbinë në veri të Kosovës (Leshkak) deri në kufirin me IRJ të Maqedonisë (Hani i Elezit).

- **Donatorët bilateral:** fondet në formë të granteve do të kërkohen nga donatorët bilateral të cilët mbajnë llogari të administruara nga BERZH, dhe që kanë shprehur interesimin për mbështetjen e aktiviteteve në Kosovë në të gjithë sektorët dhe fondet e të cilave do të përdoren për plotësimin e aktiviteteve në kuadër të KIBP.

- **Fondi Special i Aksionarëve të BERZH (FSA)** i financuar nga të hyrat neto të Bankës. FSA është mekanizëm plotësues për burimet e donatorëve dhe do të ofrojë mbështetje për BT dhe aktivitete jo BT në fushat ku ka mungesë të mbështetjes, por që janë prioritet i bankës për tejkalimin e tranzicionit.

ZOTIMET PËR BT NGA DONATORËT PËRMES BERZH, 2011-2015*

Donatori	Zotimi për BT (€)
Fondi Special i Aksionarëve të BERZH	4,960,483
Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor në kuadër të KIBP	1,840,000
BE	1,288,224
Republika Çeke	599,000
Norvegjia	901,000
Luksemburgu	63,510
Totali	9,652,216

ZOTIMET PËR BT SIPAS TEMAVE TË STRATEGJISË PËRMES BERZH, 2011-2015*

Temat e Strategjisë për Kosovën	Zotimet për BT (€)
Infrastruktura e Qëndrueshme dhe Siguria Energjetike	3,585,000
Tranzicioni në Ekonomi të Gjellbër	2,883,987
Ndërmarrësia dhe NVM-të	2,776,819
Zhvillimi i Sektorit Financiar të Fuqishëm dhe të Qëndrueshëm	268,000
Qeverisja e Mirë	138,410
Totali i përgjithshëm	9,652,216

Shënim: Vlerat e zotimeve bazuar në fund të vitit ose të dhënat periodike për secilin vit.

* Reflekton statusin e zotimeve deri me 31 dhjetor 2015